



**PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT TË PËR
BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJE
TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
2026–2030**

Maj 2026

Tabela e lëndës

PJESA 1: KONTEKSTI.....	4
1.1. Hyrje dhe qëllimi i dokumentit.....	4
1.1.1. Qasja e dokumentit.....	4
1.1.2. Parimet themelore dhe shtyllat prioritare sipas Bashkimit Evropian	5
1.1.3. Instrumentet dhe rregulloret evropiane dhe ndërkombëtare	5
1.2. Kuadri kombëtar strategjik dhe rregullator	8
1.3. Situata aktuale, arritjet rezultatet 2021-2025	11
1.3.1. Varfëria ndër breza dhe mbrojtja sociale	12
1.3.2. Përballja me diskriminimin, përfshirja dhe antigjipsizmi.....	13
1.3.3. Aksesit dhe pjesëmarrja	14
1.3.4. Strehimi	16
1.3.5. Arsimit	17
1.3.6. Punësim dhe formim profesional	19
1.3.7. Shëndetësia	21
1.3.8. Vlerësimi nga Komisioni Evropian	22
PJESA 2: QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË.....	24
2.1. Vizioni dhe misioni i dokumentit.....	24
2.2. Qëllimet e politikës dhe objektivat strategjike	24
2.3. Masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme.....	30
Fusha Prioritare 1: Arsimit dhe nxitja e dialogut ndërkulturor	30
Fusha Prioritare 2: Punësimi dhe aftësimi	31
Fusha Prioritare 3: Strehimi	33
Fusha Prioritare 4: Kujdesi shëndetësor	34
Fusha Prioritare 5: Varfëria dhe përjashtimi social.....	35
Fusha Prioritare 6: Antigjipsizmi.....	35
Fusha Prioritare 7: Aksesit i barabartë në drejtësi dhe regjistrim civil	36
2.4. Qeverisja dhe kuadri institucional.....	37
2.5. Mekanizmat e zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit.....	40
2.5.1. Qasja e zbatimit - roli i aktorëve vendor dhe përfshirja e komuniteteve	40
2.5.2. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi.....	41
2.5.3. Aktorët përgjegjëse dhe burimet e të dhënave.....	43
2.5.4. Vlerësimi	44
2.5.5. Raportimi	44
PJESA 3: FINANCIMI.....	45
4. REFERENCAT.....	47

5. ANEKSET.....	51
ANEKSI 1: Matrica E Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030.....	51
ANEKSI 2. Korniza e indikatorëve strategjik të monitorimit.....	81
ANEKSI 3. Financimi 2026-2030	86
ANEKSI 4 Dokumentet strategjike dhe kuadri ligjor relevant për PKV	93
ANEKSI 5. Shkurtesat	99

PJESA 1: KONTEKSTI

1.1. Hyrje dhe qëllimi i dokumentit

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030 (PKVBPPRE 2030) përfaqëson një angazhim të qeverisë, i ndërtuar mbi masat e ndërmarra dhe ato në zbatim nga plani i mëparshëm 2021–2025, i cili përcakton si fusha prioritare: regjistrimin civil, arsimin, dialogun ndërkulturor, punësimin dhe zhvillimin i aftësive, kujdesin shëndetësor, strehimin e integrimin urban, si dhe mbrojtjen sociale. Në këtë kuptim, PKVBPPRE 2030 përbën një vijimësi të këtij kuadri politik, të përshtatur me angazhimet më të fundit kombëtare dhe evropiane.

PKVBPPRE 2030 synon të avancojë **barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë**, përmes reduktimit të matshëm të hendekut në aksesin në të drejta, shërbime dhe mundësi krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë. PKVBPPRE 2030 synon të përkthejë angazhimet kushtetuese dhe ndërkombëtare në rezultate konkrete dhe të prekshme, përmes masave të integruara në arsim, punësim, mbrojtje sociale, shëndetësi, strehim dhe luftën kundër diskriminimit; si dhe të garantojë që ndërhyrjet të jenë të qëndrueshme, të financuara dhe të monitoruara periodikisht.

PKVBPPRE 2030 mbështetet në njohjen ligjore të romëve dhe egjiptianëve si pakica kombëtare dhe në garantimin e të drejtës së vetë identifikimit, duke konsideruar pjesëmarrjen kuptimplotë të komuniteteve si kusht thelbësor për legjitimitetin dhe efektivitetin e politikave publike.¹ Njëkohësisht, PKVBPPRE 2030 integron një **dimension të qartë të agjendës së integritit evropian**, duke shërbyer si instrument planifikimi kombëtar për adresimin e rekomandimeve dhe standardeve të BE-së në fushat e të drejtave themelore, mos diskriminimit dhe përfshirjes sociale, në funksion të përafrimit me *acquis* dhe kërkesat e procesit të anëtarësimit.

1.1.1. Qasja e dokumentit

Qasja e PKVBPPRE 2030 është e bazuar në të drejta, në evidencë dhe në pjesëmarrje, duke reflektuar parimet e Kushtetutës dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara.² Për këtë arsye, Plani vendos theksin tek garantimi i barazisë përpara ligjit, i mos diskriminimit, i të drejtave kulturore e gjuhësore dhe i autonomisë vendore, duke u fokusuar paralelisht te mekanizmat administrativë që i mundësojnë këto të drejta.

PKVBPPRE 2030 është i ndërlidhur me kuadrin kombëtar të planifikimit strategjik dhe me sektorët kryesorë të politikave publike. Ai synon të shërbejë si urë midis prioriteteve kombëtare të zhvillimit dhe integritit evropian, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030³ dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026⁴, duke përkthyer objektivat e këtyre dokumenteve në masa të synuara për romët dhe egjiptianët. Në të njëjtën kohë, Plani parashikon masa që ndërveprojnë me strategjitë dhe kuadrin ligjor sektorial (mbrojtja sociale, arsimi, punësimi, shëndetësia, strehimi), me

¹ Ligj nr. 96, datë 13.10.2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

² Ligj nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar (veçanërisht nenet 18, 20 dhe 122).

³ VKM nr. 88, datë 22.02.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030”.

⁴ VKM nr. 16, datë 11.01.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026”.

qëllim që përfshirja e romëve dhe egjiptianëve të konsiderohet pjesë integrale e politikave sektoriale dhe e buxhetimit publik.

1.1.2. Parimet themelore dhe shtyllat prioritare sipas Bashkimit Evropian

Në përputhje me qasjen e Bashkimit Evropian (BE) për romët, Plani organizohet rreth tre parimeve themelore: barazia, përfshirja dhe pjesëmarrja,⁵ të cilat zbërthehen si më poshtë:

- **Barazia** nënkupton parandalimin dhe adresimin e diskriminimit, antigjipsizmit, gjuhës së urrejtjes dhe trajtimit të pabarabartë në institucione dhe në tregun e punës, duke forcuar zbatimin e normave ligjore dhe mekanizmave të mbrojtjes dhe ankimimit.
- **Përfshirja** lidhet me uljen e varfërisë dhe përjashtimit social, aksesin në arsim cilësor, punësim të qëndrueshëm, shëndetësi dhe strehim dinjitoz dhe të desegreguar, si dhe sigurimin e aksesit në shërbime bazë dhe infrastrukturë të përshtatshme.
- **Pjesëmarrja** nënkupton fuqizimin e komuniteteve, rritjen e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje, si dhe ndërtimin e besimit dhe bashkëpunimit midis institucioneve dhe komuniteteve, përfshirë rolin e organizatave të shoqërisë civile në monitorim dhe llogaridhënie.

Këto tre shtylla orientohen nga parimet e promovimit të desegregimit, qasjes së ndjeshme gjinore dhe ndaj fëmijëve, adresimit të diskriminimit të shumëfishtë, si dhe orientimit drejt rezultateve.

1.1.3. Instrumentet dhe rregulloret evropiane dhe ndërkombëtare

Në Samitin BE–Ballkani Perëndimor të mbajtur në Zagreb në maj 2020, BE riafirmoi perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe rëndësinë e përfshirjes sociale, uljes së pabarazive dhe krijimin e kushteve për rritje gjithëpërfshirëse dhe punësim si pjesë e reformave ekonomike e sociale të rajonit dhe të agjendës së zgjerimit.⁶ Në këtë kuadër, PKVBPPRE 2030 kontribuon drejtpërdrejtë në zbatimin e reformave sociale dhe konvergjencën me BE-në.

Korniza Strategjike e BE-së për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve 2020–2030 përbën bazën kryesore politike të PKVBPPRE 2030, duke orientuar vendosjen e objektivave dhe treguesve kombëtarë drejt vitit 2030, përfshirë reduktimin e diskriminimit, varfërisë, segregimit hendekut të jetëgjatësisë.

Rekomandimi i Këshillit (2021/C 93/01) për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve përcakton kërkesa operative për masa konkrete kundër diskriminimit, antigjipsizmit, varfërisë, segregimit në arsim dhe strehim, si dhe për përfshirjen efektive të komunitetit në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave. Gjithashtu, Rekomandimi (2021/C 93/01) thekson nevojën për objektiva të qarta, mbledhje më të mirë të të dhënave, monitorim dhe raportim, si dhe nevojën për të adresuar diskriminimin e shumëfishtë që prek gratë, fëmijët, të rinjtë, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara.⁷ Në përputhje me këtë,

⁵ Komisioni Evropian (2020). “A Union of Equality: EU Roma Strategic Framework for Equality, Inclusion and Participation”, COM(2020) 620 final, 7.10.2020,

⁶ Komisioni Evropian/DG NEAR (2021). “Berlin Process: second Roma integration ministerial meeting reinforces commitment to step up efforts for inclusion”, 29.06.2021; Berlin Process. (2021). “Berlin Process 2021”.

⁷ Këshilli i Bashkimit Evropian (2021). Rekomandimi 2021/C 93/01, datë 12.03.2021.

PKVBPPRE 2030 forcon koordinimin ndërinstytucional, përmirëson sistemet e monitorimit dhe garanton pjesëmarrje më të strukturuar të komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Deklarata e Poznanit (2019), e miratuar në kuadër të Procesit të Berlinit, përbën angazhimin kryesor rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve brenda procesit të zgjerimit të BE-së. Përmes kësaj deklarate, qeveritë e rajonit janë zotuar të ndërmarrin hapa të matshëm në fushat e punësimit, arsimit, strehimit, kujdesit shëndetësor, dokumentacionit civil dhe luftës kundër diskriminimit, si dhe të krijojnë kanale formale për përfshirjen e komuniteteve rome dhe të pushtetit vendor në hartimin, monitorimin dhe raportimin e politikave. Deklarata parashikon gjithashtu përdorimin e standardeve të përbashkëta të raportimit dhe monitorimit për integrimin e romëve në rajon.⁸ PKVBPPRE 2030 harmonizon objektivat kombëtare me këto zotime dhe me standardet e përbashkëta të raportimit rajonal. Deklarata e Poznanit përfshin gjithashtu angazhime specifike për integrimin e komuniteteve rome në agjendën dixhitale dhe të gjelbër. Në këtë kuadër, PKVBPPRE 2030 adreson boshllëqet e identifikuara në aksesin dixhital me veçanërisht barrierat në përdorimin e shërbimeve elektronike shtetërore nga familjet rome dhe egjiptiane, si dhe promovon përfshirjen e tyre në sektorët e lidhur me ekonominë e gjelbër, duke kombinuar formimin profesional me mbështetjen për formalizim dhe sipërmarrje (Fusha Prioritare 2 dhe 7).

Konkluzionet e Procesit të Berlinit (2020-2021) theksojnë masa konkrete për përmirësimin e integritit të romëve, përfshirë rritjen e punësimit formal, aksesin në aftësim profesional me një fokus të veçantë të rinjtë dhe gratë, përmirësimin e strehimit dhe përdorimin e instrumenteve financiare, përfshirë Kornizën e Investimeve për Ballkanin Perëndimor. Më tej, në **Takimin e Pestë Ministror për Integrimin e Romëve** mbajtur në Berlin në 2024⁹, u theksuan tranzicioni i gjelbër dhe digjital, përmirësimi i kushteve të strehimit dhe infrastrukturës në vendbanimet rome, akses i barabartë në shëndetësi dhe forcimi i masave kundër antigjipsizmit përfshirë raportimin e rasteve të diskriminimit.

Ndër dokumentet e tjera evropiane me rëndësi të drejtpërdrejtë, **Konkluzionet e Këshillit EPSCO (2023)** theksojnë nevojën për adresimin e segregimit hapësinor dhe sigurimin e strehimit të përshtatshëm, të përbalueshëm dhe të integruar përmes zgjidhjeve të qëndrueshme dhe përfshirjes së komunitetit në hartimin dhe zbatimin e politikave që i prekin. Në këtë kuadër, PKVBPPRE 2030 adreson strehimin jo vetëm si çështje infrastrukture, por dhe si pjesë të një qasjeje më të gjerë për përfshirje sociale, desegregim dhe qasje të barabartë në shërbime.

Direktiva 2000/43/EC mbetet themeli juridik evropian në trajtimin e barabartë, duke ndaluar diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në punësim, arsim, mbrojtje sociale, shëndetësi dhe strehim.¹⁰ Për kontekstin e Planit, kërkohet përputhje e masave me standardin e trajtimit të barabartë dhe funksionimin efektiv të mekanizmave kombëtarë kundër diskriminimit.

⁸ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC). (2019). "Declaration of Western Balkans Partners on Roma Integration within the EU Enlargement Process", Poznań, 05.07.2019.

⁹Berlin Process. (2024). "Fifth Roma Ministerial Meeting Conclusions", Berlin, 2024.

¹⁰ Këshilli i Bashkimit Evropian. (2000). Direktiva 2000/43/EC, datë 29.06.2000.

Rekomandimi “Pathways to School Success” (2022/C 469/01) promovon qasje të integruara për suksesin në arsim, duke kombinuar masa parandaluese, mbështetëse, ndërhyrëse dhe kompensuese në uljen e braktisjes shkollore. Gjithashtu, Rekomandimi (2022/C 469/01) thekson nevojën për mirëqenie në shkollë, parandalim të bullizmit, ndjekje të hershme të rrezikut për braktisje dhe riangazhim të fëmijëve dhe të rinjve që kanë dalë nga sistemi arsimor.¹¹ Në përputhje me Rekomandimin, PKVBPPRE 2030 përfshin masa që orientohen jo vetëm drejt aksesit formal, por dhe drejt suksesit real në shkollë dhe desegregimit arsimor.

Plani i Veprimit i BE-së kundër Racizmit 2020–2025, thekson adresimin sistematik të diskriminimit dhe antigjipsizmit, përmes forcimit të legjislacionit, të dhënave, ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile.¹² Në këtë kontekst, PKVBPPRE 2030 e trajton antigjipsizmin si dimension specifik të politikave kundër diskriminimit. Po ashtu, **iniciativat e Këshillit të Evropës dhe Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale** theksojnë rolin e pushtetit vendor në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe përfshirjen e komuniteteve romë, duke e bërë të domosdoshëm angazhimin aktiv të bashkive në zbatimin e Planit. Qasja e Planit është gjithashtu në përputhje **me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale**, e cila vendos parime për mundësi të barabarta, akses në tregun e punës, kushte të drejta pune, mbrojtje sociale dhe përfshirje.

Plani është i përafshuar edhe me **Strategjinë e BE-së kundër Varfërisë 2026**¹³, e cila promovon një qasje të integruar për parandalimin dhe reduktimin e varfërisë përgjatë ciklit të jetës, duke kombinuar mbështetjen e të ardhurave, aksesin në shërbime cilësore, përfshirjen në tregun e punës, mbrojtjen e fëmijëve dhe familjeve, si dhe forcimin e qeverisjes dhe monitorimit të politikave sociale.

Plani harmonizohet po ashtu me instrumentet e **Këshillit të Evropës**, konkretisht me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, me Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, standardet për mbrojtjen e gjuhëve rajonale ose të pakicave dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Së bashku, këto instrumente përcaktojnë standarde për barazinë, mbrojtjen, e pjesëmarrjen.

Njëkohësisht, PKVBPPRE 2030 mbështetet në angazhimet ndërkombëtare e konventat¹⁴ të cilat vendi ynë i ka ratifikuar ose aderuar që në fillim të viteve 1990, duke i kthyer këto angazhime në masa që synojnë garantimin e aksesit real në të drejta dhe mundësi për romët dhe egjiptianët, përtej njohjes formale të tyre.

Plani kontribuon drejtpërdrejt në **Agjendën 2030**, veçanërisht në Objektivat e Zhvillimit Qëndrueshëm (OZHQ) **1** për çrrënjosjen e varfërisë, **OZHQ 4** për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, **OZHQ 10** për reduktimin e pabarazive dhe **OZHQ 16** për drejtësi, përfshirje dhe institucione efektive. Në të njëjtën kohë, kontribuon në arritjen **OZHQ 5** për barazinë

¹¹ Këshilli i Bashkimit Evropian (2022). Rekomandimi 2022/C 469/01, datë 28.11.2022, “Pathways to School Success”.

¹² Komisioni Evropian (2020). “EU Anti-racism Action Plan 2020–2025”, COM(2020) 565 final, 18.09.2020..

¹³ Komisioni Evropian (2026). “The European Union’s Anti-Poverty Strategy”, COM (2026) 538 final, Bruksel, 6.05.2026.

¹⁴ Si për shembull: Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa kundër Torturës, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

gjinore, **OZHQ 8** për punësim të denjë dhe rritje ekonomike, **OZHQ 11** për strehim dhe komunitete gjithëpërfshirëse, si edhe **OZHQ 3** për shëndet dhe mirëqenie.

Përmes kësaj ndërlihdjeje, Plani pozicionohet si një instrument ndërsektorial që kontribuon njëkohësisht në uljen e pabarazive strukturore që prekin romët dhe egjiptianët e në përmbushjen e angazhimeve kombëtare e ndërkombëtare të Shqipërisë për zhvillim të qëndrueshëm.

1.2. Kuadri kombëtar strategjik dhe rregullator

Shqipëria ka miratuar një kuadër ligjor dhe strategjik për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane, i ndërtuar mbi parimet kushtetuese të barazisë, mos diskriminimit dhe të drejtave themelore, si edhe mbi orientimin drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe integritit evropian. Ky kuadër mbështetet në **Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030**, si dokument ombrellë për planifikimin kombëtar dhe harmonizimin me procesin e anëtarësimit në BE. **Plani Kombëtar për Integrimin Evropian** shërben si instrument programues për përafrimin me *acquis* dhe përmbushjen graduale të detyrimeve që burojnë nga 33 kapitujt, veçanërisht në **Kapitullin 19** (Politika sociale dhe punësimi), **Kapitullin 23** (Gjyqësori dhe të drejtat themelore) dhe **Kapitullin 26** (Arsimi dhe kultura).

Në qendër të këtij kuadri qëndron Ligji nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, i cili garanton të drejtën e vetë identifikimit, ruajtjes së identitetit, përdorimit të gjuhës, pjesëmarrjen në jetën publike dhe aksesin e barabartë në shërbime. Zbatimi i tij është përforcuar nga aktet nënligjore të vitit 2024, përkatësisht me Vendimet nr. 843, 844 dhe 845, të cilat rregullojnë mbledhjen e të dhënave, përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare dhe funksionimin e mekanizmave institucionalë, duke e zhvendosur kuadrin nga njohja deklarative drejt zbatimit praktik.

Në fushën e mbrojtjes sociale, kuadri rregullator mbështetet kryesisht në Ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale” dhe Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, që përcakton kategoritë përfituese të skemave të mbështetjes në para, llojet e shërbimeve, standardet e ofrimit dhe përgjegjësitë institucionale. Në nivel qendror dhe vendor, **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030**, synon dhe promovon zgjerimin dhe decentralizimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, fuqizimin e mekanizmave të menaxhimit të rastit, përfshirjen aktive dhe koordinimin ndërmjet mbështetjes monetare dhe shërbimeve të integruara në komunitet.¹⁵ Për komunitetet rome dhe egjiptiane, ky kuadër krijon një bazë normative të rëndësishme për adresimin e varfërisë ndërbrezore, përjashtimit social dhe nevojës për shërbimeve të integruara. Megjithatë zbatimi efektiv në praktikë vijon të ndikohet nga faktorë të tillë si mungesa e dokumentacionit civil, nivelit të ulët të aksesit në informacion dhe shërbime, kapacitetet e kufizuara të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe disponueshmëria e cilësia e pabarabartë e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në territor.

Në fushën e strehimit, Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, përcakton programet e strehimit, kritere përparësie për grupet në nevojë dhe përgjegjësitë për njësitë

¹⁵ VKM nr. 152, datë 13.03.2024, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030”.

e vetëqeverisjes vendore.¹⁶ Ky ligj, parashikon masa mbrojtëse ndaj dëbimeve dhe rezervimin e 5% të përfituesve për komunitetet rome dhe egjiptiane në programet e strehimit social. Politikat janë plotësuar me masa financiare (p.sh. VKM nr. 456/2025) dhe me përpjekje për legalizimin e vendbanimeve informale dhe kompensimin sipas Ligjit nr. 20/2020. Në praktikë, përmes masave të Planin Kombëtar të Veprimit përtej lehtësimit të aksesit në programet e strehimit, synohet reduktimi i segregimit hapësinor, rritja e përballueshmërisë së banesave dhe forcimi kapaciteteve të njëjve të vetëqeverisjes vendore për zbatimin efektiv të politikave të strehimit.

Në arsim, Shqipëria garanton arsim falas dhe të detyrueshëm për të gjithë fëmijët nga mosha 6 deri në 16 vjeç, sipas Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, dhe përcakton parimet e përfshirjes, barazisë dhe mosdiskriminimit në arsimin parauniversitar.¹⁷ Masat mbështetëse përfshijnë identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve përmes mediatorëve romë dhe egjiptianë, si dhe zbatimin e **Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026**.¹⁸ Prioritetet lidhen me rritjen e regjistrimit dhe frekuentimit, uljen e braktisjes shkollore dhe mbështetjen e tranzicioneve ndërmjet niveleve të arsimit. Megjithatë, aksesit në shërbimet e kujdesit dhe edukimin në fëmijërinë e hershme mbetet sfidë, si përsa i përket infrastrukturës fizike, ashtu edhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Në punësim dhe formim profesional, baza ligjore mbështetet në Ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimin”, programet e nxitjes së punësimin të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave, përfshirë programet e reja që synojnë të papunët afatgjatë dhe grupet në nevojë.¹⁹ Kjo fushë mbështetet gjithashtu në **Strategjinë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësi 2023–2030** dhe planin e zbatimit të Garancisë Rinore 2023–2025.²⁰ Për romët dhe egjiptianët, kjo strategji është veçanërisht e rëndësishme, pasi krijon bazën për masa më të synuara në aktivizim, këshillim, aftësim, ndërmjetësim dhe integrim në tregun formal të punës. Ligji nr. 15/2017 për arsimin dhe formimin profesional²¹ dhe ndryshimet e fundit përforcojnë lidhjen me tregun e punës dhe zhvillimin e formave më fleksibël dhe më të orientuara drejt punës së Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), përfshirë sistemin dual. Ky kuadër mbështet masa që lidhen me promovimin e aksesit të barabartë në AFP-në me bazë shkolle dhe arsimin e dyfishtë, dhe mundësitë e të nxënimit gjatë gjithë jetës.

Në shëndetësi, kuadri kombëtar mbështetet në Ligjin nr. 10107/2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”,²² si edhe në **Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021–2030**, e cila promovon një qasje gjatë gjithë ciklit të jetës dhe përfshin zgjerimin e shërbimeve për shëndetin e nënës dhe fëmijës, vaksinimin, zhvillimin e fëmijës dhe kujdesin për shëndetin mendor.²³ Megjithatë, mbeten sfida, veçanërisht lidhur me aksesin dhe disponueshmërinë e shërbimeve në zonat rurale dhe të thella, nevojat specifike

¹⁶ Ligj nr. 22, datë 03.05.2018, “Për strehimin social”, i ndryshuar.

¹⁷ Ligj nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

¹⁸ VKM nr. 621, datë 22.10.2021, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

¹⁹ Ligj nr. 15, datë 13.03.2019, “Për nxitjen e punësimin”, i ndryshuar 24.7.2023.

²⁰ VKM nr. 173, datë 15.03.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030”.

²¹ Ligj nr. 15, datë 16.02.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

²² Ligj nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

²³ VKM nr. 210, datë 06.04.2022, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021–2030”.

të kategorive në nevojë, si dhe burimet financiare dhe njerëzore. Për romët dhe egjiptianët, prioritetet lidhen me kujdesin parësor, shëndetin riprodhues, vaksinimin, ndërmjetësimin komunitar dhe uljen e barrierave territoriale, financiare dhe administrative që kufizojnë përdorimin efektiv të shërbimeve. Ligji nr. 65/2023, për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, ofron mbështetje financiare për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 mijë lekë në muaj, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5 vjeçare.²⁴

Mbrojtja nga diskriminimi mbështeten në kuadrin kushtetues dhe legjisacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe në atë institucional përmes Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.²⁵ Ligji kundër diskriminimit është formalisht i përafuar me Direktivën 2000/43 dhe Direktivën 2000/78 të BE-së. Megjithatë, zbatimi i tij mbetet i pabarabartë.

Qasja në drejtësi dhe regjistrimi civil mbeten sfida të rëndësishme për qytetarët romë dhe egjiptianë, për shkak të mungesës së dokumentacionit, si certifikatat e lindjes apo kartat e identitetit, analfabetizmit dhe barrierave administrative. Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike” dhe krijimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, së bashku me ngritjen e shërbimeve lëvizëse të ndihmës juridike, përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të aksesit në drejtësi. Megjithatë mbeten ende sfida në zbatim.

Plani Kombëtar ndërvepron ngushtësisht me politikën dhe strategjitë horizontale që kanë ndikim ndërsektorial në përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve. Ndër dokumentet më relevante për zbatimin e tij përfshihen **Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030**,²⁶ **Strategjia Ndërsektoriale e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit 2024–2030**²⁷, **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030**,²⁸ **Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale 2024–2028**,²⁹ **Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2021–2026**,³⁰ **Plani Kombëtar i Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijët 2026-2030**,³¹ **Plani kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 (draft)**, si edhe **Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024–2030**.³² Këto dokumente politikash krijojnë sinergji ndërmjet përfshirjes sociale, mbrojtjes nga diskriminimi, drejtësisë, barazisë gjinore, mbrojtjes së fëmijëve dhe menaxhimit të migracionit, duke ndihmuar që Plani të zbatohet në mënyrë më të koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

²⁴ Ligj nr. 65, datë 21.7.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, ‘Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”.

²⁵ Ligj nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

²⁶ VKM nr. 787, datë 18.12.2024, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030”.

²⁷ VKM nr. 729, datë 13.12.2023, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030”.

²⁸ VKM nr. 400, datë 30.06.2021, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030”.

²⁹ VKM nr. 544, datë 28.08.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikave të përfshirjes sociale 2024-2028”.

³⁰ VKM nr. 659, datë 03.11.2021, “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2021–2026”.

³¹ VKM nr. 199, datë 26.03.2026, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Garancisë Evropiane për Fëmijët, 2026–2030”.

³² VKM nr. 271, datë 02.05.2024, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024–2026”.

Në tërësi, kuadri strategjik dhe rregullator ofron një bazë të konsoliduar, efektiviteti i tij varet nga koherenca ndërmjet politikave, mekanizmave të zbatimit, koordinimit ndërinstitucional, monitorimit dhe financimit të përshtatshëm.

1.3. Situata aktuale, arritjet rezultatet 2021-2025

PKVBPPRE 2030 u referohet pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”³³. Në kuptim të këtij Plani, grupi i synuar përfshin individët, familjet dhe komunitetet që vetëidentifikohen si pjesë e këtyre komuniteteve.

Zbatimi i Planit merr në konsideratë diversitetin e situatave sociale, ekonomike dhe territoriale, si dhe format e shumfishta të disavantazhit që prekin në mënyrë disproporcionale gratë, fëmijët, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet në varfëri. Në përputhje me Kornizën Strategjike të BE-së për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve 2020–2030³⁴ dhe Rekomandimin e Këshillit të 12 marsit 2021³⁵, PKVBPPRE 2030 mbështetet në një qasje të bazuar në të drejta, në evidencë dhe në pjesëmarrjen kuptimplotë të komuniteteve, duke trajtuar barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen si objektiva të ndërlydhura dhe reciprokisht përforcuese.

Sipas Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, në Shqipëri u regjistruan 9,813 persona që u vetëidentifikuan si romë dhe 12,375 persona, si egjiptianë, nga një popullsi banuese totale prej 2,402,113 banorësh. Së bashku përfaqësojnë rreth 0.9% të popullsisë (INSTAT, Cens 2023). Përqendrimi më i lartë vërehet në qarqet Tiranë, Fier, Korçë, Elbasan dhe Durrës, të cilat përbëjnë rreth 80% të popullsisë rome dhe rreth 69% të popullsisë egjiptiane të vetëidentifikuar. Megjithatë, të dhënat e disponueshme mbeten të kufizuara për analiza më të thelluara, pasi mungon një profil i plotë i disagreguar sipas grupmoshave dhe treguesve socialë, çka ndikon në mundësinë për përdorimin e tyre në shënjestrimin e saktë dhe efektivitetin e politikave.

Komisioni Evropian (2025) ka rekomanduar publikimin e të dhënave dhe analizave më të detajuara të Censit. Po ashtu, Avokati i Popullit (2025) thekson se shifrat zyrtare mbeten më të ulëta se vlerësimet e komuniteteve, për shkak të problematikave në regjistrimin civil dhe përditësimin të vendbanimit. Për sa i përket të dhënave administrative, ekzistenca e sistemeve paralele (Regjistri Elektronik Kombëtar për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror/RESHKSH, ROMALB dhe REVALB), krijon fragmentim dhe mbivendosje, duke kufizuar analizën e integruar dhe matjen e performancës së politikave.

Në periudhën 2021–2025, Shqipëria ka konsoliduar një kuadër politik të dedikuar për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve, si dhe ka vijuar zbatimin e masave në fusha prioritare si regjistrimi civil, arsimi, punësimi, mbrojtja sociale, strehimi dhe shëndetësia. Megjithatë, progresi mbetet i pabarabartë ndërmjet sektorëve dhe i pamjaftueshëm për të reduktuar ndjeshëm hendekun me pjesën tjetër të popullsisë. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2025) vëren se zbatimi i PKVBPPRE 2021–2025 dhe i

³³ Ligj nr. 96, datë 13.10.2017.

³⁴ Komisioni Evropian (2020) COM(2020) 620 final.

³⁵ Këshilli i Bashkimit Evropian (2021) Rekomandimi 2021/C 93/01.

angazhimeve të Poznanit kërkon të përmirësohen ndjeshëm. Kapacitetet institucionale mbeten të kufizuara, ndërsa nevojiten përpjekje të mëtejshme për të adresuar diskriminimin, antijipsizmin, segregimin, si dhe nxitjen e pjesëmarrjes së komuniteteve.

1.3.1. Varfëria ndër breza dhe mbrojtja sociale

Varfëria e komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri mbetet një sfidë strukturore dhe shumëdimensionale, e lidhur ngushtë me përjashtimin social, aksesin e kufizuar në shërbime publike dhe pabarazitë socio-ekonomike. Sistemi i mbrojtjes sociale ka një rol kyç në reduktimin e varfërisë, forcimin e kohezionit social, megjithatë efektiviteti i tij në mbulimin e këtyre komuniteteve mbetet i kufizuar. Kjo situatë ndikohet nga barriera të vazhdueshme strukturore dhe administrative, përfshirë mungesën e dokumentacionit civil, vështirësinë në regjistrimin dhe transferimin e vendbanimit, si dhe kompleksitetin e procedurave administrative në nivel vendor. Këtyre sfidave u shtohen edhe pabarazitë në kapacitetet institucionale të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe akses i kufizuar në shërbime të integruara sociale, duke ndikuar drejtpërdrejt në mbulimin dhe efektivitetin e skemave të mbrojtjes sociale.

Programi i Ndhmës Ekonomike (NE), mbetet instrumenti kryesor i mbështetjes financiare për familjet me të ardhura të ulëta. Sipas të dhënave të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), numri familjeve rome dhe egjiptiane përfituese të NE ishte 2,334 (6% e numrit total të përfituesve) në vitin 2025, ndërsa fondi i kushtëzuar 6% për familjet që mbeten jashtë pikëzimit ka rënë nga 507 përfitues në vitin 2021 në 97 në vitin 2024. Përtej përfitimeve në para, NE funksionon si mekanizëm hyrës për një sërë përfitimesh të tjera, përfshirë reduktimin apo përjashtimin nga tarifatat në çerdhe e kopshte, bursa për arsim parauniversitar, përjashtime nga tarifatat vjetore të shkollimit universitar, si dhe në shërbime shëndetësore publike falas. Kompensimi i energjisë elektrike u zgjerua ndjeshëm pas vitit 2020: nga 30 familje (2020) në 984 (2021), më pas 558 (2022), 562 (2023) dhe 740 (2024). Ndërsa për fëmijët në çerdhe dhe kopshte, përfituesit nga reduktimi/rimbursimi i tarifave u rritën deri në vitin 2023 (697 përfitues), por shënuan rënie në vitin 2024 (171) (MSHMS, 2026).

Një zhvillim i rëndësishëm është zbatimi i një strategjie (*exit strategy*) për **aktivizimin e përfituesve të ndhmës ekonomike në moshë pune**, duke synuar daljen e tyre nga skema pasive përmes masave të targetuara për punësim dhe riintegrim social. Që prej vitit 2022, është ngritur një mekanizëm referimi në nivel kombëtar, përmes 12 komisioneve rajonale trepalëshe, që lidhin shërbimet sociale, zyrat e punësimit dhe bashkitë. Ky mekanizëm mbështet profilizimin, referimin dhe ndjekjen e përfituesve, me synim integrimin në tregun e punës. Programi i Riintegritimit Social është pilotuar në vitin 2025 në Elbasan, Durrës dhe Gjirokastrë, duke përfshirë, ndërmjet kategorive të tjera, dhe 34 përfitues romë dhe egjiptianë, përmes këshillimit për punësim, vetëpunësim dhe formim profesional, në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile.³⁶

Në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, **Mekanizmi Kombëtar i Referimit** është funksional në të gjitha bashkitë, dhe në vitin 2024 janë mbështetur 107 raste dhe është mundësuar lëshimi i

³⁶ VKM nr. 401, datë 19.6.2024, "Për përcaktimin e procedurave, kritereve dhe rregullave për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegritimit social".

92 masave mbrojtëse (MSHMS, 2026). Në vitin 2024, 94 fëmijë në situatë rruge ose në rrezik trafikimi kanë përfituar shërbime mbrojtëse (MSHMS, 2026). Megjithatë, mbeten nevoja për forcimin e mëtejshëm të mekanizmave të parandalimit dhe ndërhyrjes së hershme.

Oferta e shërbimeve sociale për komunitetet rome dhe egjiptiane është zgjeruar nga 51 shërbime në vitin 2021 në 115 shërbime në 2025. Në total, 3,537 individë nga këto komunitete, përfshirë 2,128 gra, përfitojnë mbështetje (PNUD, 2025). Megjithatë, vetëm nëntë bashki kanë staf të dedikuar për shërbimet ndaj komuniteteve rome dhe egjiptiane (PNUD, 2025), ndërkohë që këto komunitete trajtohen si grup prioritar në rreth 35% të bashkive. Pavarësisht zgjerimit të shërbimeve, mbulimi real i nevojave mbetet i kufizuar, veçanërisht për të rinjtë. Shërbimet më të përdorura janë këshillimi, qendrat ditore dhe komunitare, të cilat mbulojnë vetëm rreth 11–12% të nevojave të identifikuar. Aktualisht në 35% e bashkive, grupet në nevojë nga komunitetet rome dhe egjiptiane, trajtohen si grupe prioritare.

Në vitin 2025, 156 fëmijë romë dhe egjiptianë raportohen si përfitues në institucionet e **përkujdesjes rezidenciale**, duke qenë të mbipërfaqësuar në këtë formë kujdesi (29.6%) dhe të nënpërfaqësuar në shërbimet komunitare dhe ato me bazë familjen. Kjo situatë reflekton si ekzistencën e disa praktikave dhe paragjyqimeve institucionale të vazhdueshme, ashtu edhe mungesën e ndërhyrjeve të mjaftueshme në terren (PNUD, 2025).

Programi “Bonusi i Bebes” ka shënuar rritje të numrit të përfituesve, nga 193 në vitin 2021 në 761 në vitin 2023, me një rënie të lehtë në 716 në vitin 2024 (MSHMS, 2026). Ndërsa ndikimi i tij në politikën demografike mbetet i kufizuar, ai mund të ketë një efekt pozitiv të tërthortë për komunitetet rome dhe egjiptiane, duke nxitur regjistrimin e lindjeve dhe përfshirjen e hershme në sistemet e mbrojtjes sociale.

Në tërësi, krahas zgjerimit të masave dhe shërbimeve, mbetet thelbësor forcimi i zbatimit të tyre në praktikë, përmes përmirësimit të menaxhimit të rastit, ndërhyrjeve në komunitet dhe ndërlidhjes më të fortë ndërmjet ndihmës financiare, përkujdesjes sociale dhe riintegritimit social e ekonomik.

1.3.2. Përballja me diskriminimin, përfshirja dhe antigjipsizmi

Antigjipsizmi dhe diskriminimi ndaj romëve dhe egjiptianëve vijojnë të përbëjnë një pengesë strukturore për barazinë, përfshirjen dhe kohezionin social. Edhe pse kuadri ligjor kundër diskriminimit është forcuar, zbatimi në praktikë mbetet i kufizuar. Faktorë si vonesat në miratimin e akteve nënligjore, kapacitetet e pamjaftueshme në nivel vendor dhe mungesa e të dhënave të standardizuara dhe të disagreguara sipas etnisë kufizojnë monitorimin, nxisin nënraportimin dhe vështirësojnë matjen e progresit. Në të njëjtën kohë, operacionalizimi i konceptit të antigjipsizmit në dokumentet politike dhe ligjore, përmes përkufizimeve të qarta, objektivave dhe indikatorëve të matshëm, mbetet i paplotë, ndërsa ndërhyrjet për ndërgjegjësim vijojnë të jenë të fragmentuara dhe jo të koordinuara në mënyrë të qëndrueshme.

Gjatë vitit 2024, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)** ka trajtuar 24 ankesa ku është pretenduar diskriminim për shkak të përkatësisë etnike, nga të cilat vetëm 3 raste kanë përfunduar me konstatim diskriminimi (KMD, 2024). Ankesat lidhen kryesisht me pengesa në aksesin në shërbime publike përmes portalit e-Albania, mospërfitimin nga bursat në arsimin

parauniversitar për familjet në nevojë dhe për pakicat rome e egjiptiane, si dhe me përdorimin e gjuhës së papërshtatshme në media.

Përpjekjet për forcimin e kapaciteteve institucionale kanë qenë të kufizuara dhe jo të njëtrajtshme. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) ka **hartuar një kurrikul trajnimi mbi antigjipsizmin dhe rolin e administratës publike** në adresimin e tij. Megjithatë, trajnimi i detyrueshëm për administratën publike dhe strukturat kryesore institucionale, përfshirë njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjyqësorin dhe strukturat e rendit, ende nuk është zbatuar në mënyrë sistematike.

Parandalimi dhe adresimi i gjuhës dhe krimeve të urrejtjes mbetet i fragmentuar. Po ashtu, fuqizimi i organizatave rome dhe egjiptiane për përfaqësim, advokim dhe monitorim mbetet i kufizuar, duke ndikuar llogaridhënien dhe zbatimin efektiv të politikave në terren. Në këtë kontekst, kërkohet një zhvendosje nga njohja formale e diskriminimit dhe antigjipsizmit drejt masave të strukturuar, të matshme dhe të koordinuara, që adresojnë diskriminimin strukturor dhe promovojnë përfshirjen reale të qytetarëve me përkatësi rome dhe egjiptiane në jetën publike.

Disa nga sfidat kryesore lidhur me varfërinë dhe mbrojtjen sociale:

- Akses i kufizuar efektiv në skemat e mbrojtjes sociale, i ndikuar nga mungesa e dokumentacionit civil dhe barrierat administrative..
- Mbështetje financiare dhe shërbime sociale jo gjithmonë të ndërlidhura në mënyrë efektive për riintegrim afatgjatë.
- Kapacitete të kufizuara në nivel vendor për menaxhimin e rasteve dhe ofrim të shërbimeve të integruara.
- Mbështetje e pamjaftueshme për alternativa me bazë familjen dhe komunitetin, veçanërisht për fëmijët.

1.3.3. Akses i pjesëmarrja

Pavarësisht përmirësimeve të viteve të fundit, regjistrimi civil dhe dokumentacioni bazë vijnë të përbëjnë një pengesë të rëndësishme për një pjesë të romëve dhe egjiptianëve, duke ndikuar drejtpërdrejt në aksesin në shërbime sociale, shëndetësore, arsimore dhe në mbrojtje sociale.³⁷ Këto vështirësi shfaqen veçanërisht në rastet e lindjeve jashtë sistemit shëndetësor, mosrespektimit të afateve ligjore për regjistrimin e të porsalindurve, lindjeve nga prindër nën moshë, lindjeve në lëvizje, si dhe në transferimin e vendbanimit për familjet që jetojnë në kushte informale ose pa dokumentacion të plotë banimi. Sfidat tjera lidhen me procedurat për vendosjen e atësisë ose amësisë, kostot e testeve të ADN-së dhe regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë vendit, veçanërisht kur dokumentacioni i lëshuar nga autoritetet e huaja është i paplotë ose nuk mund të legalizohet.³⁸

Gjatë periudhës 2021–2024, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për reduktimin e këtyre barrierave. Ndryshimet në ligjin nr. 10 129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” të vitit 2024 dhe në aktet nënligjore përkatëse kanë qartësuar procedurat për deklarimin e vendbanimit

³⁷ Avokati i Popullit (2025). Rekomandime lidhur me procesin e regjistrimit civil të pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane, 15 korrik 2025.

³⁸ MSHMS (2026). Raporti i Monitorimit të zbatimit të PKVBPPRE 2021-2025.

dhe kanë zgjeruar përdorimin e formave alternative të provës së banimit. Po ashtu, digjitalizimi i shërbimeve përmes platformës e-Albania ka reduktuar kostot dhe kohën e aplikimit. Sipas raportimeve, numri i fëmijëve të identifikuar si të paregjistruar ka rënë nga 650 raste në vitin 2021 në 402 raste në vitin 2023, duke reflektuar progres, por ende jo eliminim të plotë të problemit (MSHMS, 2026).

Në lidhje me aksesin në drejtësi, sistemi i ndihmës juridike falas ka zgjeruar mbulimin territorial, me 20 qendra funksionale, ndërsa 547 qytetarë romë dhe egjiptianë kanë përfituar ndihmë juridike parësore gjatë viteve 2021–2024 (MSHMS, 2026). Megjithatë, zbatimi në nivel vendor mbetet i pabarabartë dhe shpesh i kufizuar nga kërkesa administrative dhe procedura komplekse. Një nga barrierat kryesore lidhet me verifikimin e vendbanimit, i cili shpesh kërkon certifikata pronësie ose kontrata qiraje që shumë familje nuk i disponojnë. Po ashtu, kriteret e të ardhurave, kërkesat procedurale dhe nevoja për të provuar paraprakisht diskriminimin, ose për të siguruar urdhër mbrojtjeje në rastet e dhunës në familje, përpara përfitimit të ndihmës juridike falas, krijojnë barriera shtesë dhe dekurajojnë veçanërisht viktimat. Këto vështirësi përforcohen nga mungesa e dokumentacionit civil dhe nivelet e ulëta të shkrim-leximit, duke kufizuar përfshirjen efektive në proceset administrative dhe gjyqësore (PNUD, 2024).

Sfidat lidhen po ashtu me cilësinë e aksesit në drejtësi, përfshirë nivelin ende të pamjaftueshëm të tarifave për shërbimet e ndihmës juridike, që ndikon në tërheqjen e përfaqësimit ligjor cilësor, si dhe mungesën e masave lehtësuese për grupet më të cenueshme në kushtet e hartës së re gjyqësore Komisioni Evropian, 2025).

Në drejtim të pjesëmarrjes, Komisioni Evropian vëren se mundësitë për pjesëmarrje politike të pakicave mbeten të kufizuara, veçanërisht në nivel kombëtar. Në nivel vendor, përfaqësimi i romëve dhe egjiptianëve në këshillat bashkiakë mbetet i paqëndrueshëm, me prani në 6 bashki në vitin 2021, 8 në vitin 2022, 4 në vitin 2023 dhe 5 në vitin 2024 (MSHMS, 2026). Në këtë kontekst, krahas përmirësimit të aksesit në shërbime, kërkohet forcimi i mekanizmave të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes reale të këtyre komuniteteve në proceset vendimmarrëse.

Disa nga sfidat kryesore:

Aksesi në drejtësi dhe pjesëmarrja:

- Regjistrimi civil dhe dokumentacioni bazë vijojnë të kufizojnë aksesin në të drejta dhe shërbime.
- Procedura komplekse dhe kërkesa dokumentacioni që kufizojnë aksesin efektiv në ndihmën juridike falas.
- Barrierat gjuhësore, niveli i ulët i shkrim-leximit dhe mungesa e informacionit kufizojnë përfshirjen në proceset administrative dhe gjyqësore.
- Pjesëmarrje e kufizuar dhe e paqëndrueshme në vendimmarrje, veçanërisht në nivel vendor dhe kombëtar.

Diskriminimi dhe antigjipsizmi:

- Zbatim i kufizuar i kuadrit ligjor dhe mungesë operacionalizimi të antigjipsizmit në politika (indikatore, objektiva, monitorim).
- Nënraportim i rasteve dhe mungesë të dhënash të disagreguara për matjen e progresit.
- Trajnime dhe ndërgjegjësim institucional ende të pjesshme dhe jo sistematike.
- Fuqizim i kufizuar i organizatave romë dhe egjiptiane për përfaqësim dhe monitorim.

1.3.4. Strehimi

Strehimi për komunitetet rome dhe egjiptiane vijon të karakterizohet nga nivele të larta pasigurie dhe në kushte të papërshtatshme banimi, të lidhura me mungesën e titujve të pronësisë dhe ekspozimin ndaj rrezikut të dëbimit. Megjithëse Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social” i njeh këto komunitete si grupe prioritare, nevojat e tyre nuk reflektohen në mënyrë të qëndrueshme në planifikim, mbledhjen e të dhënave dhe monitorim. Mbipopullimi i banesave prek rreth dy në tre fëmijë, ndërsa barrierat e dokumentacionit, financiare dhe digjitale vijnë të kufizojnë aksesin në strehim social.

Në vitin 2024, 38 bashki kanë miratuar plane për strehimin social. Në vitin 2025, vetëm 30 bashki paraqitën kërkesa për financim për subvencionet e strehimit, ndërsa 52 bashki aplikuan për programe për përmirësimin e kushteve të banimit, pavarësisht shkallës së gjerë të nevojës në të gjithë vendin (MSHMS, 2026).

Kuadri ligjor parashikon masa mbrojtëse, përfshirë ndalimin e dëbimeve pa ofruar alternativa të përshatshme strehimi, si dhe përcakton që jo më pak se 5% e përfituesve në çdo program strehimi të jenë aplikantë nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Po ashtu, janë ndërmarrë hapa për përshpejtimin e procesit të legalizimit të vendbanimeve informale dhe zbatimin e Ligjit nr. 20/2020, i cili parashikon kompensim financiar ose strehim alternativ në rastet kur legalizimi nuk është i mundur.

Nga të dhënat administrative duket se familjet rome dhe egjiptiane kanë përfituar në mënyrë më të qëndrueshme nga programet e strehimit social, por mbeten të kufizuara në aksesin ndaj instrumenteve që kërkojnë kapacitet financiar, si subvencionimi i interesave të kredive. Në programin e subvencionimit të qirasë, pjesëmarrja e tyre ka peshë relative më të lartë e tendencën më pozitive - 15.9% në vitin 2023 në rreth 20.5–20.6% në vitet 2024–2025. Në programin për përmirësimin e kushteve të banimit, përqindja mbetet më e ulët dhe më e luhatshme, nga 10.8% në 2023, në 8.7% në 2024 dhe 10.1% në 2025, çka sugjeron se nevojat për ndërhyrje në banesë janë të pranishme, por mbulimi nuk është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Ndërkohë, granti i menjëhershëm ka numër shumë të vogël përfituesish në total e përqindjet ndryshojnë ndjeshëm nga viti në vit. Megjithatë, rritja nga 3.3% për vitin 2023 në 27% në 2024 dhe 17.6% në 2025 tregojnë se ky instrument mund të jetë i rëndësishëm për raste emergjente, por me ndikim të kufizuar për shkak të volumit të ulët. Në tërësi, të dhënat sugjerojnë se familjet rome dhe egjiptiane përfitojnë më shumë nga programet që nuk kërkojnë aftësi paguese. Përrjashtimi praktik nga subvencionimi i interesave të kredive thekson nevojën për instrumente më të përshatshme, garanci sociale ose zgjidhje alternative strehimi për familjet me të ardhura të ulëta dhe punësim informal.

Familjet rome dhe egjiptiane përballen me vështirësi të shumta në akses, përfshirë diskriminim në tregun e qirasë dhe mungesës së dokumentacionit formal të banimit apo regjistrimit. Edhe pse legjislati parashikon lehtësime për familjet e paregjistruara përmes konfirmimit të qëndrimit të tyre nga bashkitë, zbatimi i këtyre dispozitave mbetet i kufizuar. Diskrecioni i pushtetit vendor në aplikimin e kriterëve të përfitimit, i kombinuar me mungesën e një formule kombëtare të standardizuar vlerësimi, krijon pabarazi territoriale dhe akses të pabarabartë.

Në vitin 2025, proces i legalizimit të pronës për familjet rome dhe egjiptiane ka marrë një shtysë të re pas miratimit të vendimit të këshillit të ministrave 435/2024 dhe nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe pushtetit vendor. Në këtë kuadër, janë ngritur zyra të posaçme në Fier dhe Vlorë për të mbështetur familjet në procesin e legalizimit. Gjatë vitit 2025, janë trajnuar 51 përfaqësues vendorë dhe janë asistuar drejtpërdrejt 65 familje rome në këto procese (MSHMS, 2026).

Disa nga sfidat kryesore:

- Akses i kufizuar në programet e strehimit për shkak të barrierave të dokumentacionit, financiare dhe administrative.
- Zbatim i pabarabartë në nivel vendor dhe mungesë e standardizimit në përzgjedhjen e përfituesve.
- Segregim hapësinor dhe kushte të dobëta jetese që vazhdojnë të ndikojnë në përjashtimin social.
- Progres i ngadaltë në legalizimin e vendbanimeve informale dhe në sigurimin e alternativave të qëndrueshme të strehimit.

1.3.5. Arsimi

Arsimi për fëmijët dhe të rinjtë me përkatësi në komunitetet rome dhe egjiptiane mbetet një nga fushat ku pabarazitë me pjesën tjetër të popullsisë shfaqen që në moshë të hershme dhe vijnë përgjatë ciklit shkollor (Komisioni Evropian, 2025). Megjithatë në vitet e fundit janë ndërmarrë masa për lehtësimin e aksesit në arsim, nivelet e regjistrimit, vijueshmërisë, përfundimit të shkollës dhe të alfabetizimit mbeten më të ulëta se mesatarja kombëtare. Te të rinjtë romë (15-29 vjeç), niveli i analfabetizimit arrin në 35%, veçanërisht te vajzat dhe gratë. Ndërkohë, të rinjtë romë dhe egjiptianë të moshës 10–29 vjeç kanë 30 herë më shumë gjasa të jenë analfabetë dhe më në rrezik për të mbetur jashtë sistemit arsimor krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre (INSTAT, 2025).

Pjesëmarrja në arsimin parashkollor mbetet veçanërisht e ulët për fëmijët e këtyre komuniteteve. Sipas Censit 2023, vetëm 51.2% e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç në nivel kombëtar frekuentojnë një institucion parashkollor, ndërsa kjo përqindje zbritet në 38.3% për fëmijët egjiptianë dhe në 26.5% për fëmijët romë (INSTAT, 2025). Si rezultat, rreth tre në pesë fëmijë romë dhe egjiptianë mbeten jashtë arsimit parashkollor, duke ndikuar negativisht në zhvillimin e hershëm, përgatitjen për shkollë dhe mundësitë e barabarta në vijim të edukimi arsimor. Mbështetja përmes reduktimit ose rimbursimit të tarifave për çerdhe dhe kopshte u rrit deri në 697 përfitues në vitin 2023, por ra në 171 në vitin 2024 (MSHMS, 2026).

Përjashtimi nga arsimi nuk lidhet vetëm me vështirësitë ekonomike dhe mungesën e dokumentacionit civil, por edhe me nivelin e ulët të ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme, si dhe me praninë e stigmatizimit dhe paragjyqimeve etnike. Në shumicën e bashkive mungojnë kuota apo mekanizma të dedikuar për përfshirjen e fëmijëve me përkatësi në komunitetet rome dhe egjiptiane në institucionet parashkollore. Ndërkohë, shërbimet për fëmijët pa kujdes prindëror mbulojnë vetëm 45% të nevojave, ndërsa më shumë se gjysma e bashkive (51%) raportojnë mungesë të këtyre shërbimeve (PNUD, 2025).

Tabela 1. Regjistrimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në sistemin arsimor publik dhe privat, sipas nivelit arsimor.

Numri i nxënësve të regjistruar (publik dhe privat)	2020-2021	2021-2022	2022-2023	2023-2024
Arsimi parashkollor				
Total	71,332	72,384	69,750	66,711
R&E	2,446 (3.4%)	2,384 (3.3%)	2,153 (3.1%)	2,147 (3.2%)
Arsimi bazë				
Total	28,6486	27,8138	26,7275	25,8072
R&E	11,419 (4%)	10,933 (3.9%)	10,488 (3.9%)	9,503 (3.7%)
Arsimi i mesëm i lartë				
Total	88,965	85,188	79,032	75,348
R&E	1,010 (1.1%)	1,018 (1.2%)	858 (1.1%)	858 (1.1%)

Burimi: Vjetari Statistikor për Arsimin 2020-2024

Të dhënat tregojnë një rënie të përgjithshme të regjistrimeve. Sipas të dhënave të publikuara në vjetarin statistikor të Ministrisë së Arsimit, numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor dhe të detyrueshëm në vitin akademik 2021-2022 ka qënë 13,317 (MA, 2025). Nga të dhënat administrative, rezulton që numri i regjistrimeve në vitin 2024-2025 ka rënë në 9,377 (MSHMS, 2026). Kjo rënie ka ndodhur pavarësisht zgjerimit të disa masave mbështetëse, si tekstet falas, transporti dhe bursa. Përfituesit nga transporti falas janë rritur nga 464 në vitin 2022 në 600 në vitin 2024. Ndërkohë, bursat në arsimin parauniversitar kanë shënuar rritje gjatë periudhës 2022-2024, duke arritur në 649 përfitues në vitin 2024, pavarësisht luhatjeve ndërmjet viteve (MSHMS, 2026).

Po ashtu, pjesëmarrja në arsimin e mesëm të lartë mbetet e ulët dhe e karakterizuar nga pabarazi. Vetëm 15% e të rinjve romë dhe egjiptianë e përfundojnë këtë nivel, krahasuar me 75% në nivel kombëtar. Modelet gjinore janë të ndërthurura, me përmirësim të pjesëmarrjes së vajzave, ndërsa regjistrimi i djemve ka shënuar rënie (IIEP-UNESCO, 2024). Faktorë si varfëria, kostot e tërthorta të shkollimit dhe martesat e hershme, vijnë të ndikojnë në përjashtim.

Masat për mbështetjen e të nxënësve dhe qëndrimin në shkollë ende nuk kanë prodhuar rezultate të qëndrueshme. Pjesëmarrja në programe mbështetëse pas shkollës ka pësuar rritje nga zbritur nga 505 në vitin shkollor 2021-2022 në 678 përfitues në vitin shkollor 2024-2025 (të dhëna administrative, MA, 2026). Ndërkohë, megjithëse rastet e braktisjes shkollore kanë shënuar rënie, ato mbeten ende të konsiderueshme. Konkretisht, numri i braktisjeve ra nga 724 raste në vitin 2022 në 591 raste në vitin 2024, ndërsa numri i nxënësve të rikthyer në shkollë mbeti pothuajse i pandryshuar, me 132 raste si në vitin 2023 ashtu edhe në vitin 2024 (MSHMS, 2026)³⁹. Kjo tregon se hendeku vijon të mbetet i lartë, veçanërisht për djemtë romë (MSHMS, 2026). Nxënësit romë priren të braktisin shkollën që në arsimin fillor, duke çuar në një rënie graduale të regjistrimeve deri në përfundim të arsimit të detyrueshëm. (IIEP-UNESCO, 2024).

Të dhënat e Bankës Botërore nga viti 2017 tregojnë se pabarazitë arsimore për fëmijët romë dhe egjiptianë kanë qënë të theksuara (Banka Botërore, 2019). Rreth 19% e nxënësve romë dhe egjiptianë ndiqnin shkolla të segreguara, ndërsa rezultatet e tyre në vlerësimet kombëtare ishin dukshëm nën mesataren. Në testimet e arsimit fillor, ata arrinin mesatarisht rreth 29 pikë, krahasuar me 45 pikë në

³⁹ Të dhëna administrative të nxjerra nga ROMALB për raportimin e PKVBPPRE 2021–2025 (MSHMS, 2026). Të dhënat administrative të MA të disagreguara sipas etnisë nuk janë të disponueshme

nivel kombëtar. Megjithatë, duke qenë se këto statistika i përkasin vitit 2017, nevojiten analiza më të përditësuara për të pasqyruar situatën aktuale, sfidat ekzistuese dhe progresin. Mungesa e të dhënave të disagreguara pas vitit 2017, konfirmon nevojën e ngutshme për sistemin kombëtar të monitorimit të parashikuar në objektivin 1.2.

Ndërlidhja midis arsimit dhe mbrojtjes sociale është përmirësuar përmes forcimit të mekanizmave të referimit. Në vitin 2024, u referuan 891 familje, prej të cilave 570 rome dhe 321 egjiptiane, kryesisht në bashkitë Shkodër, Elbasan, Lushnjë dhe Lezhë (MSHMS, 2026). Kjo tregon një përmirësim të koordinimit ndërinstytucional, por dhe nivele të larta të nevojave që kërkojnë ndërhyrje të vazhdueshme.

Në drejtim të arsimit gjithëpërfshirës janë ndërmarrë disa hapa për përmirësimin e ndërmjetësimit dhe përfshirjes, përfshirë angazhimin e mediatorëve dhe mësuesve nga komunitetet rome dhe egjiptiane (28⁴⁰ dhe 100⁴¹ respektivisht). Megjithatë, këto ndërhyrje mbeten të kufizuara në shkallë dhe shpesh të varura nga mbështetja e donatorëve, duke kërkuar institucionalizim dhe financim të qëndrueshëm.

Janë ndërmarrë gjithashtu hapa për përfshirjen e historisë dhe kulturës rome në kurrikulën arsimore, megjithatë nevojiten përpjekje të mëtejshme për forcimin e kapaciteteve të stafit arsimor në fushën e përfshirjes, diversitetit dhe antigjipsizmit. Në dy shkolla⁴² të Elbasanit gjuha rome është përfshirë në programin mësimor. Pjesëmarrja e prindërve me përkatësi në komunitetet rome dhe egjiptiane në bordet e shkollave mbetet minimale, ndërsa rastet e segregimit (KMD, 2024) dhe përfaqësimi i kufizuar tregojnë se sfidat që lidhen me përfshirjen dhe diskriminimin vijojnë të jenë të pranishme. Në këtë kontekst, sistemi arsimor duhet të forcohet edhe si hapësirë për promovimin e diversitetit, respektit të ndërsjellë dhe kohezionit social.

Disa nga sfidat kryesore:

- Pjesëmarrje shumë e ulët në edukimin në fëmijërinë e hershme (EKFH), me pasoja në zhvillimin e mëvonshëm arsimor dhe mundësitë e barabarta në shkollim.
- Braktisje e hershme e shkollës dhe pjesëmarrje e ulët në arsimin e mesëm të lartë, veçanërisht te djemtë që i përkasin komunitetit rom.
- Pabarazi të theksuara në arritjet arsimore dhe nivele të larta analfabetizmi, sidomos te gratë me përkatësi në komunitetin rom.
- Masa mbështetëse jo gjithmonë të qëndrueshme dhe ndërhyrje të kufizuara në shkallë për përfshirje dhe dialog ndërkulturor.

1.3.6. Punësim dhe formim profesional

Pavarësisht përpjekjeve për zgjerimin e programeve të punësimit, integrimi i romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës mbetet i kufizuar. Mungojnë të dhënat e plota të disagreguara për këto komunitete në tregun e punës, ndërkohë që vlerësimet ekzistuese tregojnë nivele të ulëta të punësimit, pavarësisht zgjerimit të shërbimeve të punësimit, programeve aktive dhe përpjekjeve për ndërmjetësim institucional.

Gjatë periudhës 2021–2025, janë zgjeruar shërbimet e këshillimit dhe orientimit të karrierës, si dhe janë forcuar mekanizmat e referimit ndërmjet strukturave të punësimit dhe mbrojtjes

⁴⁰Ministria e Arsimit. Të dhëna administrative. 2025.

⁴¹ Komisioni Evropian, (2025). "Albania 2025 Report", Commission Staff Working Document, SWD (2025)

⁴² Shkollat 9 vjeçare "Hamit Mullisi" dhe "Abdyl Paralloi".

sociale. Megjithatë, numri i përfituesve romë dhe egjiptianë nga këto shërbime është ulur nga 7,198 në vitin 2022, në rreth 5,987 në vitin 2025 (9% e përfituesve totalë) (AKPA, 2025).

Profilizimi i punëkërkuarve tregon një nivel të lartë vulnerabiliteti. Konkretisht, rreth 90% e të regjistruarve vlerësohen me rrezik të lartë për papunësi afatgjatë dhe përballen me barriera të shumta për integrim në tregun e punës. Rreth 63% nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm, 34% janë përfitues të ndihmës ekonomike dhe rreth 30% janë mbi 50 vjeç (AKPA, 2025)

Në vitin 2025, rreth 887 romë dhe egjiptianë u punësuan nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit (3.9% e totalit), duke shënuar një rritje krahasuar me 2022, (497, ose 1.9% e totalit). Po ashtu, 428 romë dhe egjiptianë morën pjesë në programet e nxitjes së punësimit (15.2% e përfituesve) (AKPA, 2025).

Sa i përket formimit profesional, 356 romë dhe egjiptianë morën pjesë në kurse e formimit profesional publik (2.9% e totalit) (AKPA, 2025). Megjithatë, mungojnë të dhënat e disagreeguara për certifikimin, ndërsa nuk raportohet pjesëmarrje në kurse të avancuara, si ato në fushën e teknologjisë së informacionit (IT). Aksesit në formim profesional mbetet i kufizuar, pasi kushtet e pranimit në këto oferta trajnimi kërkojnë që aplikanti të ketë përfunduar arsimin e detyrueshëm, të cilin një pjesë e konsiderueshme e këtij grupi nuk e plotëson.

Tabela 1. Treguesit kryesorë të shërbimeve dhe programeve të punësimit

	2022	2023	2024	2025
Numri i punëkërkuarve të regjistruar dhe profilizuar në zyrat e punës				
Total	76,879	76,580	69,641	67,056
R&E	7,198 (9.4%)	6,863 (9%)	6,111 (8.8%)	5,987 (8.9%)
Numri i të punësuarve nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit dhe këshillimit për punësim				
Total	26,808	27,651	27,497	22,538
R&E	497 (1.8%)	1,032 (3.7%)	1,086 (3.9%)	887 (3.9%)
Numri i pjesëmarrësve në programet e nxitjes së punësimit				
Total	4,344	2,635	2,465	2,816
R&E	304 (7%)	194 (7.4%)	305 (12.4%)	428 (15.2%)
Numri i pjesëmarrësve në kurse të formimit profesional publik dhe privat				
Total	14,917	10,547	9,128	12,338
R&E	255 (1.7%)	228 (2.2%)	200 (2.2%)	356 (2.9%)

Burimi: Analiza Vjetore e AKPA 2022-2025

Niveli i punësimit mbetet shumë i ulët, ndërsa sfidat lidhen me nivelin e ulët të arsimit dhe aftësive, informalitetin, diskriminimin, përfaqësimin e ulët në administratën publike dhe kapacitetet e kufizuara institucionale për ofrimin e shërbimeve të përshtatura. Po ashtu, një masë e planifikuar për angazhimin e 12 mediatorëve romë dhe egjiptianë pranë zyrave të

punësimi nuk është zbatuar, duke kufizuar regjistrimin proaktiv, ndërmjetësimin dhe orientimin në komunitet.

Të dhënat e disponueshme tregojnë se 52% e të rinjve romë të moshës 16–24 vjeç janë jashtë punësimi, arsimit ose formimit profesional (NEET), ndërsa 37% raportojnë përvoja diskriminimi gjatë kërkimit të punës (Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2024). Edhe pse Shqipëria ka filluar zbatimin e skemës së Garancisë Rinore, më pak se 7% e përfituesve janë të rinj romë dhe egjiptianë.⁴³

Një pjesë e konsiderueshme e tyre vijon të jetë e angazhuar në sektorin informal, përfshirë aktivitete si grumbullimi i materialeve të riciklueshme ose tregtia ambulante. Këto forma punësimi sigurojnë të ardhura minimale për mbijetesë, por nuk ofrojnë mbrojtje sociale dhe kontribuojnë në ciklin e përjashtimit social. Në këtë kontekst, sfida kryesore mbetet kalimi nga pjesëmarrja në masa aktive drejt rezultateve të qëndrueshme në punësim formal, fuqizim ekonomik dhe përfaqësim më të mirë të romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës dhe në institucionet publike.

1.3.7. Shëndetësia

Akresi i qytetarëve me përkatësi në komunitetet romë dhe egjiptiane në shërbimet shëndetësore vijon të ndikohet nga një sërë faktorësh strukturorë dhe institucionalë, të cilët kufizojnë mundësinë e tyre për të përfituar shërbime të plota dhe në kohë. Gjatë viteve 2021–2024, reformat ligjore kanë synuar përmirësimin e funksionimit të sistemit, forcimin e kujdesit parësor pranë vendbanimit, standardizimin e shërbimeve, si dhe zhvillimin dhe forcimin e sistemeve elektronike të informacionit shëndetësor. Në të njëjtën kohë, janë zgjeruar disa masa mbështetëse për familjet në nevojë, përfshirë mbështetjen financiare për gratë e papuna me fëmijë dhe familjet me të ardhura të ulëta. Megjithatë, romët dhe egjiptianët vijojnë të përballen me pengesa të konsiderueshme në aksesin real në shërbimet shëndetësore. Këto lidhen kryesisht me punësimin informal, mosregjistrimin si të papunë, mungesën e kartës shëndetësore, kushtet e pafavorshme të jetesës, distancën nga qendrat shëndetësore dhe përvoja të diskriminimit.

Një tregues i qartë i këtyre pabarazive është niveli i ulët i vaksinimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë krahasuar me mesataren kombëtare. Po ashtu, gratë nga këto komunitete përballen me vështirësi të veçanta në aksesin në shërbimet e shëndetit riprodhues. Të dhënat tregojnë se 66% e fëmijëve nga familje me të ardhura të ulëta, 46% e fëmijëve në zonat rurale dhe 51% e fëmijëve romë dhe egjiptianë raportojnë pengesa në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor (Mone, et.al., 2023).

Nga ana tjetër, periudha 2021–2024 reflekton disa përmirësime në përdorimin e shërbimeve bazë dhe parandaluese. Numri i grave dhe vajzave romë dhe egjiptiane që përfituan barna falas dhe ekzaminime gjatë shtatzënisë u rrit nga 1,273 në vitin 2021 në 3,833 në vitin 2024 (MSHMS, 2026). Gjithashtu, numri i punonjësve të trajnuar për barazinë në ofrimin e shërbimit dhe punën me grupet vulnerabël u rrit nga 309 në vitin 2021 në 555 në vitin 2023, me 494 të trajnuar në vitin 2024. Një rol të rëndësishëm kanë luajtur ekipet mjekësore lëvizëse, të cilat kanë ofruar shërbime për 46,372 persona në vitin 2021, 48,667 në vitin 2022,

⁴³ Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (2024). Progres raporti i zbatimit të Planit të Garancisë Rinore 2024.

53,017 në vitin 2023 dhe 52,429 në vitin 2024, me mbulim relativisht të balancuar mes dy komuniteteve (MSHMS, 2026).

Megjithatë, progresi mbetet i pjesshëm dhe i pabarabartë. Në disa fusha vërehen luhajtje ose rënie, veçanërisht në aktivitetet informuese për shëndetin riprodhues dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme, si dhe në numrin e përfituesve nga kontrollet dhe diagnozat përkatëse.

Një boshllëk i rëndësishëm mbetet mungesa e rolit të ndërmjetësit shëndetësor ose edukatorit të shëndetit, si pasojë e mungesës së një kuadri të posaçëm rregullator që e përcakton dhe e institucionalizon këtë funksion. Si rezultat, nuk raportohet trajnim apo angazhim i romëve dhe egjiptianëve në këtë funksion (MSHMS, 2026). Mungesa e mediatorëve shëndetësorë, veçanërisht për gratë rome që nuk zotërojnë mirë gjuhën shqipe, kufizon më tej aksesin në shërbimet e shëndetit riprodhues dhe në institucionet e kujdesit shëndetësor. Punësimi i romëve dhe egjiptianëve në sistemin publik të shëndetësisë ka shënuar një rritje të lehtë, nga 140 të punësuar në vitin 2021 në 155 të punësuar në 2024 (MSHMS, 2026).

Në tërësi, përmirësimet në kuadrin ligjor, trajnimin e stafit, ekipet lëvizëse dhe zgjerimin e disa shërbimeve kanë kontribuar në rritjen e aksesit në shërbime. Megjithatë, barrierat strukturore dhe boshllëqet institucionale vazhdojnë të kufizojnë përdorimin efektiv dhe të barabartë të këtyre shërbimeve nga romët dhe egjiptianët.

Disa nga sfidat kryesore:

- Akses i kufizuar efektiv në shërbime për shkak të pengesave strukturore, përfshirë mungesën e sigurimit shëndetësor, dokumentacionit civil dhe distancën nga shërbimet.
- Pabarazi në rezultatet shëndetësore, veçanërisht në vaksinim dhe shëndetin riprodhues, që prekin më shumë gratë dhe fëmijët nga komunitetet rome dhe egjiptiane.
- Mungesë e ndërmjetësimit shëndetësor, për shkak të mungesës së kuadrit rregullator dhe institucionalizimit të rolit të mediatorëve.
- Zbatim i pjesshëm dhe i pabarabartë i ndërhyrjeve, me luhajtje në aktivitetet parandaluese dhe informuese.
- Kapacitete të kufizuara për shërbime të përshtatura, përfshirë mungesën e stafit të trajnuar dhe përfaqësimit të komuniteteve në sistemin shëndetësor.

1.3.8. Vlerësimi nga Komisioni Evropian

Vlerësimi i Komisionit Evropian thekson se Shqipëria ka konsoliduar një kuadër politik e ligjor për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve, por rezultatet konkrete mbeten ende të kufizuara. Në këtë kuadër, progresi i mëtejshëm kërkon forcimin e zbatimit, sigurimin e financimit të qëndrueshëm, përmirësimin e koordinimit institucional dhe fuqizimin e mekanizmave të monitorimit të politikave ekzistuese.

Në fushën e politikave sociale (**Kapitulli 19**), Shqipëria vlerësohet si *'mesatarisht e përgatitur'*. Komisioni thekson nevojën për përafrim të mëtejshëm me *acquis*, forcim të kapaciteteve administrative dhe inspektuese, si dhe rritjen të financimit dhe cilësisë së shërbimeve sociale.

Për romët dhe egjiptianët, niveli i punësimit mbetet i ulët, duke kërkuar masa më të synuara për përfshirje në tregun e punës dhe adresimin e diskriminimit. Miratimi i këtij PKVBPPRE adreson një nga kushtet përmbyllëse të Kapitullit 19 “Politikat Sociale dhe të Punësimit”, sipas Qëndrimit të Përbashkët të BE-së për Grupkapitullin III, miratuar më 08.05.2025.

Në fushën e të drejtave themelore (Kapitulli 23), kuadri ligjor dhe institucional vlerësohet përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane, por zbatimi mbetet i dobët dhe i kufizuar nga burime të pamjaftueshme. Sfida kryesore lidhet me diskriminimin, antigjipsizmin dhe segregimin, si dhe me kapacitetet e kufizuara institucionale për koordinimin dhe monitorimin e politikave. Përmirësimi kërkon një rritje të burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe forcimin e sistemeve të mbledhjes së të dhënave dhe llogaridhënies.

Në fushën e arsimit dhe kulturës (Kapitulli 26), janë shënuar zhvillime pozitive, përfshirë përditësimin e kurrikulës, rritjen e investimeve dhe përmirësimin në arsimin dhe formimin parauniversitar. Megjithatë, pabarazitë në akses, segregimi shkollor dhe normat e larta të braktisjes së shkollës vijojnë të pengojnë arritjen e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe cilësor. Forcimi i mëtejshëm i sistemit kërkon zgjerimin e praktikave gjithëpërfshirëse, eliminimin e segregimit dhe forcimin e bashkërendimit ndërmjet nivelit qendror dhe vendor.

PJESA 2: QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

2.1. Vizioni dhe misioni i dokumentit

Vizioni

“Një shoqëri shqiptare gjithëpërfshirëse dhe e barabartë, me kohezion social, ku romët dhe egjiptianët gëzojnë të drejta të barabarta, jetojnë me dinjitet dhe marrin pjesë plotësisht në jetën ekonomike, sociale, kulturore dhe publike, pa u përballur me varfëri, diskriminim, segregim apo pengesa në aksesin në shërbime dhe mundësi.”

Misioni

Qeveria shqiptare angazhohet të udhëheqë dhe koordinojë një qasje ndërsektoriale për reduktimin e pabarazive strukturore që prekin romët dhe egjiptianët. Kjo realizohet përmes masave të integruara në arsim, punësim, strehim, shëndetësi, mbrojtje sociale, drejtësi, regjistrim civil, si dhe përmes forcimit të pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje dhe rritjes së llogaridhënies institucionale për rezultate të matshme.

Parimet dhe vlerat

PKVBPPRE 2030 udhëhiqet nga parimet e mëposhtme, në përputhje të plotë me Kornizën Strategjike Evropiane⁴⁴ dhe Deklaratën e Poznanit:

Barazia dhe drejtësia sociale. Lufta kundër diskriminimit dhe antigjipsizmit përbën një prioritet ndërsektorial në të gjitha politikatat, duke garantuar akses në të drejta, shërbime dhe mundësi të barabarta për romët dhe egjiptianët.

Pjesëmarrja dhe fuqizimi. Sigurohet pjesëmarrje domethënëse e romëve dhe egjiptianëve në të gjitha fazat e hartimit dhe zbatimit të politikave. Promovohet fuqizimi i komuniteteve dhe shoqërisë civile, si dhe ndërtimi i besimit ndërmjet institucioneve dhe komuniteteve.

Respektimi i diversitetin dhe qasja ndërsektoriale. Plani merr në konsideratë diversitetin brenda komuniteteve, duke adresuar ndërthurjen e faktorëve si gjinia, mosha, aftësia e kufizuar dhe statusi socio-ekonomik, përmes një qasjeje të ndjeshme ndaj pabarazive të shumëfishta.

Qasje e kombinuar – universale dhe e synuar. Politikatat gjithëpërfshirëse kombinohen me masa të synuara për të siguruar që shërbimet publike të jenë të aksesueshme për të gjithë, ndërkohë që ofrojnë mbështetje shtesë për romët dhe egjiptianët.

Vendimmarrje e bazuar në evidenca dhe llogaridhënie. Vendosja e objektivave të matshëm dhe përmirësimi i mbledhjes së të dhënave janë thelbësore për monitorimin e progresit, rritjen e transparencës dhe forcimin e llogaridhënies.

2.2. Qëllimet e politikës dhe objektivat strategjike

PKVBPPRE 2030 synon reduktimin e hendekut të barazisë midis qytetarëve me përkatësi rome dhe egjiptiane dhe pjesës tjetër të popullsisë, përmes përmirësimit të aksesit në të drejta, shërbime e mundësi. Plani përkthen vizionin e politikës në qëllime të matshme dhe objektiva strategjike, të organizuara në fusha prioritare dhe format e përjashtimit. Në këtë kuadër, plani

⁴⁴ Komisioni Evropian, 2020, COM(2020) 620 final.

synon të forcojë qasjen ndërsektoriale, koordinimin institucional dhe llogaridhënien për rezultate konkrete në nivel kombëtar dhe vendor.

Fusha Prioritare 1: Arsimi dhe nxitja e dialogut ndërkulturor

Qëllimi i Politikës 1: *Rritja e aksesit, pjesëmarrjes dhe përfundimit të arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës, si dhe promovimin e dialogut ndërkulturor.*

Indikatorë suksesi: Rritja e aksesit në të gjitha nivelet e arsimit deri në 2030 (si më poshtë).

Në këtë fushë, qëllimi i politikës është të rritet barazia e mundësive për romët dhe egjiptianët në aksesin, vijimësinë dhe përfundimin e arsimit në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, duke siguruar njëkohësisht cilësi, gjithëpërfshirje dhe mbështetje institucionale. Ky qëllim synon jo vetëm rritjen e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe të lartë, por edhe përmirësimin e kushteve për sukses arsimor, reduktimin e segregimit dhe diskriminimit, si dhe fuqizimin e rolit të arsimit në promovimin e njohjes, respektit dhe dialogut ndërkulturor. Deri në vitin 2030, synohet që mbi 50% e fëmijëve romë dhe egjiptianë të moshës 3–6 vjeç të regjistrohen në institucionet e arsimit parashkollor, mbi 95% e fëmijëve të regjistrohen dhe të përfundojnë arsimin fillor dhe rritje progresive e regjistrimeve dhe përfundimit të arsimit të mesëm.

Në kuadër të këtij qëllimi të Politikës 1 janë përcaktuar tre objektiva specifike, të cilët synojnë rritjen e aksesit në arsim, përmirësimin e gjithëpërfshirjes dhe fuqizimin e përfaqësimit kulturor dhe shoqëror të komuniteteve romë dhe egjiptiane.

Objektivi specifik	Indikatorët e performancës
Objektivi specifik 1.1: Rritja e aksesit, pjesëmarrjes dhe përfundimit të arsimit për fëmijët, nxënësit dhe studentët romë dhe egjiptianë në të gjitha nivelet.	Mbi 50% e fëmijëve 3-6 vjeç të regjistruar në institucionet e arsimit parashkollor. Mbi 95% e fëmijëve R/E të regjistruar dhe përfundojnë arsimin fillor. (Deklarata e Poznan) Rritje progresive e fëmijëve R/E të regjistruar dhe përfundojnë të arsimin e mesëm. (Deklarata e Poznan)
Objektivi specifik 1.2: Përmirësimi i barazisë dhe gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor për romët dhe egjiptianët dhe reduktimit të segregimit dhe diskriminimit.	0% e fëmijëve nga 6 deri në 15 vjeç në shkolla ku të gjithë nxënësit janë romë ose egjiptianë, deri në 2030. Ulje e përqindjes së fëmijëve në klasa ku shumica e nxënësve janë romë ose egjiptianë, nga 23–24% (FRA, 2024) në < 20% (2030).
Objektivi specifik 1.3: Promovimi i njohjes, përfaqësimit dhe dialogut ndërkulturor për romët dhe egjiptianët në arsim dhe hapësirën publike.	Të paktën 10 projekte të financuara çdo vit deri në 2030.

Fusha Prioritare 2: Punësimi dhe aftësimi

Qëllimi i Politikës 2: *Rritja e përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve në tregun formal të punës dhe fuqizimi ekonomik i tyre.*

Indikatorë suksesi: Deri në 2030, 20% më shumë persona 20-64 vjeç të deklarojnë statusin e tyre si të punësuar (përfshirë me kohë të plotë, të pjesëshme, sezonale, të vetëpunësuar apo në punë gjatë 4 javëve të fundit).

Në fushën e punësimit dhe aftësimit, qëllimi i politikës është të rritet përfshirja e romëve dhe egjiptianëve në tregun formal të punës dhe të forcohet pavarësia e tyre ekonomike përmes aksesit më të mirë në formim profesional, programe aktive të tregut të punës, shërbime

ndërmjetësimi për punësim, si dhe përmes mbështetjes për vetëpunësim, sipërmarrje dhe formalizim të aktiviteteve ekonomike. Ky qëllim synon jo vetëm rritjen e pjesëmarrjes në masat e punësimit dhe aftësimin, por edhe përmirësimin e rezultateve të tyre në drejtim të punësimit formal, të qëndrueshëm dhe cilësor, si dhe uljen e barrierave strukturore dhe diskriminimit në tregun e punës. Deri në vitin 2030, synohet që mbi 30% e qytetarëve me përkatësi në komunitetet rome dhe egjiptiane të mbështetur përmes formimit profesional dhe programeve aktive të tregut të punës të arrijnë qëndrueshmëri në punësim; mbi 1,000 qytetarë nga këto komunitete të fuqizohen ekonomikisht çdo vit përmes masave të vetëpunësimit, sipërmarrjes, formalizimit dhe integritit në sektorë me potencial punësimi, përfshirë ekonominë e gjelbër; si dhe të përmirësohet aksesin e tyre i barabartë në punësimin publik dhe privat.

Në kuadër të këtij qëllimi të politikës janë përcaktuar tre objektiva specifike, të cilët synojnë rritjen e pjesëmarrjes në aftësim dhe punësim, fuqizimin ekonomik, reduktimin e pabarazive dhe diskriminimit në tregun e punës.

Objektivi specifik	Indikatorët e performancës
Objektivi specifik 2.1: Rritja e pjesëmarrjes, përfundimit dhe punësimit të romëve dhe egjiptianëve përmes formimit profesional dhe masave aktive të tregut të punës.	Mbi 40% e personave të mbështetur nga programet e punësimit kanë qëndrueshmëri në punësim. Deri në 2030, 10% më shumë romë dhe egjiptianë janë të punësuarve në sektorin publik.
Objektivi specifik 2.2: Fuqizimi ekonomik i romëve dhe egjiptianëve përmes vetëpunësimit, sipërmarrjes dhe formalizimit të aktiviteteve ekonomike dhe përfshirjes në sektorë me potencial, përfshirë ekonominë e gjelbër.	Më shumë se 1,000 romë dhe egjiptianë fuqizohen ekonomikisht çdo vit deri në 2030.
Objektivi specifik 2.3: Përmirësimi i aksesit të barabartë në punësim dhe reduktimi i diskriminimit në tregun e punës.	Të paktën 12 mediatorë romë dhe egjiptianë ofrojnë shërbime të punësimit të dedikuara.

Fusha Prioritare 3: Strehimi

Qëllimi i Politikës 3: *Përmirësimi i sigurisë së strehimit dhe aksesit në zgjidhje të qëndrueshme, të përballueshme dhe të desegreguara për romët dhe egjiptianët.*

Indikatorë suksesi: Deri në 2030, mbi 30% e familjeve rome dhe egjiptiane jetojnë në banesa me akses në ujë dhe kanalizime brenda banesave të tyre.

Në fushën e strehimit, qëllimi i politikës është të rritet siguria e strehimit për romët dhe egjiptianët dhe të përmirësohet aksesin e tyre në zgjidhje të qëndrueshme, të sigurta dhe të desegreguara të banimit. Ky qëllim synon forcimin e statusit ligjor të banesës dhe të vendbanimit përmes legalizimit, formalizimit dhe zgjidhjeve alternative të strehimit, zgjerimin e aksesit në programet e strehimit social për familjet më të cenueshme, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës përmes investimeve në ujësjellës, kanalizime dhe infrastrukturë lokale në zonat ku jetojnë komunitetet rome dhe egjiptiane. Deri në vitin 2030, synohet që 20% e njësive të banimit të kenë status ligjor ose të jenë të formalizuara, të rritet me të paktën 50% numri i përfituesve nga komunitetet rome dhe egjiptiane në programet e strehimit social, përfshirë bonusin e qirasë, si dhe të realizohen mbi 50 projekte dhe investime për ujë, kanalizime dhe infrastrukturë bazë në zonat me rrezik segregimi.

Në kuadër të këtij qëllimi të Politikës 3 janë përcaktuar tre objektiva specifike, të cilët synojnë rritjen e sigurisë së strehimit, zgjerimin e aksesit në mbështetje publike për banim dhe reduktimin e segregimit rezidencial.

Objektivi specifik	Indikatorët e performancës
Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i sigurisë së strehimit përmes legalizimit, formalizimit të vendbanimit dhe zgjidhjeve alternative të qëndrueshme.	Të paktën 20% e njësive të banimit kanë status ligjor ose janë të formalizuara.
Objektivi specifik 3.2: Rritja e aksesit në programet e strehimit social dhe përmirësimi i kushteve të banimit për familjet më të cenueshme.	Rritje me të paktën 50% të numrit të përfituesve në programet e strehimit social (përfshirë bonus qeraje).
Objektivi specifik 3.3: Parandalimi dhe reduktimi i segregimit rezidencial dhe përmirësimi i aksesit në shërbimet bazë dhe infrastrukturën vendore.	Mbi 50 projekte dhe investime të kryera për uji dhe kanalizime në zonat me risk segregimi deri në 2030.

Fusha Prioritare 4: Kujdesi shëndetësor

Qëllimi i Politikës 4: *Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet shëndetësore dhe reduktimi i pabarazive në rezultatet shëndetësore.*

Indikatorë sukcesi: Deri në 2030, mbi 95% e qytetarëve me përkatësi në komunitetet rome dhe egjiptiane janë të mbuluar me sigurim shëndetësor. **Në fushën e kujdesit shëndetësor,** qëllimi i politikës është të përmirësohet aksesit efektiv dhe i barabartë i romëve dhe egjiptianëve në shërbimet shëndetësore parësore, parandaluese dhe riprodhuese, si dhe të reduktohen pabarazitë që lidhen me përdorimin e shërbimeve dhe rezultatet bazë të shëndetit. Ky qëllim synon jo vetëm rritjen e mbulimit me sigurim shëndetësor, por edhe përmirësimin e përdorimit real të shërbimeve, forcimin e rolit të mediatorëve shëndetësorë si urë lidhëse ndërmjet institucioneve dhe komunitetit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit shëndetësor në komunitetet rome dhe egjiptiane. Deri në vitin 2030, synohet që 70% e popullsisë rome dhe egjiptiane të përdorë të paktën një shërbim shëndetësor gjatë vitit, të rritet me 50% numri i mediatorëve shëndetësorë për 10,000 banorë, si dhe mbi 60% e familjeve rome dhe egjiptiane të jenë të informuara për shërbimet parandaluese dhe të drejtat në kujdesin shëndetësor.

Në kuadër të këtij qëllimi të Politikës 4 janë përcaktuar tre objektiva specifike, të cilët synojnë rritjen e aksesit në shërbime, forcimin e ndërmjetësimit shëndetësor në nivel komunitar dhe zgjerimin e edukimit shëndetësor për parandalim dhe kujdes më të hershëm.

Objektivi specifik	Indikatorët e performancës
Objektivi specifik 4.1: Rritja e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve shëndetësore parësore dhe parandaluese.	70% e qytetarëve me përkatësi në komunitetin rom dhe egjiptian përdorin të paktën një shërbim shëndetësor në vit.
Objektivi specifik 4.2: Forcimi dhe institucionalizimi i sistemit të mediatorëve shëndetësorë dhe rritja e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në sektorin shëndetësor.	50% rritje në numrin e mediatorëve/10,000 banorë. VKM për institucionalizimin e mediatorëve shëndetësorë miratuar deri në Q2 2027.
Objektivi specifik 4.3: Rritja e edukimit shëndetësor dhe përdorimit të shërbimeve parandaluese në komunitetet rome dhe egjiptiane.	Mbi 60% e familjeve rome dhe egjiptiane janë informuar deri në 2030.

Fusha Prioritare 5: Varfëria dhe përjashtimi social

Qëllimi i Politikës 5: *Reduktimi i varfërisë dhe përjashtimit social të komuniteteve romë dhe egjiptiane përmes rritjes së aksesit në mbrojtjen sociale, shërbimet e integruara dhe aktivizimit ekonomik.*

Indikatorë suksesi: Deri në vitin 2030, evidentohet një trend në rënie i përqindjes së romëve dhe egjiptianëve, përfshirë fëmijët, që janë në rrezik varfërie ose në kushte të privimit të rëndë material. **Në fushën e varfërisë dhe përjashtimit social,** qëllimi i politikës është të përmirësohet aksesit i romëve dhe egjiptianëve në skemat e mbrojtjes sociale, shërbimet komunitare dhe mekanizmat e integruar të mbështetjes, me synim reduktimin e varfërisë, parandalimin e përjashtimit të thelluar social dhe ekonomik, si dhe forcimin e kujdesit me bazë komunitare dhe në familje. Ky qëllim synon rritjen e mbulimit dhe efektivitetit të shërbimeve sociale në nivel vendor, përmirësimin e koordinimit ndër-institucional për identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve në nevojë, si dhe forcimin e kapaciteteve të pushtetit vendor për përgatitje dhe reagim në situata krize, me vëmendje të veçantë ndaj grupeve më të cenueshme. Deri në vitin 2030, synohet që 40 bashki të financojnë dhe të ofrojnë shërbime funksionale në terren për romët dhe egjiptianët, mbi 70% e rasteve të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge të ndiqen dhe të marrin zgjidhje përmes mekanizmave vendorë të mbrojtjes dhe referimit, si dhe të miratohet e të zbatohet një protokoll emergjence për mbrojtjen dhe mbështetjen e pakicave në situata krize. Në kuadër të këtij qëllimi të politikës janë përcaktuar dy objektiva specifike, të cilët synojnë zgjerimin e aksesit në mbështetje sociale, forcimin e mekanizmave vendorë të koordinimit dhe menaxhimit të rasteve dhe përmirësimin e gatishmërisë institucionale për reagim në kohë krize.

Objektivi specifik	Indikatorët e performancës
Objektivi specifik 5.1: Rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në shërbimet e integruara dhe forcimi i mekanizmave të identifikimit dhe menaxhimit të rasteve.	Deri në 2030, 40 bashki financojnë shërbime për romët dhe egjiptianë dhe kanë shërbime funksionale në terren. Mbi 70% e rasteve të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge të ndjekura dhe zgjidhura, përmes mekanizmave vendorë të mbrojtjes dhe referimit
Objektivi specifik 5.2: Forcimi i mekanizmave vendorë të koordinimit dhe referimit për ofrimin e shërbimeve sociale të integruara.	Protokolli i emergjencës për pakicat i miratuar dhe në zbatim.

Fusha Prioritare 6: Antigjipsizmi

Qëllimi i Politikës 6: *Lufta kundër antigjipsizmit dhe garantimi i barazisë efektive dhe gjithëpërfshirëse për romët dhe egjiptianët përmes reformave institucionale, forcimit të masave kundër diskriminimit, rritjes së ndërgjegjësimit publik dhe pjesëmarrjes në jetën publike.*

Indikatorë suksesi: deri në 2030, evidentohet një trend në rënie i individëve që raportojnë diskriminim në 12 muajt e fundit për shkak të përkatësisë etnike.

Në fushën e antigjipsizmit, qëllimi i politikës është të adresojë një nga pengesat më të thella strukturore për barazinë dhe përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve, përkatësisht paragjykimin e rrënjosur, diskriminimin sistematik dhe narrativat negative që kufizojnë aksesin e tyre në të drejta, shërbime dhe mundësi. Në këtë kuadër, politika synon forcimin e kapaciteteve të institucioneve publike për të parandaluar, identifikuar, monitoruar dhe adresuar diskriminimin, antigjipsizmin, gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes ndaj romëve

dhe egjiptianëve. Njëkohësisht, ajo synon të nxisë ndryshim të qëndrueshëm të narrativës publike përmes fushatave të ndërgjegjësimit, aktiviteteve publike, promovimit të diversitetit dhe krijimit të hapësirave më të mëdha për përfaqësim dhe pjesëmarrje të romëve dhe egjiptianëve në strukturat vendimmarrëse vendore dhe kombëtare. Deri në vitin 2030, synohet që të miratohen të paktën 7 dokumente ligjore dhe strategjike sektoriale, të cilët përfshijnë në mënyrë eksplicite konceptin e antigjipsizmit, më shumë se 50% të stafit në administratë publike, sistemin e drejtësisë, policisë, dhe aktorë të tjerë vendorë/politikë të ndërgjegjësuar mbi konceptin e antigjipsizmit, si dhe të arrihet përfaqësim i romëve dhe egjiptianëve në të paktën 20 bashki në këshillat bashkiakë dhe strukturat e tjera vendimmarrëse.

Në kuadër të këtij qëllimi të politikës janë përcaktuar tre objektiva specifike, të cilët synojnë integrimin e antigjipsizmit në kuadrin e politikave publike, forcimin e kapaciteteve institucionale për monitorim dhe adresim të diskriminimit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe të pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në jetën publike.

Objektivi specifik	Indikatorët e performancës
Objektivi specifik 6.1: Integrimi i konceptit të antigjipsizmit në kuadrin ligjor, strategjik dhe institucional të politikave publike.	Të paktën 7 dokumente ligjore dhe strategjike sektoriale të miratuara përfshijnë në mënyrë eksplicite konceptin e antigjipsizmit
Objektivi Specifik 6.2. Forcimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin dhe adresimin e diskriminimit dhe antigjipsizmit.	Më shumë se gjysma e stafit në administratën publike, sistemin e drejtësisë, policinë, aktorët vendorë dhe politikë (Këshilla Bashkiakë e Parlament) vendorë e politikë kapacitohen mbi antigjipsizmin, diskriminimin dhe krimet e urrejtjes.
Objektivi specifik 6.3: Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe promovimi i narrativave pozitive për romët dhe egjiptianët.	Përfaqësim i romëve dhe egjiptianëve në të paktën 20 bashki në këshillat bashkiakë dhe strukturat e tjera vendimmarrëse.

Fusha Prioritare 7: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil

Qëllimi i Politikës 7: *Garantimi i aksesit efektiv dhe të barabartë të romëve dhe egjiptianëve në regjistrimin civil, dokumentimin personal dhe ndihmën juridike falas.*

Indikatorë suksesi: Deri në vitin 2030, të gjithë qytetarët me përkatësi në komunitetet rome dhe egjiptiane janë të regjistruar në regjistrat civilë dhe numri i përfituesve nga këto komunitete nga ndihma juridike falas rritet me të paktën 30%.

Në fushën e aksesit në drejtësi dhe regjistrimit civil, qëllimi i Politikës 7 është të sigurojë që romët dhe egjiptianët të mos përballen më me pengesa administrative, financiare dhe procedurale në ushtrimin e të drejtave të tyre themelore. Ky qëllim synon të përmirësojë aksesin në regjistrimin civil dhe dokumentimin personal, si parakusht për përfitimin e të drejtave të tjera sociale, ekonomike dhe civile, si dhe të rrisë aksesin në ndihmën juridike falas dhe në mekanizmat e mbrojtjes ligjore për individët dhe familjet në nevojë. Në të njëjtën kohë, ai synon të forcojë kapacitetet institucionale dhe koordinimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse për gjendjen civile, njësitë të vetëqeverisjes vendore, shërbimeve sociale, institucioneve të drejtësisë dhe ofruesve të ndihmës juridike, me qëllim identifikimin më të hershëm të rasteve, zgjidhjen më të shpejtë të barrierave dhe garantimin e aksesit efektiv në të drejta. Me këtë fushë prioritare synohet jo vetëm eliminimi i rasteve të me mungesë të

regjistrimit civil, por edhe thjeshtimin e procedurave, reduktimin e kostove dhe rritjen e qasjes në informacion dhe mbështetje juridike, veçanërisht për grupet më të cenueshme.

Në kuadër të këtij qëllimi të Politikës 7 janë përcaktuar dy objektiva specifike, të cilët synojnë, nga njëra anë, përmirësimin e regjistrimit civil dhe dokumentimit përmes eliminimit të barrierave administrative dhe financiare dhe, nga ana tjetër, rritjen e aksesit në ndihmën juridike falas dhe fuqizimin e romëve dhe egjiptianëve për të ushtruar të drejtat e tyre ligjore në mënyrë të informuar dhe efektive. Fusha Prioritare 7 integron gjithashtu masat për përfshirjen dixhitale, duke adresuar barrierat në aksesin e shërbimeve publike elektronike, në zbatim të angazhimeve të Deklaratës së Poznanit për tranzicionin dixhital.

Objektivi specifik	Indikatorët e performancës
Objektivi Specifik 7.1: Përmirësimi i regjistrimit civil dhe dokumentimit të romëve dhe egjiptianëve përmes eliminimit të barrierave administrative dhe financiare.	Miratohen procedura të standardizuara administrative për regjistrimin civil dhe transferimin e dosjeve ku jeton familja. Të paktën 1,500 persona/familje përfitojnë shërbime mbështetëse për regjistrim civil çdo vit.
Objektivi specifik 7.2: Rritja e aksesit në ndihmën juridike falas dhe shërbimet elektronike publike.	Mbi 25 qendra dhe zyra të ndihmës juridike parësore falas janë funksionale në bashkitë me përqendrim të lartë të komuniteteve. Kuadri ligjor i rishikuar dhe miratuar që njeh romët dhe egjiptianët si kategori përfituese automatike ≥3,000 individë romë dhe egjiptianë të trajnuar në shkrim-lexim dixhital dhe navigim në shërbimet e e-Albania deri në 2030. ≥50% e familjeve romë dhe egjiptiane në bashkitë prioritare me akses aktiv në e-Albania deri në 2030

2.3. Masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme

PKVBPPRE 2030 përfshin objektiva specifike për secilën fushë duke marrë parasysh politikat ekzistuese dhe bazohet në strategjitë sektoriale për periudhën 2026-2030, duke prezantuar veprime të synuara që adresojnë të drejtat dhe nevojat e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Gjithashtu, PKVBPPRE 2030 thekson bashkëpunim ndërsektorial ndërmjet shëndetësisë, strehimit, arsimit, punësimit, mbrojtjes sociale dhe institucioneve që garantojnë të drejtat themelore përmes objektivave që përforcojnë njëra tjetrën. Ky seksion përmbledh objektivat specifike, masat prioritare dhe aktivitetet për secilën fushë, ndërsa për aktivitetet e detajuara janë të paraqitura në Aneksin 1.

Fusha Prioritare 1: Arsimi dhe nxitja e dialogut ndërkulturor

Objektivi specifik 1.1: Rritja e aksesit, pjesëmarrjes dhe përfundimit të arsimit për fëmijët, nxënësit dhe studentët romë dhe egjiptianë në të gjitha nivelet.

Aktivitetet në këtë objektiv fokusohen në identifikimin e hershëm, regjistrimin, ndjekjen dhe mbështetjen e vazhdimësisë në arsim për fëmijët romë dhe egjiptianë, duke nisur nga arsimi parashkollor deri te arsimi i lartë. Kjo përfshin forcimin e mekanizmave vendorë për identifikimin dhe referimin e fëmijëve jashtë sistemit ose në rrezik braktisjeje, si edhe standardizimin dhe vendosjen e mediatorëve arsimorë për të ndërmjetësuar mes shkollës, familjes dhe komunitetit. Në vijim, parashikohen programe të integruara mbështetëse për vijimësinë dhe rikthimin në arsim, si programet pas mësim, skemat për rikthimin dhe

riintegrimin në arsimin formal, si dhe masa mbështetëse financiare që synojnë uljen e barrierave ekonomike. Këtu përfshihen skema vendore për reduktimin ose përjashtimin e tarifave, transport falas për nxënësit që jetojnë larg shkollës, bursat në arsimin parauniversitar dhe mbështetje me bursa ose tarifa të reduktuara në arsimin e lartë.

Masat prioritare

Masa 1.1.1. Zbatimi i mekanizmave vendorë për identifikimin, regjistrimin dhe monitorimin e vijimësisë së fëmijëve romë dhe egjiptiane në arsimin parashkollor dhe të detyrueshëm.

Masa 1.1.2. Zbatimi i programeve të integruara për mbështetjen e vijimësisë, përfundimit dhe rikthimit në arsim.

Objektivi specifik 1.2: Përmirësimi i barazisë dhe gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor për romët dhe egjiptianët dhe reduktimit të segregimit dhe diskriminimit.

Ky objektivi përqendrohet te rritja e cilësisë dhe karakterit gjithëpërfshirës të sistemit arsimor përmes trajnimit të stafit arsimor mbi arsimin gjithëpërfshirës, antigjipsizmin dhe mosdiskriminimin. Në të njëjtën kohë, parashikohet integrimi i konceptit të antigjipsizmit në kurrikula dhe trajnimin e mësuesve për ta adresuar atë në praktikën pedagogjike. Një shtyllë tjetër e rëndësishme është rishikimi i kurrikulave dhe teksteve shkollore për të eliminuar stereotipet dhe për të përfshirë historinë dhe kulturën romë dhe egjiptiane. Paralelisht, parashikohet ngritja e një sistemi monitorimi për shkollat dhe klasat në rrezik segregimi, e hartimi i planeve korrigjuese vendore, si dhe forcimi i mekanizmave për identifikimin e hershëm të nxënësve jashtë sistemit ose në rrezik braktisjeje.

Masat prioritare:

Masa 1.2.1: Përmirësimi i cilësisë, gjithëpërfshirjes dhe mos diskriminimit në sistemin arsimor.

Objektivi specifik 1.3: Promovimi i njohjes, përfaqësimit dhe dialogut ndërkulturor për romët dhe egjiptianët në arsim dhe hapësirën publike.

Aktivitetet në këtë objektivi synojnë rritjen e dukshmërisë së kulturës, historisë dhe identitetit romë dhe egjiptian në arsim dhe në jetën publike. Kjo përfshin zhvillimin dhe zgjerimin e mësimit të gjuhës romë në arsimin parauniversitar, si dhe mbështetjen e mësuesve përkatës. Njëkohësisht, parashikohen programe të integruara kulturore dhe ndërkulturore, që përfshijnë aktivitete artistike dhe kulturore, përfshirje në media dhe kalendarë publikë, si edhe financim të projekteve kulturore dhe materialeve në gjuhët e pakicave. Në këtë kuadër synohet edhe rritja e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në institucionet publike kulturore.

Masat prioritare:

Masa 1.3.1: Promovimi i kulturës, historisë dhe dialogut ndërkulturor.

Fusha Prioritare 2: Punësimi dhe aftësimi

Objektivi specifik 2.1: Rritja e pjesëmarrjes, përfundimit dhe tranzicionit në punësim të romëve dhe egjiptianëve përmes formimit profesional dhe masave aktive të tregut të punës.

Ky objektivi fokusohet te forcimi i mekanizmave të aktivizimit, këshillimit dhe ndërmjetësimit në tregun e punës për romët dhe egjiptianët. Aktivitetet përfshijnë këshillimin për karrierë, profilizimin dhe planifikimin individual, si dhe zbatimin e programeve të riintegritimit social dhe

punësimin në bashkëpunim me ofrues jo publikë të shërbimeve të punësimin. Gjithashtu, parashikohen aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese të dedikuara për komunitetet, për të rritur përdorimin e programeve të nxitjes së punësimin.

Në këtë objektiv përfshihet edhe rritja e pjesëmarrjes në formim profesional dhe masa aktive të tregut të punës, duke përmirësuar jo vetëm regjistrimin, por edhe përfundimin, certifikimin dhe tranzicionin në punësim. Kjo mbështetet me ndërmjetësim aktiv me punëdhënësit, monitorim të qëndrueshmërisë në punë pas përfundimit të programeve dhe promovim të punës së denjë, përmes ndërgjegjësimin, monitorimit të kushteve të punës dhe formalizimit të punësimin. Një nënfushë e veçantë i kushtohet integritit të të rinjve romë dhe egjiptianë, përmes përfshirjes në skemën e Garancisë Rinore, praktikave profesionale dhe arsimit profesional, përfshirë bursat dhe subvencionet. Po ashtu, parashikohen masa për rritjen e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në administratën publike dhe në praktikat profesionale brenda saj.

Masat prioritare:

Masa 2.1.1: Forcimi i mekanizmave të aktivizimit dhe ndërmjetësimin në tregun e punës për romët dhe egjiptianët.

Masa 2.1.2: Rritja e pjesëmarrjes në formim profesional dhe masave aktive të tregut të punës, si dhe përmirësimit të qëndrueshmërisë në punë.

Masa 2.1.3: Mbështetja e integritit të të rinjve romë dhe egjiptianë në tregun e punës përmes Garancisë Rinore, praktikave profesionale dhe arsimit profesional.

Masa 2.1.4: Mbështetja e integritit të romëve dhe egjiptianëve në administratën publike.

Objektivi specifik 2.2: Fuqizimi ekonomik i romëve dhe egjiptianëve përmes vetëpunësimin, sipërmarrjes dhe formalizimit të aktiviteteve ekonomike dhe përfshirjes në sektorë me potencial, përfshirë ekonominë e gjelbër.

Ky objektiv mbështet vetëpunësimin dhe zhvillimin e mikro-ndërmarrjeve, përmes granteve dhe skemave mbështetëse për biznese të vogla të romëve dhe egjiptianëve. Veçanërisht, parashikohen masa për sipërmarrjen sociale dhe përfshirjen në sektorë të lidhur me ekonominë e gjelbër, si riciklimi, përpunimi dhe riparimi. Një komponent i rëndësishëm lidhet me formalizimin e aktiviteteve ekonomike, përmes mbështetjes për licencim, regjistrim dhe integrim në tregje publike, si edhe përmes masave të lehtësimin fiskal në nivel vendor për bizneset romë dhe egjiptiane.

Masat prioritare:

Masa 2.2.1: Mbështetja e vetëpunësimin dhe zhvillimit të sipërmarrjes sociale dhe mikro-ndërmarrjeve

Masa 2.2.2: Mbështetja për formalizimin e aktiviteteve ekonomike dhe përfshirjen në sektorë me potencial punësimi, përfshirë ekonominë e gjelbër.

Objektivi specifik 2.3: Përmirësimi i aksesit të barabartë në punësim dhe reduktimi i diskriminimit në tregun e punës.

Aktivitetet synojnë forcimin e mekanizmave institucionalë kundër diskriminimit në tregun e punës. Kjo nis me hartimin e kuadrit rregullator për mediatorët e punësimin për romët dhe egjiptianët dhe vijon me punësimin e tyre në zyrat e punës në bashkitë me përqendrim të

lartë të këtyre komuniteteve. Po ashtu, parashikohet trajnimi i detyrueshëm i stafit të shërbimeve të punësimit dhe AFP-së mbi diversitetin, mosdiskriminimin dhe qasjen gjithëpërfshirëse, si dhe zhvillimi i materialeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese për punëkërkuesit, punëdhënësit dhe ofruesit e shërbimeve.

Masat prioritare:

Masa 2.3.1: Forcimi i mekanizmave institucionalë dhe masave për parandalimin e diskriminimit në tregun e punës.

Fusha Prioritare 3: Strehimi

Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i sigurisë së strehimit përmes legalizimit, formalizimit të vendbanimit dhe zgjidhjeve alternative të qëndrueshme.

Ky objektivi synon forcimin e planifikimit vendor për strehimin social, përmes asistencës teknike për bashkitë në hartimin ose përditësimin e planeve 5-vjeçare të strehimit dhe në përgatitjen e aplikimeve për financim. Një shtyllë tjetër është mbështetja për legalizimin dhe formalizimin e vendbanimit, përmes identifikimit të rasteve, përgatitjes së dosjeve dhe ndjekjes administrative.

Masat prioritare:

Masa 3.1.1: Forcimi i planifikimit vendor të strehimit social dhe përmirësimi i kapaciteteve.

Masa 3.1.2: Forcimi i proceseve të legalizimit dhe formalizimit të vendbanimit.

Objektivi specifik 3.2: Rritja e aksesit në programet e strehimit social dhe përmirësimi i kushteve të banimit për familjet më të cenueshme.

Aktivitetet në këtë objektivi fokusohen në lehtësimin e aksesit të familjeve romë dhe egjiptiane në programet e strehimit social, si subvencionimi i qerasë, kreditë e buta dhe asistencë direkte për përgatitjen e aplikimeve dhe dokumentacionit. Gjithashtu, parashikohet monitorimi i zbatimit të kuotës ligjore (5%) në programet e strehimit social, si dhe realizimi i ndërhyrjeve fizike për përmirësimin e kushteve të banimit, përfshirë rehabilitimin, rikonstrukcionin dhe aksesin në shërbime bazë.

Masat prioritare:

Masa 3.2.1: Përmirësimi i aksesit dhe përfshirjes së familjeve R/E në programet e strehimit social.

Masa 3.2.2: Përmirësimi i kushteve të banimit përmes ndërhyrjeve fizike.

Objektivi specifik 3.3: Parandalimi i segregimit rezidencial dhe përmirësimi i aksesit infrastrukturë dhe shërbime bazë.

Ky objektivi përqendrohet në hartëzimin dhe analizën e zonave me rrezik segregimi rezidencial, si bazë për plane vendore, ndërhyrjeje me fokus desegregimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Në vijim, parashikohen projekte infrastrukturore për ujë, kanalizime, energji dhe rrugë në zonat me përqendrim të komuniteteve romë dhe egjiptiane, si dhe konsultime të strukturuar me komunitetet për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e ndërhyrjeve.

Masat prioritare:

Masa 3.3.1: Parandalimi i segregimit rezidencial dhe përmirësimi i kushteve të jetesës.

Fusha Prioritare 4: Kujdesi shëndetësor

Objektivi specifik 4.1: Rritja e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve shëndetësore parësore dhe parandaluese.

Ky objektivi synon zgjerimin e shërbimeve shëndetësore në terren, përmes ekipeve lëvizëse që ofrojnë vizita, vaksinim, kontrolle bazë dhe referime në komunitetet rome dhe egjiptiane. Po ashtu, parashikohet rritja e mbulimit me check-up për grupmoshën 35-70 vjeç përmes identifikimit aktiv dhe referimit. Një tjetër drejtim lidhet me përmirësimin e cilësisë dhe barazisë në shërbimet shëndetësore, përmes trajnimit të stafit mjekësor dhe administrativ mbi mosdiskriminimin, barazinë gjinore dhe komunikimin ndërkulturor, si edhe krijimit të një mekanizmi të strukturuar për raportimin dhe monitorimin e rasteve të diskriminimit në kujdesin parësor. Gjithashtu, objektivi mbështet shëndetin e nënës dhe fëmijës, me identifikim dhe ndjekje antenatale e postnatale të grave rome dhe egjiptiane, si dhe me rritjen e aksesit në përfitimet financiare dhe shërbimet shëndetësore përmes bashkëpunimit ndërmjet strukturave sociale, shëndetësore dhe mediatorëve.

Masat prioritare:

Masa 4.1.1: Zgjerimi i aksesit në shërbimet shëndetësore parësore e parandaluese përmes ndërhyrjeve në terren dhe identifikimit aktiv të përfituesve.

Masa 4.1.2: Përmirësimi i cilësisë, barazisë dhe përdorimit të shërbimeve shëndetësore.

Masa 4.1.3: Fuqizimi i shërbimeve për shëndetin e nënës dhe fëmijës dhe rritja e aksesit në përfitimet shëndetësore dhe sociale.

Objektivi specifik 4.2: Forcimi dhe institucionalizimi i sistemit të mediatorëve shëndetësorë dhe rritja e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në sektorin shëndetësor.

Ky objektivi synon institucionalizimin e mediatorëve shëndetësorë, përmes miratimit të kuadrit ligjor dhe buxhetor dhe zgjerimit të rrjetit të tyre në territor. Paralelisht, parashikohen masa për rritjen e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në sektorin shëndetësor, përmes bursave dhe kuotave në studimet mjekësore dhe teknike shëndetësore, si edhe përmes politikave të punësimit në institucionet e shëndetit publik.

Masat prioritare:

Masa 4.2.1: Konsolidimi dhe zgjerimi i sistemit të mediatorëve shëndetësorë.

Masa 4.2.2: Rritja e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në sektorin shëndetësor përmes arsimit dhe punësimit.

Objektivi specifik 4.3: Rritja e edukimit shëndetësor dhe përdorimit të shërbimeve parandaluese në komunitetet rome dhe egjiptiane.

Aktivitetet lidhen me ndërgjegjësimin komunitar dhe edukimin shëndetësor, përfshirë fushata për navigimin në sistemin shëndetësor, përdorimin e e-Albania dhe referimeve, fushata derë më derë për vaksinimin dhe gjurmimin e fëmijëve me vakcina të vonuara, si edhe programe për promovimin e stileve të shëndetshme të jetesës. Po ashtu, parashikohen sesione edukative të strukturuar mbi vaksinimin dhe kujdesin ndaj foshnjave, fushata mbi SST dhe shëndetin riprodhues, si dhe prodhimi e shpërndarja e materialeve informuese të përshtatura kulturalisht dhe në gjuhën rome.

Masat prioritare:

Masa 4.3.1: Përmirësimi i edukimit shëndetësor dhe promovimi i sjelljeve të shëndetshme përmes angazhimit komunitar.

Fusha Prioritare 5: Varfëria dhe përjashtimi social

Objektivi specifik 5.1: Rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në shërbimet e integruara dhe forcimi i mekanizmave të identifikimit, referimit dhe menaxhimit të rasteve.

Ky objektivi fokusohet në forcimin e aksesit në mbrojtjen sociale dhe shërbimet e integruara, përmes sistemeve proaktive të identifikimit dhe ndjekjes së familjeve romë dhe egjiptiane nga ekipet lëvizëse dhe përmes koordinimit ndërsektorial. Po ashtu synohet zgjerimi i qasjes së integruar të shërbimeve (cash+) dhe forcimit dhe standardizimit të mekanizmave vendorë të identifikimit, referimit dhe menaxhimit të rasteve. Një komponent i rëndësishëm është promovimi i aktivizimit ekonomik të përfituesve të mbrojtjes sociale, veçanërisht grave romë dhe egjiptiane, përmes profilizimit, formimit profesional, ndërmjetësimit në punë dhe programeve specifike në sektorët socialë dhe shëndetësorë. Ky objektivi përfshin edhe forcimin e mekanizmave të referimit dhe menaxhimit të rasteve për fëmijët dhe familjet në rrezik, si dhe zgjerimin e shërbimeve komunitare multifunkionale në bashkitë prioritare.

Masat prioritare:

Masa 5.1.1: Forcimi i aksesit në mbrojtjen sociale dhe shërbime të integruara.

Masa 5.1.2: Aktivizimi ekonomik dhe përfshirja në tregun e punës për përfituesve të mbrojtjes sociale, me fokus gratë romë dhe egjiptiane.

Masa 5.1.3: Forcimi dhe standardizimi i mekanizmave vendorë të identifikimit, referimit dhe menaxhimit të rasteve për fëmijët dhe familjet në rrezik.

Objektivi specifik 5.2: Forcimi i mekanizmave vendorë për përgatitjen dhe reagimin ndaj krizave dhe emergjencave.

Aktivitetet synojnë përgatitjen dhe reagimin social ndaj emergjencave, përmes fushatave ndërgjegjësuese në gjuhën romë për pandemitë dhe emergjencat civile, krijimit të databazave vendore për familjet në rrezik dhe identifikimit të vendbanimeve të ekspozuara ndaj rreziqeve, me qëllim planifikimin e masave mbrojtëse ose zhvendosjes emergjente.

Masat prioritare:

Masa 5.2.1: Forcimi i përgatitjes dhe reagimit social në situata emergjence dhe krize.

Fusha Prioritare 6: Antigjipsizmi

Objektivi specifik 6.1: Integrimi i konceptit të antigjipsizmit në kuadrin ligjor, strategjik dhe institucional të politikave publike.

Ky objektivi synon standardizimin dhe integrimin e konceptit të antigjipsizmit në legjislacion, dokumente politike dhe strategji sektoriale, në mënyrë që lufta kundër diskriminimit të bëhet pjesë e qartë dhe e matshme e politikave publike.

Masat prioritare:

Masa 6.1.1: Integrimi i antigjipsizmit në legjislacion dhe politika sektoriale.

Objektivi specifik 6.2: Forcimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin dhe adresimin e diskriminimit dhe antigjipsizmit.

Aktivitetet përfshijnë zhvillimin e programeve të detyrueshme të trajnimit për administratën publike, sistemin e drejtësisë, policinë dhe aktorët politikë/vendorë mbi antigjipsizmin, diskriminimin dhe krimet e urrejtjes. Paralelisht, parashikohet zhvillimi i një sistemi të integruar për monitorimin, raportimin dhe analizën e diskriminimit dhe antigjipsizmit, si dhe forcimi i mekanizmave për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe shoqërinë civile.

Masat prioritare:

Masa 6.2.1: Forcimi i kapaciteteve profesionale për parandalimin dhe adresimin e antigjipsizmit.

Masa 6.2.2: Forcimi i sistemeve për monitorimin, raportimin dhe adresimin e diskriminimit dhe antigjipsizmit.

Objektivi specifik 6.3: Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe promovimi i narrativave pozitive për romët dhe egjiptianët.

Ky objektivi mbështet fushata të integruara ndërgjegjësuëse dhe aktivitete publike për promovimin e diversitetit dhe reduktimin e stereotipave ndaj romëve dhe egjiptianëve. Njëkohësisht synohet rritja e pjesëmarrjes së tyre në jetën publike dhe vendimmarrëse, sidomos në proceset zgjedhore dhe në strukturat vendore e kombëtare.

Masat prioritare:

Masa 6.3.1: Promovimi i diversitetit dhe reduktimi i stereotipave përmes fushatave ndërgjegjësuëse dhe aktiviteteve publike.

Masa 6.3.2: Rritja e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në jetën publike dhe vendimmarrje.

Fusha Prioritare 7: Akses i barabartë në drejtësi dhe regjistrim civil

Objektivi specifik 7.1: Përmirësimi i regjistrimit civil dhe dokumentimit të romëve dhe egjiptianëve përmes eliminimit të barrierave administrative dhe financiare.

Ky objektivi fokusohet në identifikimin proaktiv të personave të paregjistruar dhe mbështetjen e tyre për regjistrim civil dhe dokumentim, brenda dhe jashtë vendit. Për ta bërë këtë të realizueshme, parashikohen shërbime mbështetëse të integruara, si përkthimi, legalizimi i dokumenteve dhe procedurat konsullore, si edhe mbështetje financiare për testet ADN dhe verifikimin e identitetit. Po ashtu, parashikohen thjeshtimi dhe standardizimi i procedurave administrative, trajnimi i nëpunësve të gjendjes civile për trajtim pa diskriminim dhe zbatimin e procedurave alternative për regjistrimin civil në rastet e familjeve që jetojnë në zona informale.

Masat prioritare:

Masa 7.1.1: Identifikimi proaktiv dhe regjistrimi civil i personave të paregjistruar.

Masa 7.1.2: Eliminimi i barrierave administrative dhe financiare për regjistrimin civil përmes shërbimeve mbështetëse, thjeshtimit të procedurave dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.

Objektivi specifik 7.2: Rritja e aksesit në ndihmën juridike falas, shërbimet elektronike publike.

Ky objektiv synon zgjerimin e aksesit në ndihmën juridike falas, si parësore ashtu edhe dytësore, për romët dhe egjiptianët, si dhe rishikimin e kuadrit ligjor për ta bërë këtë akses më të lehtë dhe më automatik për këto komunitete. Njëkohësisht, parashikohet zgjerimi i rritjes së shërbimeve të ndihmës juridike dhe bashkëpunimit me klinikat ligjore dhe organizatat përkatëse, si dhe zhvillimi i fushatave informuese dhe aktiviteteve të edukimit ligjor për të rritur njohjen dhe përdorimin e këtyre shërbimeve. Një masë tjetër lidhet me rritjen e përfshirjes dixhitale dhe e aksesit në shërbimet elektronike për romët dhe egjiptianët.

Masat prioritare:

Masa 7.2.1: Përmirësimi i aksesit në ndihmën juridike falas për romët dhe egjiptianët.

Masa 7.2.2: Rritja e ndërgjegjësimit dhe fuqizimit ligjor të romëve dhe egjiptianëve

Masa 7.2.3: Rritja e përfshirjes dixhitale dhe e aksesit në shërbimet elektronike për romët dhe egjiptianët.

2.4. Qeverisja dhe kuadri institucional

PKVBPPRE 2030 zbatohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe me dokumente të tjera strategjike që kontribuojnë në përfshirjen dhe fuqizimin e komuniteteve romë dhe egjiptiane.

Zbatimi i Planit mbështetet në një sistem të strukturuar qeverisjeje, i cili siguron koordinimin efektiv ndër-institucional, përgjegjësi të qarta, pjesëmarrje të komuniteteve dhe monitorim të bazuar në evidencë. Duke qenë se masat shtrihen në disa sektorë, sistemi i qeverisjes ndërtohet mbi një qasje shumë-nivelëshe, që përfshin institucionet qendrore, pushtetin vendor, institucionet e pavarura, shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e komuniteteve romë dhe egjiptiane.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka rolin udhëheqës për drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të zbatimit të Planit. Përgjegjësitë institucionale për secilën masë janë të përcaktuara në matricën e Planit të Veprimit, ndërsa aktivitetet specifike sektoriale reflektohen në planet vjetore të institucioneve përgjegjëse.

Për të siguruar koherencë dhe koordinim në nivel qendror, janë përcaktuar mekanizmat e mëposhtëm:

- **Grupi Tematik për Mbrojtjen dhe Përfshirjen Sociale** funksionon në kuadër të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor.
- **Koordinatori Kombëtar për zbatimin e PKVBPPRE**, mbështetur nga Sekretariati Teknik;
- **Grupi Ndër-institucional i Koordinimit (GNK)** për zbatimin e PKVBPPRE, i kryesuar nga MSHMS, me pjesëmarrjen e ministrive dhe agjencive përkatëse. Institucionet kryesore të përfshira në GNK përshkruhen më poshtë.
- **Platforma Kombëtare për Pjesëmarrje**, me synim përfshirjen e shoqërisë civile dhe komuniteteve.

(i) Grupi Tematik për Mbrojtjen dhe Përfshirjen Sociale siguron koherencë strategjike ndërmjet PKVBPPRE dhe reformave të tjera sektoriale. Ky mekanizëm, i kryesuar nga

Zëvendësministri përgjegjës për përfshirjen sociale dhe përfaqësues të ministrive të linjës, agjencive dhe partnerëve të zhvillimit. Për të garantuar koherencën me ciklet kombëtare të planifikimit, buxhetimit dhe raportimit, PKV BPPRE do të integrohet në Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për miratimin e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale dhe për krijimin e mekanizmit të integruar sektorial/ndërsektorial.”

(ii) Koordinatorit Kombëtar dhe Sekretariati Teknik. Zëvendësministri përgjegjës për përfshirjen sociale ushtron funksionin e **Koordinatorit Kombëtar për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve**, duke vepruar si pika qendrore e kontaktit për koordinimin, mbikëqyrjen dhe raportimin e zbatimit të Planit. Koordinatorit Kombëtar është përgjegjës për:

- sigurimin e drejtimit strategjik për zbatimin e Planit dhe integrimin e objektivave e masave në politikat sektoriale;
- koordinimin ndërinstytucional, përfshirë pushtetin vendor, institucionet e pavarura, shoqërinë civile dhe komunitetet;
- mbikëqyrjen e zbatimit operacional në bashkëpunim me strukturat përkatëse të MSHMS;
- hartimin e raporteve vjetore dhe planeve të monitorimit në bashkëpunim me aktorët kyç;
- mobilizimin e burimeve dhe përafrimin e programeve dhe investimeve me prioritetet e Planit;
- nxitjen e bashkëpunimit me homologët e vendeve të tjera dhe shkëmbimin e praktikave të mira.

Koordinatorit Kombëtar mbështetet nga Sekretariati Teknik, rolin e të cilit do ta luajë Drejtoria e Politikave të Përfshirjes Sociale pranë MSHMS në bashkëpunim me pikat fokale në institucionet përgjegjëse.

(iii) Grupi Ndërinstytucional i Koordinimit është mekanizmi kryesor operacional për koordinimin ndërsektorial të zbatimit të Planit. Detyrat kryesore të GNK përfshijnë shqyrtimin e progresit dhe të raporteve të zbatimit; ofrimin e mbështetjes teknike për institucionet përgjegjëse; identifikimin e boshllëqeve dhe propozimin e masave përkatëse; raportimin periodik në nivel qeveritar mbi ecurinë e zbatimit; organizimin e takimeve dhe mbështetjen e proceseve të vlerësimeve të jashtme, si dhe integrimin e gjetjeve në përmirësimin e Planit. GNK mbledhet të paktën dy herë në vit dhe sipas nevojës më shpesh. Institucionet kryesore pjesëmarrëse përfshijnë:

- **Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS)** e cila koordinon politikat sociale në tërësi e zbaton masat për mbrojtjen sociale e shërbimet komunitare, mediatorët shëndetësorë si dhe mbikëqyr mekanizmat e referimit dhe menaxhimit të rastit.
- **Ministria e Arsimit (MA)** si institucionin përgjegjës për përfshirjen në arsim (arsimin parauniversitar dhe bursat), koordinimin me DRAP/ZVAP dhe institucionet arsimore dhe monitoron treguesit e regjistrimit, frekuentimit, cilësinë dhe përfundimin e arsimit.

- **Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI)**, përgjegjëse për politikat e punësimit dhe aftësimit në koordinim me AKPA. Ndërkohë **AKPA** është institucioni zbatues i programeve të nxitjes dhe monitoron pjesëmarrjen në tregun e punës dhe formim profesional. AKPA gjithashtu siguron ofrimin e shërbimeve pranë komunitetit, ndërmjetësimin me punëdhënësit.
- **Ministria e Drejtësisë (MD)** siguron akses në ndihmë ligjore falas dhe mekanizma mbrojtjeje ligjore si dhe koordinon me institucionet e drejtësisë e Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD).
- **Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)** koordinon proceset e regjistrimit civil dhe dokumentimit;
- **Bashkitë (NJVV)** zbatojnë masat në nivel lokal, hartojnë dhe zbatojnë plane vendore të shërbimeve të përkujdesit social e përfshirjes, koordinojnë shërbimet sociale, strehimin dhe ndërhyrjet komunitare, dhe mekanizmin e referimit. Në grupin teknik NJVV do të përfaqësohen përmes **Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)**.
- Pjese e Grupit Ndërinstitucional të Koordinimit do të jenë dhe **Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)** e cila kontribuon në çështjet e legalizimit dhe pronësisë si dhe institucione të pavarura si INSTAT e KMD. INSTAT ka një rol kyç në prodhimin e statistikave zyrtare, ndërsa KMD trajton rastet e diskriminimit dhe monitoron zbatimin e legjislacionit për barazi.

(iv) Për të garantuar përfshirjen e komuniteteve dhe shoqërisë civile, Koordinatori Kombëtar do të ngrejë një **Platformë Kombëtare e Pjesëmarrjes**. Platforma do të ndihmojë në organizimin e forumeve vendore në bashkitë prioritare me përqendrim më të lartë të komuniteteve rome dhe egjiptiane si dhe do të sigurojë përfshirjen e shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të komuniteteve në monitorimin e zbatimit të Planit. Gjithashtu, Platforma do të kontribuojë në identifikimin e barrierave, diskriminimit dhe nevojave të komuniteteve e do të mbështetë dialogun me institucionet. Takimet do të organizohen të paktën dy herë në vit dhe sipas nevojës. Drejtimi i saj do të realizohet përmes një përfaqësuesi të zgjedhur nga anëtarët e Platformës, me rotacion çdo 2 vite dhe me mbështetjen e Sekretariatit Teknik.

Platforma Kombëtare e Pjesëmarrjes konstituohet dhe funksionon sipas parimeve të mëposhtme operative:

- **Përbërja.** Platforma përbëhet nga organizata të shoqërisë civile rome dhe egjiptiane (të paktën 50% e anëtarëve), organizata të tjera të shoqërisë civile aktive në fushën e të drejtave të pakicave, si dhe përfaqësues të komuniteteve nga bashkitë prioritare. Sigurohet përfaqësim i barabartë gjinor dhe përfshirja e të rinjve dhe e personave me aftësi të kufizuara.
- **Financimi.** Sekretariati Teknik siguron mbulimin e kostove operative të Platformës, përfshirë organizimin e takimeve, materialeve dhe interpretimit, përmes buxhetit institucional të MSHMS dhe/ose fondeve të partnerëve të zhvillimit.
- **Mekanizmi i dokumentimit dhe informacionit.** Pas çdo takimi të Platformës, Sekretariati Teknik harton dhe ndan procesverbalin e strukturuar, i cili dokumenton kontributet e anëtarëve, rekomandimet e paraqitura dhe mënyrën e trajtimit të tyre

në procesin e raportimit ose planifikimit. Raporti vjetor i progresit të PKVBPPRE 2030 përfshin një seksion të dedikuar që pasqyron gjetjet dhe rekomandimet e Platformës, me shpjegim të arsyeve kur rekomandimet nuk janë pasqyruar.

- **Lidhja me ciklin e raportimit.** Platforma mbledhet të paktën dy herë në vit. Takimi i parë (mars/prill) shqyrton të dhënat e zbatimit të vitit të kaluar; takimi i dytë (shtator/tetor) kontribuon në planifikimin e masave për vitin pasardhës dhe shqyrton draftin e raportit vjetor të progresit.

Në nivel qendror, një rol mbështetës luajnë edhe komisionet parlamentare, veçanërisht Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik të cilat kontribuojnë në forcimin e mbikëqyrjes parlamentare dhe promovimin e politikave për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve.

2.5. Mekanizmat e zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit

2.5.1. Qasja e zbatimit - roli i aktorëve vendor dhe përfshirja e komuniteteve

Bashkitë janë në qendër të modelit të zbatimit të PKVBPPRE 2030, si aktorë kryesorë në ofrimin e shërbimeve dhe ndërmjetësimin e ndërhyrjeve në nivel vendor. Ato veprojnë përmes rrjetit të profesionistëve, mekanizmave të referimit dhe planeve social vendore. Konkretisht, në nivel vendor, bashkitë:

- identifikojnë individët dhe familjet në nevojë përmes punonjësve socialë, administratorëve socialë dhe strukturave të tjera vendore;
- koordinojnë ofrimin e shërbimeve sociale, arsimore, shëndetësore, të strehimit dhe integritimit social;
- sigurojnë referimin, ndjekjen dhe ndërhyrjen në kohë për rastet komplekse;
- bashkëpunojnë me strukturat rajonale dhe qendrore për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve.

Në këtë kuadër, institucionet sektoriale me përgjegjësi të drejtpërdrejta koordinojnë ngushtë me pushtetin vendor, për të siguruar që masat e përbashkëta të diskutohen, planifikohen dhe zbatohen në kohë dhe me standarde të unifikuara.

Organizatat e shoqërisë civile, në nivel vendor dhe kombëtar, janë partnerë strategjikë në zbatimin dhe monitorimin e Planit. OSHC ofrojnë kontribut të rëndësishëm përmes aktiviteteve me bazë komunitare, ndërgjegjësimin dhe mbështetjes për familjet, ofrimin të shërbimeve psikosociale, arsimore, pas-shkollore, ndihmës juridike dhe të ndërmjetësimin. Gjithashtu, ato marrin pjesë në mekanizmat e koordinimit në nivel vendor dhe në **Platformën Kombëtare të Pjesëmarrjes**.

Në përputhje me parimet e përfshirjes, PKVBPPRE 2030 siguron që **zëri i komuniteteve rome dhe egjiptiane** të përfshihet në mënyre sistematike në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave. Kjo pjesëmarrje synon të jetë e strukturuar, përfaqësuese, duke reflektuar diversitetin brenda komuniteteve, përfshirë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet në situata të shumëfishta cenueshmërie.

Gjatë zbatimit, mendimet dhe sugjerimet e mbledhura përmes Platformës Kombëtare të Pjesëmarrjes integrohen në proceset e raportimit dhe mund të nxisnin planifikimin e vlerësimeve tematike. Mbledhja e mendimeve në mënyrë të strukturuar së bashku me

vlërësimet e kryera do të ushqejnë raportin vjetor dhe vlerësimin afatmesëm të Planit, duke mundësuar rishikimin dhe përmirësimin e masave për vitet në vijim.

2.5.2. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi

2.5.2.1. Qëllimi dhe parimet

Korniza e monitorimit, raportimit dhe vlerësimit synon të sigurojë që zbatimi i PKVBPPRE 2030 të jetë **i bazuar në evidencë, i orientuar drejt rezultateve, i matshëm dhe transparent**. Në përputhje me rekomandimet e BE-së, monitorimi i Planit mbështetet, sa të jetë e mundur, në **portofolin e treguesve të zhvilluar nga Komisioni Evropian**,⁴⁵ si dhe në sistemet kombëtare të statistikave e të dhënave administrative të institucioneve përgjegjëse, ku është e mundur. Kjo qasje kombinon tregues sasiore dhe cilësorë, të përshtatur me kontekstin.

Përvoja ndërkombëtare tregon se kuadri i monitorimit është më efektiv kur mbështetet nga një arkitekturë e qartë qeverisjeje dhe një cikël të rregullt rishikimi. Në shumicën e vendeve⁴⁶ përdoren sete treguesish që kombinojnë tregues të rekomanduar nga BE dhe kombëtarë, bazuar në të dhëna administrative dhe anketa dytësore. Në këtë kuadër, qasja e monitorimit për Planin udhëhiqet nga disa parime kryesore:

- **Përafrimi me kornizën e treguesve** të BE-së dhe i referencave të Deklaratës së Poznań, duke përdorur, sa të jetë e mundur, kornizën e treguesve të sugjeruar;
- **Përdorimi i të dhënave administrative**. Prioritet i jepet përdorimit të të dhënave ekzistuese për të shmangur barrën e panevojshme institucionale dhe për të rritur qëndrueshmërinë e sistemit;
- **Disagregimi i të dhënave**, aty ku është e mundur, sipas gjinisë, moshës, vendbanimit, aftësisë së kufizuar, statusit socio-ekonomik dhe, kur është e mundur metodologjikisht, sipas përkatësisë në komunitetet romë dhe egjiptiane;
- **Përdorimi i të dhënave dytësore alternative**, në rastet kur të dhënat administrative janë të paplota ose të pamjaftueshme;
- **Pjesëmarrja e komuniteteve dhe shoqërisë civile**, për të siguruar që monitorimi të reflektojë jo vetëm progresin formal, por edhe përvojën reale të aksesit në shërbime, diskriminimit dhe cilësisë së ndërhyrjeve;
- **Mësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm**. Gjetjet nga monitorimi përdoren për të përmirësuar zbatimin e masave dhe për të informuar ciklet e ardhshme të planifikimit strategjik.

Zbatimi i plotë i PKVBPPRE 2030 paraprihet nga një fazë përgatitore gjashtë mujore, me synim testimin dhe konsolidimin e mekanizmave të nevojshëm për zbatimin në shkallë kombëtare. Kjo fazë përqendrohet në vënien në funksion të mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor dhe testimin e proceseve të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet aktorëve. Gjithashtu, thelbësore në fazën përgatitore është hartëzimi i të dhënave, identifikimi i boshllëqeve dhe përcaktimi i treguesve të ndikimit, përfshirë zgjidhjet alternative për vlerat bazë të treguesve, burimin dhe mbledhjen e të dhënave si dhe strukturën e raportimit të tyre. Ky proces përfshin dhe zhvillimin e instrumenteve dhe metodologjive për monitorimin e treguesve si dhe identifikimin e

⁴⁵ Komisioni Evropian (2020). "Portfolio of Indicators", ANNEX II to COM (2020), 620 final, 07.10.2020.

⁴⁶ Komisioni Evropian (2024). "Report on the implementation of the national Roma strategic frameworks", COM(2024) 422 final, 25.09.2024.

nevojave për përshtatje ligjore apo institucionale. Konkretisht e rëndësishme për fazën përgatitore është prioritizimi i hapave të përmbledhur në figurën e mëposhtme:

Figura 1. Hapat prioritare për fazën përgatitore



2.5.2.2. Korniza e monitorimit

Korniza e monitorimit për PKVBPPRE 2030 mbështetet në portofolin e treguesve të rekomanduar nga Bashkimi Evropian për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve⁴⁷, si dhe në paketën minimale të treguesve të përcaktuar në Deklaratën e Poznań-it për vendet e Ballkanit Perëndimor (RCC, 2019).

Portofoli i treguesve të BE-së kërkon një analizë të mëtejshme për zbatueshmërinë në kontekstin shqiptar. Në Aneksin 2 janë përzgjedhur një grup treguesish bazë, ndërsa në mënyrë graduale, përmes investimeve në sistemet e të dhënave, synohet përafrimi progresiv me treguesit e BE-së. Në përputhje me rekomandimet e BE-së, ky portofol konsiderohet si një “menu” treguesish, nga e cila përzgjidhen dhe përshtaten treguesit më të realizueshëm, të plotësuar me tregues kombëtarë të lidhur me sistemet ekzistuese administrative. Në përputhje me rekomandimet e KE, korniza bën dallim ndërmjet treguesve të strategjik (të ndikimit) të cilët masin ndryshimet reale në shoqëri dhe treguesve të procesit, të cilët masin progresin në zbatimin e masave dhe aktiviteteve sipas matricës së Planit. Konkretisht, korniza e monitorimit synon të jetë realiste për kapacitetet e vendit, e krahasueshme në nivel rajonal dhe e aftë për të prodhuar seri kohore të qëndrueshme

Tabela 3. Korniza e bazë e monitorimit, sipas Deklaratës së Poznań-it

Fusha	Treguesi
Punësimi	Norma e punësimit
	Norma e punësimit në sektorin publik
Strehimi	Numri/përqindja e njësive të banimit me status ligjor (ose informal)
	Përqindja/numri i përfituesve nga strehimi social (ose norma e pastrehësisë)
Arsimi	Norma e regjistrimit në arsimin fillor
	Norma e përfundimit të arsimit fillor
	Norma e regjistrimit në arsimin e mesëm
	Norma e përfundimit të arsimit të mesëm
Shëndetësia	Norma e mbulimit me sigurim shëndetësor
Regjistrimi civil	Numri i personave të peregjistruar
Antigjipsizmi	Norma e përjetimit të diskriminimit

Pas vlerësimit të treguesve bazë (Poznań) dhe atyre të sugjeruar në portofolin e treguesve të BE-së, do të integrohen gradualisht tregues shtesë në përputhje me sistemet ekzistuese të të

⁴⁷ Komisioni Evropian (2020), “Portfolio of indicators”, Annex II to COM(2020) 620 final, 07.10.2020.

dhënave. Gjatë fazës përgatitore (6 mujori i parë pas miratimit të planit), vlerësimi dhe përzgjedhja e treguesve strategjik do të marrë në konsideratë kapacitetet ekzistuese të mbledhjes së të dhënave, në bashkëpunim institucionet përgjegjëse për mbledhjen e treguesve sektorialë. Treguesit strategjikë do të përditësohen gradualisht gjatë zbatimit të Planit, bazuar në përmirësimin e sistemeve të mbledhjes së të dhënave administrative dhe statistikore, si dhe në përputhje me metodologjitë e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) e EUROSTAT. Në rastet kur mungojnë të dhëna të disagreguara sipas etnisë, në përputhje me angazhimet e vendit (Deklarata e Poznań) institucionet përgjegjëse do të zhvillojnë gradualisht mekanizmat statistikore administrative për të siguruar mbledhjen e këtyre të dhënave, nisur fillimisht nga treguesit bazë (Tabela 3, më sipër); në përputhje me standardet për mbrojtjen e të dhënave personale, vetëidentifikimin vullnetar dhe parimin e mosdiskriminimit. Korniza paraprake e treguesve strategjikë paraqitet në Aneksin 2.

2.5.3. Aktorët përgjegjëse dhe burimet e të dhënave

MSHMS, përmes Koordinatorit Kombëtar, Sekretariatit Teknik dhe Grupit Ndërinstitucional të Koordinimit mbikëqyr kornizën e përgjithshme të monitorimit dhe raportimit. INSTAT mbështet vlerësimin e cilësisë së të dhënave administrative, kontribuon në përpunimin e të dhënave statistikore dhe mbështetjen në zhvillimin e baseline-ve, sipas nevojës për tregues të caktuar. Institucionet përgjegjëse e sektoriale caktojnë pika fokale për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave sektoriale, bashkëpunimin me Sekretariatit Teknik për raportimin periodik të progresit si dhe pjesëmarrjen në takimet periodike të monitorimit.

Burimet kryesore të të dhënave statistikore do të përfshijnë:

- sistemet administrative të MA për arsimin;
- sistemet e mbrojtjes sociale (NE e aftësia e kufizuar, REKSHKSH) dhe SHSSH lidhur me shërbimet sociale dhe përfituesit nga komunitetet.
- sistemet e AKPA për punësimin dhe aftësimin;

sistemet administrative të kujdesit parësor, MSHMS, Drejtoria e Shëndetit Publik/Instituti i Shëndetit Publik dhe burime të tjera të MSHMS për shëndetësinë;

- regjistrat e MPB për regjistrimin civil dhe dokumentimin;
- të dhënat e MD, konkretisht lidhur me aksesin në drejtësi përmes raportimeve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas;
- të dhëna nga KMD për rastet e diskriminimit;
- të dhëna nga MEI dhe bashkitë lidhur me strehimin.
- INSTAT lidhur me të dhënat kombëtare me bazë anketash, përfshirë Censin dhe të dhëna të tjera administrative.

Në nivel vendor, bashkitë luajnë rol qendror në mbledhjen, analizën dhe raportimin e të dhënave, veçanërisht në fushat e shërbimeve sociale, strehimit, identifikimit të rasteve dhe monitorimit të aksesit në shërbime. Ky rol mbështetet përmes formateve të standardizuara të raportimit dhe koordinimit me strukturat qendrore dhe rajonale.

Shoqëria civile dhe përfaqësuesit e komuniteteve përbëjnë një burim të rëndësishëm plotësues, duke kontribuar me evidenca nga terreni mbi cilësinë shërbimeve, barrierat dhe rastet e diskriminimit. Këto kontribute do të integrohen në mënyrë të strukturuar përmes Platformës të Pjesëmarrjes dhe diskutohen në mekanizmat përkatës të koordinimit.

2.5.4. Vlerësimi

Zbatimi i PKVBPPRE 2030 do të vlerësohet përmes dy momenteve kryesore (1) **vlerësimi afatmesëm (2028)**, i cili do të shqyrtojë progresin, funksionimin e mekanizmave të koordinimit dhe monitorimit, si dhe nevojën për përshtatje të masave; dhe (2) **vlerësim përfundimtar (2030)**, që do të analizojë rezultatet, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve. Përtej këtyre dy vlerësimeve, procesi do të përfshijë edhe mekanizma të rishikimit periodik të zbatimit, duke përdorur të dhënat periodike (gjashtëmujore) nga institucionet dhe bashkitë, aty ku janë të disponueshme; raportimet e Sekretariatit Teknik dhe Grupit Ndërinstitucional; evidencat nga shoqëria civile dhe Platforma e Pjesëmarrjes; si dhe gjetje nga studime, vlerësime tematike dhe analiza të pavarura. Në këtë mënyrë, monitorimi dhe vlerësimi nuk trajtohen si procese të shkëputura, por si mekanizma të integruar dhe të vazhdueshëm për rishikimin dhe përmirësimin e ndërhyrjeve.

Gjithashtu, sipas nevojës, mund të realizohen vlerësime tematike sektoriale, me fokus në fusha apo bashki specifike, ose në funksionimin e mekanizmave vendorë.

2.5.5. Raportimi

Raportimi organizohet në disa nivele dhe, në përputhje me natyrën e treguesve dhe formatet e raportimit, të cilat do të përgatiten gjatë fazës përgatitore (6 muaji i parë pas miratimit të Planit). Institucionet përgjegjëse përgatisin raporte periodike gjashtë mujore mbi zbatimin e masave dhe progresin ndaj treguesve përkatës, ndërsa MSHMS përgatit raportin vjetor. Sekretariati Teknik, pranë Koordinatorit Kombëtar, ka detyrën të mbledhë dhe konsolidojë raportimet nga ministritë, agjencitë dhe bashkitë, analizojë progresin ndaj vlerave bazë dhe treguesve të performancës, të përgatisë raportin vjetor kombëtar të progresit si dhe të prezantojë gjetjet në Grupin Ndërinstitucional Teknik, në Platformën Kombëtare të Pjesëmarrjes dhe në Grupin Tematik të Koordinimit Ndërinstitucional (IPMG). Në funksionin të transparencës dhe llogaridhënies, raportet e progresit dhe vlerësimit publikohen dhe diskutohen me aktorët kryesorë, përfshirë institucionet publike, shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e komuniteteve.

PJESA 3: FINANCIMI

Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve mbështetet në një qasje të qëndrueshme të planifikimit financiar, e cila garanton vijimësinë e ndërhyrjeve dhe konsolidimin gradual të rezultateve në shtatë fushat prioritare.

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e këtij plani veprimit është rreth 2.3 miliardë lekë për periudhën pesëvjeçare 2026–2030. Struktura e financimit është projektuar në mënyrë progresive, duke nisur me 348 milionë lekë në vitin e parë (2026), 431 milionë lekë në vitin e dytë (2027), 464 milionë lekë në vitin e tretë (2028), dhe 1.1 miliardë lekë në dy vitet e fundit (2029 dhe 2030), në përputhje me rritjen e kapaciteteve institucionale dhe shtrirjen e shërbimeve në nivel vendor. Ky planifikim gradual reflekton nevojën që investimet të shkallëzohen ndërkohë që sistemet konsolidohen.

Baza e financimit është buxheti i shtetit, i cili mbulon 88% të kostos në vitin e parë dhe ruan mbulim solid prej rreth 79% në vitet 2027–2029, kur kostot e strehimit dhe shërbimeve rriten ndjeshëm. Për të gjithë periudhën pesëvjeçare, buxheti kombëtar siguron 1,87 miliardë lekë, ose 80% të kostos totale. Kjo nënkupton se pjesa dërrmuese e planit të veprimit nuk kërkon burime të reja jashtë kornizës buxhetore ekzistuese, por riorientim dhe koordinim më efektiv të burimeve tashmë të alokuara në programet: Arsimi Bazë (09120), Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Parësor (07220), Strehimi (06190), Tregu i Punës (10550), Përkujdesja Sociale (10430), Ndihma Juridike Falas (03310) dhe Gjendja Civile (01170). Më shumë se gjysma e hendekut financiar është parashikuar në fushën e strehimit, duke reflektuar nevojën për një mbështetje në rritje të politikave të strehimit nëpërmjet zgjerimit të fondeve dhe investimeve publike.

Qëndrueshmëria financiare e planit forcohet nga një strukturë e diversifikuar burimesh. Partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit kontribuojnë me rreth 98 milionë lekë (4.2%), me kontribut të BE-së dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë të fokusuar në regjistrim civil dhe ndihmë juridike, në shëndetësi, arsim dhe luftën kundër diskriminimit. Ky angazhim i partnerëve pasqyron besimin ndërkombëtar në qëndrueshmërinë dhe ambicien e planit, si dhe përputhet me prioritetet e Procesit të Berlinit dhe të Kornizës Strategjike të BE-së për Romët 2020–2030.

Pushteti vendor është aktor kyç i financimit dhe zbatimit, sidomos në fushat e strehimit, mbrojtjes sociale dhe shërbimeve komunitare. Bashkitë, si ofruesit kryesorë të shërbimeve sociale, do të përfshihen gradualisht në buxhetimin e dedikuar për këto aktivitete, përmes fondit social, mbështetjes së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe ministrive të linjës. Ky proces është i mbështetur në strukturat ekzistuese institucionale në nivel vendor, duke garantuar vijimësinë e financimit edhe pas periudhës së planit të veprimit.

Hendeku financiar i identifikuar, i parashikuar kryesisht në fushat e strehimit dhe mbrojtjes sociale, do të adresohet përmes mobilizimit aktiv të instrumenteve të financimit europian dhe ndërkombëtar, duke përfshirë mundësinë e instrumenteve të financimit të BE-së për periudhën 2026–2030. Kjo qasje proaktive ndaj hendekut nënkupton se plani është i

zbatueshëm edhe në skenarin buxhetor bazë, ndërkohë që burimet shtesë të partnerëve do të mundësojnë zgjerim dhe thellim të ndërhyrjeve.

Kostoja e planit të veprimit specifikon për çdo qëllim politikash dhe nënobjektiv lidhjen me programin buxhetor sipas fushave kryesore. Fusha me investimin më të lartë është mbrojtja sociale (Qëllimi 5) me rreth 122 milionë lekë në vit) dhe strehimi (Qëllimi 3) me rreth 90 milionë lekë në vit, duke pasqyruar vendosmërinë për adresimin strukturor të varfërisë dhe përjashtimit social. Arsimi (Qëllimi 1) dhe shëndetësia (Qëllimi 2) paraqesin trajektore financimi në rritje progresive, duke reflektuar natyrën strukturore të ndryshimit të synuar dhe nevojën për investime të qëndrueshme afatgjata.

4. REFERENCAT

1. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (2023). *Analiza Vjetore*. Aksesuar [këtu](#).
2. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (2024). *Analiza Vjetore*. Aksesuar [këtu](#).
3. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (2025). *Analiza Vjetore*. Aksesuar [këtu](#).
4. Avokati i Popullit (2025). *Rekomandime lidhur me procesin e regjistrimit civil të pakicave kombëtare romë dhe egjiptiane*, 15 korrik 2025. Aksesuar [këtu](#).
5. Berlin Process (2024). *Fifth Roma Ministerial Meeting Conclusions*. Berlin, 2024. Aksesuar [këtu](#).
6. Council of the European Union (2000). “*Council Directive 2000/43/EC of 29 June 2000 implementing the principle of equal treatment between persons irrespective of racial or ethnic origin*”. Official Journal of the European Communities, L 180, 19.07.2000. CELEX: 32000L0043.
7. Council of the European Union (2021). “*Council Recommendation of 12 March 2021 on Roma equality, inclusion and participation (2021/C 93/01)*”. Official Journal of the European Union, C 93, 19.03.2021. CELEX: 32021H0319(01).
8. Council of the European Union (2022). “*Council Recommendation of 28 November 2022 on pathways to school success and replacing the Council Recommendation of 28 June 2011 on policies to reduce early school leaving (2022/C 469/01)*”. Official Journal of the European Union, C 469, 09.12.2022. CELEX: 32022H1209(01) Aksesuar [këtu](#).
9. *European Commission (2026). The European Union’s Anti-Poverty Strategy: addressing and preventing poverty from childhood to old age*. COM(2026) 538 final, Brussels, 6.05.2026. CELEX: 52026DC0538. Aksesuar [këtu](#)
10. *European Commission (DG NEAR). Berlin Process: Third Roma Ministerial meeting strengthens commitment to step up efforts on inclusion”, 29.06.2021.*
11. European Commission (2020). *Portfolio of indicators, Annex II to the Communication A Union of Equality: EU Roma Strategic Framework for Equality, Inclusion and Participation*, COM(2020) 620 final, Brussels, 7.10.2020. Aksesuar në: Aksesuar [këtu](#).
12. European Commission (2024). *Albania 2024 Report, Commission Staff Working Document*, Brussels, 30.10.2024. SWD(2024) 690 final. Aksesuar [këtu](#).
13. European Commission (2024). *Report on the implementation of the national Roma strategic frameworks in light of the EU Roma strategic framework for equality, inclusion and participation and the Council Recommendation on Roma equality, inclusion and participation*. Brussels, 25.09.2024. Aksesuar [këtu](#).
14. European Commission (2025). *Albania 2025 Report, Commission Staff Working Document*, SWD(2025) 750 final, datë 04.11.2025. Aksesuar [këtu](#).
15. European Union Agency for Fundamental Rights (FRA) (2025). *Rights of Roma and Travellers in 13 European Countries – Perspectives from the Roma Survey 2024*. Vjenë: FRA. Aksesuar [këtu](#).
16. European Union Agency for Fundamental Rights (FRA) (2025). *Roma Survey 2024: Data and maps*. Aksesuar [këtu](#).

17. INSTAT (2023). *Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri 2023. Gjetjet kryesore*. Aksesuar [këtu](#).
18. INSTAT (2025). *Fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri: Censi 2023 – Raporti tematik i thelluar*. Tiranë: Instituti i Statistikave. Aksesuar [këtu](#).
19. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 152, datë 13.03.2024, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030”. Aksesuar [këtu](#).
20. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 16, datë 11.01.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026”. Aksesuar [këtu](#).
21. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 173, datë 15.03.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030”. Aksesuar [këtu](#).
22. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 199, datë 26.03.2026, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Garancisë Evropiane për Fëmijët, 2026–2030”. Aksesuar [këtu](#).
23. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 210, datë 06.04.2022, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021–2030”. Aksesuar [këtu](#).
24. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 271, datë 02.05.2024, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024–2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024–2026”. Aksesuar [këtu](#).
25. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 400, datë 30.06.2021, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030”. Aksesuar [këtu](#).
26. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 401, datë 19.06.2024, “Për përcaktimin e procedurave, kritereve dhe rregullave për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegrimit social”. Aksesuar [këtu](#).
27. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 544, datë 28.08.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikave të përfshirjes sociale 2024–2028”. Aksesuar [këtu](#).
28. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 621, datë 22.10.2021, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”. Aksesuar [këtu](#).
29. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 659, datë 03.11.2021, “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2021–2026”. Aksesuar [këtu](#).
30. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 729, datë 13.12.2023, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030”. Aksesuar [këtu](#).
31. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 787, datë 18.12.2024, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030”. Aksesuar [këtu](#).
32. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim Nr. 88, datë 22.02.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”. Aksesuar [këtu](#).
33. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2024). *Raporti Vjetor 2024*. Aksesuar [këtu](#).
34. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2016). Ligj Nr. 121, datë 24.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Aksesuar [këtu](#).

35. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2019). Ligj Nr. 57, datë 28.08.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Aksesuar [këtu](#).
36. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligj Nr. 10 383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 65, datë 21.07.2023. Aksesuar [këtu](#).
37. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligj Nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.
38. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligj Nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar më 02.11.2023.
39. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligj Nr. 15, datë 13.03.2019, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar më 24.07.2023. Aksesuar këtu.
40. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligj Nr. 15, datë 16.02.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar më 18.04.2024. Aksesuar [këtu](#).
41. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligj Nr. 22, datë 03.05.2018, “Për strehimin social”, i ndryshuar më 27.07.2023. Aksesuar [këtu](#).
42. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligj Nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar më 12.09.2024. Aksesuar [këtu](#).
43. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligj nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar më 09.02.2022. Aksesuar [këtu](#).
44. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligj Nr. 96, datë 13.10.2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.
45. Ministria e Arsimit (2025). *Vjetari Statistikor për Arsimin 2023-2024*. Aksesuar [këtu](#).
46. Ministria e Arsimit. *Të dhëna administrative për arsimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve romë dhe egjiptianë 2025 dhe 2026*.
47. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (2024). *Progres Raporti i Zbatimit të Planit të Garancisë Rinore 2024*. Aksesuar [këtu](#).
48. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2026). *Raporti i Monitorimit të zbatimit të PKVBPPRE 2021-2025*.
49. Mone I, Vasil S, Alia A, Xinxo S, Muça K, Burazeri G. (2023). *Socio-Demographic Correlates of Barriers to Access Healthcare Services among Children in Post-Communist Albania*. Sustainability. 2023; 15(11):8455. Aksesuar [këtu](#).
50. Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (2024). *Studim për Qasjen në Drejtësi në Shqipëri*. Aksesuar [këtu](#).
51. Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (2025). *Hartëzimi i Shërbimeve Sociale në Shqipëri*. Tiranë. Aksesuar [këtu](#).
52. Regional Cooperation Council (RCC) (2019). *Declaration of Western Balkans Partners on Roma Integration within the EU Enlargement Process*. Poznan, 05.07.2019. Aksesuar [këtu](#).
53. UNESCO International Institute for Educational Planning (IIEP-UNESCO) (2024). *Education Sector Analysis: Albania*. Paris: IIEP-UNESCO. Aksesuar [këtu](#).

54. World Bank (2019). *Roma Briefs: Europe and Central Asia – Albania*. Based on the 2017 UNDP–World Bank–EC Regional Roma Survey. Washington, DC: World Bank. Aksesuar [këtu](#).

5. ANEKSET

ANEKSI 1: Matrica E Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030

Fusha Prioritare 1: Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor	53
Objektivi specifik 1.1: Rritja e aksesit, pjesëmarrjes, dhe përfundimit të arsimit për fëmijët, nxënësit dhe studentët romë dhe egjiptianë në të gjitha nivelet.	53
Objektivi specifik 1.3: Promovimi i njohjes, përfaqësimit dhe dialogut ndërkulturor për romët dhe egjiptianët në arsim dhe hapësirën publike.	56
Fusha Prioritare 2: Punësimi dhe Formimi Profesional	58
Objektivi specifik 2.1: Rritja e pjesëmarrjes, përfundimit dhe punësimit të romëve dhe egjiptianëve përmes formimit profesional dhe masave aktive të tregut të punës.	58
Objektivi specifik 2.2: Fuqizimi ekonomik i romëve dhe egjiptianëve përmes vetëpunësimit, sipërmarrjes dhe formalizimit të aktiviteteve ekonomike dhe përfshirjes në sektorë me potencial, përfshirë ekonominë e gjelbër.	60
Objektivi specifik 2.3: Përmirësimi i aksesit të barabartë në punësim dhe reduktimi i diskriminimit në tregun e punës.	61
Fusha Prioritare 3: Strehimi.....	63
Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i sigurisë së strehimit përmes legalizimit, formalizimit të vendbanimit dhe zgjidhjeve alternative të qëndrueshme.	63
Objektivi specifik 3.2: Rritja e aksesit në programet e strehimit social dhe përmirësimi i kushteve të banimit për familjet më të cënueshme.	63
Objektivi specifik 3.3: Parandalimi i segregimit rezidencial dhe përmirësimi i aksesit në infrastrukturë dhe shërbime bazë.	64
Fusha Prioritare 4: Kujdesi Shëndetësor	66
Objektivi specifik 4.1: Rritja e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve shëndetësore parësore dhe parandaluese.	66
Objektivi specifik 4.2: Forcimi dhe institucionalizimi i sistemit të mediatorëve shëndetësorë dhe rritja e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në sektorin shëndetësor.	67
Objektivi specifik 4.3: Rritja e edukimit shëndetësor dhe përdorimit të shërbimeve parandaluese në komunitetet romë dhe egjiptiane.	68
Fusha Prioritare 5: Varfëria dhe përjashtimi social	70
Objektivi specifik 5.1: Rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në shërbimet e integruara dhe forcimi i mekanizmave të identifikimit dhe menaxhimit të rasteve.	70
Objektivi specifik 5.2: Forcimi i mekanizmave vendorë për përgatitjen dhe reagimin ndaj krizave dhe emergjencave.	72
Fusha Prioritare 6: Antigjipsizmi	74

<i>Objektivi specifik 6.1: Integrimi i konceptit të antigjipsizmit në kuadrin ligjor, strategjik dhe institucional të politikave publike.</i>	74
<i>Objektivi specifik 6.2: Forcimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin dhe adresimin e diskriminimit dhe antigjipsizmit.</i>	74
<i>Objektivi specifik 6.3: Rritja e ndërgjegjësimin publik dhe promovimi i narrativave pozitive për romët dhe egjiptianët.</i>	75
Fusha Prioritare 7: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil	77
<i>Objektivi specifik 7.1: Përmirësimi i regjistrimit civil dhe dokumentimit të romëve dhe egjiptianëve përmes eliminimit të barrierave administrative dhe financiare.</i>	77
<i>Objektivi specifik 7.2: Rritja e aksesit në ndihmën juridike falas dhe shërbimet elektronike publike.</i>	78
ANEKSI 2. Korniza e indikatorëve strategjik të monitorimit	81
ANEKSI 3. Financimi 2026-2030	86
ANEKSI 4 Dokumentet strategjike dhe kuadri ligjor relevant për PKV	93
ANEKSI 5. Shkurtesat.....	99

Shënim: Institucioni i renditur i pari në kolonën “Institucionet përgjegjëse” është institucioni udhëheqës/përgjegjës kryesor, ndërsa institucionet e tjera të listuara janë institucione kontribuese., në përputhje me mandatet përkatëse institucionale.

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 1: Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor							
Qëllimi i Politikës 1: Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët dhe promovimi i përfaqësimit dhe dialogut ndërkulturor.							
Objektivi specifik 1.1: Rritja e aksesit, pjesëmarrjes, dhe përfundimit të arsimit për fëmijët, nxënësit dhe studentët romë dhe egjiptianë në të gjitha nivelet.							
Masa 1.1.1: Zbatimi i mekanizmave vendorë për identifikimin, regjistrimin dhe monitorimin e vijimësisë së fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor, të detyrueshëm.	a. Zbatimi i mekanizmave vendorë për identifikimin, regjistrimin dhe monitorimin e vijimësisë të fëmijëve R/E në arsimin parashkollor dhe të detyrueshëm (në bashkëpunim me strukturat arsimore dhe shërbimet sociale).	2026-2030	2,147 (2024) fëmijëve R/E në arsimin parashkollor (MA, 2024); 26.5% romë dhe 38.3% egjiptianë regjistruar në arsimin parashkollor; ⁴⁸ 9,503 nxënës në arsimin e detyrueshëm (MA, 2024); 1,660 raste të identifikuar/referuara në kohë në arsimin parashkollor dhe bazë (MA, 2025).	% e fëmijëve R/E (3-6 vjeç) të regjistruar në arsimin parashkollor; % e fëmijëve R/E në moshën shkollore të regjistruar në arsimin e detyrueshëm; Numri i rasteve të identifikuar dhe referuara.	≥50% regjistrim i fëmijëve R/E (3-6 vjeç) në arsimin parashkollor; ≥95% regjistrim në arsimin e detyrueshëm; Rritje progressive vjetore ≥5% ≥1,900 raste të identifikuar/referuara në kohë në arsimin parashkollor dhe bazë në 2030.	NJVV, MA, AKAP/ DRAP/ZVAP	Buxheti i shtetit
	b. Përcaktimi i profilit funksional, trajnimi dhe vendosja e mediatorëve arsimorë për ndërmjetësimin ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit, dhe ndjekjen e rasteve në rrezik.	2026-2030	28 mediatorë në institucionet arsimore publike në 4 bashki (MA, 2025); Profil funksional i pa standardizuar.	Profil funksional i mediatorit i miratuar; Numri i mediatorëve të trajnuar dhe aktivë në sistem; Numri i rasteve të trajtuara.	Profil funksional i miratuar deri në 2027 (MA); ≥50% bashki me mediatorë aktivë në të gjitha bashkitë prioritare deri në 2030 (NJVV); rritje progresive vjetore e rasteve të trajtuara.	MA, NJVV, AKAP/ DRAP/ZVAP	Buxheti i shtetit, donatorë
Masa 1.1.2: Zbatimi i programeve të integruara për mbështetjen e vijimësisë, përfundimit dhe rikthimit në arsim.	a. Ofrimi i programeve të mbështetjes arsimore pas mësimin (after-school), përfshirë mbështetje për detyrat dhe zhvillimin e kompetencave bazë në institucionet arsimore prioritare (institucionet	2026-2030	678 përfitues të programeve mbështetëse arsimore (MA, 2025).	%/numri i shkollave prioritare që ofrojnë programe; Numri i nxënësve R/E përfitues nga programet mbështetëse arsimore (programe pas mesimit	≥70% e shkollave prioritare ofrojnë programe; ≥ 775 përfitues të programeve mbështetëse arsimore (MA, 2030).	MA, NJVV, AKAP, institucionet zbatuese të programeve pas shkolle; OJF	Buxheti i shtetit, donatorë

⁴⁸ Vlera bazë nga INSTAT (2025). Fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri. Censusi 2023. Raport temati bazuar në të dhënat nga Censi 2023.

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 1: Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor							
Qëllimi i Politikës 1: Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët dhe promovimi i përfaqësimit dhe dialogut ndërkulturor.							
	zbatuese dhe shkollat qendër komunitare)			dhe mësim i gjuhës rome).			
	b. Zbatimi i programeve për identifikimin e fëmijëve R/E jashtë sistemit arsimor dhe rikthimin e riintegrimin e tyre në arsimin formal.	2026-2030	2,571 marrin pjesë dhe përfundojnë arsimin bazë përmes programeve me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme (MA, 2025).	Numri i nxënësve R/E që përfundojnë arsimin bazë.	≥ 2,950 marrin pjesë dhe përfundojnë arsimin bazë.	NJVV , AKAP/DRAP/ZV A, OJF	Buxheti i shtetit, donatorë
	c. Zbatimi dhe zgjerimi i skemave mbështetëse financiare për reduktimin/përrjashtimin e tarifave, për R/E në arsimin parauniversitar.	2026-2030	10 bashki që zbatojnë skema mbështetëse financiare (MA, 2025).	% e nxënësve të mbuluar nga skemat mbështetëse.	≥90% e nxënësve në nevojë transporti të mbuluar.	MA (orientues), NJVV (zbatues), MF	Buxheti i shtetit, NJVV
	ç. Sigurimi i transportit falas për nxënësit R/E që banojnë larg institucioneve arsimore.	2026-2030	648 përfitues (MA, 2025).	Numri i nxënësve që përfitojnë transport falas; % e kërkesave të mbuluara.	≥745 përfitues; ≥90% mbulim.	MA , NJVV	Buxheti i shtetit
	d. Zgjerimi/rishikimi i skemave të bursave për nxënësit R/E në arsimin e detyrueshëm dhe të mesëm (në mbështetje të vijimësisë si dhe të lidhur me mekanizmin e referimit të nxënësve në rrezik braktisjeje drejt programeve AFP sipas Masës 2.1.3.)	2026-2030	457 bursa në arsimin bazë dhe të mesëm (MA, 2025).	Numri i bursave të akorduara sipas nivelit arsimor; Numri i nxënësve të referuar nga skema e bursave drejt AFP.	≥5% bursa në vit; ≥100 nxënës R/E të arsimit të mesëm të referuar në AFP deri në 2030.	MA , MEI/AKPA, NJVV	Buxheti i shtetit
	dh. Ofrimi i bursave dhe reduktimi ose përjashtimi i tarifave për studentët R/E në arsimin e lartë.	2026-2030	Nuk ka të dhëna të konsoliduara (do të përcaktohet në fund të 2026).	Numri i studentëve përfitues nga bursa, përjashtim/reduktim tarifash.	≥ 15% rritje vjetore	MA , AKFAL, IAL, MF	Buxheti i shtetit
Objektivi specifik 1.2: Përmirësimi i barazisë dhe gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor për romët dhe egjiptianët dhe reduktimit të segregimit dhe diskriminimit.							

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 1: Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor							
Qëllimi i Politikës 1: Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët dhe promovimi i përfaqësimit dhe dialogut ndërkulturor.							
Masa 1.2.1: Përmirësimi i cilësisë, gjithëpërfshirjes, dhe mos diskriminimit në sistemin arsimor.	a. Trajnimi i detyrueshëm i mësuesve, psikologëve dhe punonjësve socialë për arsimin gjithëpërfshirës dhe antigjipsizmin.	2026-2030	65% e stafit arsimor i trajnuar në arsimin gjithëpërfshirës (MA, 2025).	% e stafit të trajnuar; Numri i trajnimeve.	≥90% e personelit	MA, ASCAP, AKAP, IAL	Buxheti i shtetit
	b. Integrimi i temës së antigjipsizmit në kurrikulat shkollore e programe trajnimi	2026-2030	0 kurrikula arsimore e module trajnimi me antigjipsizëm të integruar.	Numri i kurrikulave që integrojnë konceptin e antigjipsizmit; Integrimi i konceptit të antigjipsizmit dhe diskriminimit në modulet e trajnimit të mësuesve mbi arsimi gjithëpërfshirës;	≥3 kurrikula deri në 2028 (histori, qytetari dhe gjuhë shqipe letërsi); Antigjipsizmi i integruar si temë brenda moduleve të trajnimit për arsimin gjithëpërfshirës.	ASCAP AKAP, MA, Institucionet arsimore	Buxheti i shtetit
	c. Trajnimi i mësuesve mbi antigjipsizmin dhe diskriminimin.	2026-2030	169 drejtues rrjetesh të profileve gjuhë shqipe letërsi, histori, gjeografi, qytetari dhe gjuhë të huaja (ASCAP, 2025).	Numri i mësuesve të trajnuar mbi antigjipsizmin (si pjesë e trajnimeve të dedikuara mbi antigjipsizmin dhe diskriminimin apo në kuadër të arsimit gjithëpërfshirës).	≥600 deri në 2030	MA, ASCAP, AKAP, DRAP/ZVAP	Buxheti i shtetit
	ç. Vlerësimi dhe rishikimi i kurrikulave dhe teksteve shkollore për eliminimin e stereotipeve dhe përfshirjen e historisë dhe kulturës rome dhe egjiptiane.	2026-2030	25% e teksteve/kurrikulave të rishikuara (MA, 2025); Udhëzues për përfshirjen e kulturës rome i miratuar (MA, 2024); 30 mësues dhe drejtues në kopshte dhe shkolla të trajnuar (MA, 2022).	Numri/% i/e kurrikulave/ teksteve të rishikuara për përfshirjen e historisë dhe kulturës rome dhe egjiptiane; Numri i mësuesve të trajnuar.	≥80% e kurrikulës/teksteve të rishikuara; ≥90% e stafit akademik përkatës të trajnuar.	MA, ASCAP, AKAP, IAL/eksperte akademike	Buxheti i shtetit
	d. Integrimi i treguesve që masin segregimi në sistemin e monitorimit të shkollave/klasave dhe	2026-2030	1 shkollë/Naim Frashëri, në Korçë (KMD, 2024); Sistemi i monitorimit nuk ka tregues specifikë për	Tregues të monitorimit të segregimit të integruar në sistemin të monitorimit;	Sistem kombëtar funksional me treguesit e matjes së	MA, AKAP, NJVV, Institucionet arsimore;	Buxheti i shtetit

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 1: Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor							
Qëllimi i Politikës 1: Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët dhe promovimi i përfaqësimit dhe dialogut ndërkulturor.							
	zbatimi i planeve vendore për adresimin e rrezikut të identifikuar.		matjen e segregimit. Disa të dhëna paraprake gjenden në anketën e FRA 2024 (Aneksi 2).	Numri i shkollave që në rrezik; % e nxënësve R/E në shkolla të segreguara me ≥50% nxënës R/E; % e fëmijëve R/E në klasa të segreguara; Numri i planeve korrigjuese të miratuara dhe zbatuara.	segregimit deri në Q4 2027; ≥1 plan korrigjues për çdo shkollë me rrezik të lartë; 0% e fëmijëve në shkolla me segregim të plotë; Ulje % së fëmijëve R/E në klasa të segreguara (< 20%) ⁴⁹	MSHMS, KMD	
Objektivi specifik 1.3: Promovimi i njohjes, përfaqësimit dhe dialogut ndërkulturor për romët dhe egjiptianët në arsim dhe hapësirën publike.							
Masa 1.3.1: Promovimi i kulturës, historisë, dhe dialogut ndërkulturor.	a. Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës së gjuhës rome në arsimin parauniversitar, me trajnimin e mësuesve përkatës.	2026-2030	2 institucione arsimore me mësim të gjuhës rome (MA, 2025).	Numri i institucioneve arsimore që ofrojnë mësimin e gjuhës rome; Numri i mësuesve të trajnuar.	≥ 15 institucione dhe stafet akademike përkatëse.	MA, ASCAP, AKAP, Institucionet arsimore, OJF	Buxheti i shtetit
	b. Programi i integruar për promovimin e kulturës dhe kontributit të R/E, përmes aktiviteteve kulturore, përfshirjes në media dhe kalendarë publikë, si dhe financimit të projekteve kulturore.	2026-2030	≥ 10 aktivitete kulturore (MTKS, 2025); 8 programe/dokumentarë (MTKS, 2025); 5 projekte kulturore të financuara (MTKS, 2025).	Numri i aktiviteteve; % e bashkive me aktivitete në kalendarët publikë; Numri i programeve/dokumentarëve; Numri projekteve dhe materialeve kulturore të financuara.	≥ 30 evente (2030); ≥70% e bashkive pjesëmarrëse; ≥16 programe/dokumentarë; ≥15 projekte/materiale kulturore.	MTKS, NJVV, Media, QKLL, IAL, OJF	Buxheti i shtetit
	c. Mbështetja e botimeve dhe materialeve kulturore në gjuhën rome.	2026-2030	5 materiale (MTKS, 2025)	Numri i materialeve kulturore të mbështetura.	≥10 materiale	MTKS, QKLL, IAL, OJF	Buxheti i shtetit

⁴⁹ Nga 23–24% sipas FRA “Roma Survey 2024” në nën 20%.

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 1: Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor							
Qëllimi i Politikës 1: <i>Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët dhe promovimi i përfaqësimit dhe dialogut ndërkulturor.</i>							
	ç. Rritja e përfaqësimit të R/E në institucionet publike kulturore	2026-2030	Nuk ka të dhëna (2025)	Numri i R/E të punësuar në institucionet publike të kulturës.	≥20% mbi baseline deri në 2030	MTKS, DAP/institucion et kulturore publike, NJVV	Buxheti i shtetit

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar (2030)	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 2: Punësimi dhe Formimi Profesional							
Qëllimi i Politikës 2: Rritja e përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve në tregun formal të punës dhe fuqizimi ekonomik i tyre.							
Objektivi specifik 2.1: Rritja e pjesëmarrjes, përfundimit dhe punësimit të romëve dhe egjiptianëve përmes formimit profesional dhe masave aktive të tregut të punës.							
Masa 2.1.1: Forcimi i mekanizmave të aktivizimit dhe ndërmjetësimit në tregun e punës për romët dhe egjiptianët.	a. Ofrimi i shërbimeve të këshillimit për karrierë, profilizimit dhe planifikimit individual të punëkërkuarve romë dhe egjiptianë.	2026-2030	5,984 punëkërkuar të regjistruar R/E (AKPA 2025 8.9% e pu.pa.).	Numri i pu.pa. R/ E që marrin; % e pu.pa. të profilizuar.	≥30% mbi vlerën bazë (7.500 përfitues).	AKPA, MEI	Buxheti i shtetit
	b. Zbatimi i programit të riintegritimit social dhe punësimit, në bashkëpunim me ofrues jo-publik të shërbimeve të punësimit (VKM 401).	2026-2030	34 përfitues (bashkitë pilot Elbasan, Gjirokastër dhe Durrës, AKPA, 2025).	Numri i romëve/ egjiptianëve të marrin shërbime të riintegritimit social.	≥30% mbi vlerën bazë (150 përfitues).	AKPA, MEI	Buxheti i shtetit
	c. Organizimi i aktiviteteve informuese e ndërgjegjësuere të synuara për komunitetet R/E për promovimin e programeve të nxitjes.	2026-2030	442 aktivitete (AKPA, 2025)	Numri i aktiviteteve informuese që synojnë komunitetet rome dhe egjiptiane.	≥ 120 (20%) e aktiviteteve të dedikuara.	AKPA, DRAKPA, MEI OJF	Buxheti i shtetit
Masa 2.1.2: Rritja e pjesëmarrjes në formim profesional dhe masave aktive të tregut të punës, si dhe përmirësimin të qëndrueshmërisë në punë.	a. Ndërmjetësimi aktiv i punësimit përmes ndërmjetësimit së punëkërkuarve R/E me punëdhënësit.	2026-2030	887 pu.pa R/E të punësuar (AKPA, 2025).	Numri/% e të punësuarve të ndërmjetësuar.	≥ 1,100 R/E të punësuar deri në 2030.	AKPA, Punëdhënësit/ organizatat e biznesit, NJVV	Buxheti i shtetit
	b. Rritja e pjesëmarrjes të R/E në programet e formimit profesional (publik dhe privat) duke përfshirë si nënkategori prioritarë nxënësit me rrezik braktisjeje të arsimit të mesëm ⁵⁰ dhe të rinjtë në skemën e Garancisë Rinore. ⁵¹	2026-2030	320 përfitues (AKPA, 2025)	Numri i R/E të regjistruar në formim profesional (privat dhe publik); % që përfundojnë; % që certifikohen dhe % që kalojnë në punësim; nga të cilët ≥50 me bursë në AFP publike.	≥ 400 përfitues deri në 2030; ≥70% përfundojnë; ≥40% kalojnë në punësim; ≥50 me bursë në AFP publike.	MEI/AKPA, Ofrues private të AFP, NJVV	Buxheti i shtetit

⁵⁰ koordinim me masën 1.1.2.d

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar (2030)	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 2: Punësimi dhe Formimi Profesional							
Qëllimi i Politikës 2: Rritja e përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve në tregun formal të punës dhe fuqizimi ekonomik i tyre.							
	c. Monitorimi i qëndrueshmërisë në punë pas përfundimit të formimit profesional.	2026-2030	26.9% punësueshmëri për kursantët R/E 6 muaj pas përfundimit të programit (AKPA, 2025).	% e rasteve të mbështetura që kanë qëndrueshmëri në punë pas 6 muajsh dhe pas 12 muajsh.	≥ 40% e rasteve të mbështetura me qëndrueshmëri në punë pas 6-12 muajsh (2030).	AKPA,	Buxheti i shtetit
	ç. Promovimi i punës së denjë dhe përmirësimi i kushteve të punës për R/E, përmes ndërgjegjësimit, monitorimit dhe zbatimit të standardeve të punësimit pa diskriminim.	2026-2030	Nuk ka të dhëna të disagreguara	Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere për punën e denjë; Numri i punëdhënësve të përfshirë; Numri i inspektimeve të kushteve të punës; % e rasteve me përmirësim të kushteve të punës; % e përfituesve R/E të punësuar në mënyrë formale.	≥25 aktivitete ndërgjegjësuere ≥200 punëdhënës; ≥800 raste të monitoruara; ≥50% përmirësim i kushteve të punës; ritje progresive e punësimit formal të R/E.	MEI/AKPA, ISHPSHSH, NJVV MSHMS OJF, Organizatat e punëdhënësve	Buxheti i shtetit
Masa 2.1.3: Mbështetja e integritit të të rinjve romë dhe egjiptianë në tregun e punës përmes Garancisë Rinore, praktikave profesionale dhe arsimit profesional.	a. Përfshirja e të rinjve romë dhe egjiptianë në skemën e Garancisë Rinore .	2026-2030	91 (AKPA, 2025)	Numri i të rinjve romë dhe egjiptianë të përfshirë në skemën e Garancisë Rinore.	≥ 200 (2030)	AKPA, MEI NJVV, Ofrues AFP, AKR	Buxheti i shtetit
	b. Integrimi i të rinjve të diplomuar në praktikat profesionale	2026-2030	10 përfitues R/E në vitin 2025 dhe 23 në (AKPA, 2024).	Numri i përfituesve R/E të praktikave profesionale.	≥ 75 përfitues R/E	AKPA, Punëdhënësit, NJVV	Buxheti i shtetit
	c. Mbështetja për përfshirjen e të rinjve romë dhe egjiptianë në arsimin profesional publik, përfshirë bursat dhe subvencionet. (VKM 666)	2026-2030	10 përfitues (AKPA, 2025).	Numri i përfituesve të bursave dhe subvencione në arsim profesional.	≥ 50 (2030)	AKPA/ofrues AFP, MEI, MA, NJVV	Buxheti i shtetit

⁵¹ koordinim me Masën 2.1.3.a

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar (2030)	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 2: Punësimi dhe Formimi Profesional							
Qëllimi i Politikës 2: Rritja e përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve në tregun formal të punës dhe fuqizimi ekonomik i tyre.							
Masa 2.1.4: Mbështetja e integritit të romëve dhe egjiptianëve administratën publike.	a. Nxitja e punësimit të R/E në administratën publike, përmes preferencës në përzgjedhje në rastet e rezultateve të barabarta.	2026-2030	200 (DAP, 2025)	Përfshirja e kategorisë së R/E në kategoritë prioritare (përmes ndryshimeve ligjore) ⁵² ; Numri i të punësuarve në administratën publike	Ndryshimet ligjore të miratuara e harmonizuara sipas sistemeve të ndryshme (status shërbimi civil ose jo) Rritje progresive (≥30%) (2030)	DAP/Institucio net publike, MEI/AKPA, MSHMS	Buxheti i shtetit
	b. Integrimi i të rinjve romë dhe egjiptianë në praktikën profesionale në administratën publike.	2026-2030	Nuk ka të dhëna të disagreguara.	Numri i romëve dhe egjiptianëve që kryejnë praktikën profesionale në administratën publike.	200 (2030)	AKR, MKTS, DAP/Institucio net publike	Buxheti i shtetit, donatorë
Objektivi specifik 2.2: Fuqizimi ekonomik i romëve dhe egjiptianëve përmes vetëpunësimit, sipërmarrjes dhe formalizimit të aktiviteteve ekonomike dhe përfshirjes në sektorë me potencial, përfshirë ekonominë e gjelbër.							
Masa 2.2.1: Mbështetja e vetëpunësimit dhe zhvillimit të sipërmarrjes sociale dhe mikro-ndërmarrjeve.	a. Mbështetje vetëpunësimit dhe zhvillimit të bizneseve të vogla për R/E përmes granteve dhe programeve mbështetëse.	2026-2030	20 përfitues R/E (AKPA, 2024)	Numri i përfituesve nga grantet e vetëpunësimit.	≥120 biznese deri në 2030;	MEI/AKPA, NJVV, MSHMS, OJF	Buxheti i shtetit dhe donatorë
	b. Zbatimi i skemave të financimit dhe mbështetjes për zhvillimin e sipërmarrjes sociale dhe mikro-ndërmarrjeve në ekonominë e gjelbër (përfshirë riciklimin, riparimin), përmes granteve, pajisjeve dhe	2026-2030	Mungojnë të dhënat e disagreguara për R/E.	Numri i përfituesve nga skemat e financimit për ngritjen e biznesit; Numri i individëve dhe subjekteve të angazhuar formalisht në aktivitetet e ekonomisë së gjelbër.	≥20% e përfituesve janë R/E	NJVV, MEI, MIE, MSHMS, OJF	Buxheti i shtetit dhe donatorë

⁵² Në rastin e shërbimit civil VKM242/2015 dhe VKM243/2015, dhe vendime të tjera që rregullojnë rekrutimet në sisteme jashtë shërbimit civil.

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar (2030)	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 2: Punësimi dhe Formimi Profesional							
Qëllimi i Politikës 2: Rritja e përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve në tregun formal të punës dhe fuqizimi ekonomik i tyre.							
	mbështetjes për formalizim.						
Masa 2.2.2: Mbështetja për formalizimin e aktiviteteve ekonomike dhe përfshirjen në sektorë me potencial punësimi, përfshirë ekonominë e gjelbër.	a. Mbështetje për formalizimin e aktiviteteve ekonomike dhe individëve dhe subjekteve.	2026-2030	Mungojnë të dhënat e agreguara.	Numri i individëve të formalizuar/licencuar për aktivitete ekonomike ambulatorë ose të integruar në tregje publike të dedikuara.	≥100	MEI, DPT, QKB, NJVV	Buxheti i shtetit dhe donatorë
	b. Masa për lehtësim fiskal për bizneset romë dhe egjiptiane.	2026-2030	Mungojnë të dhënat e agreguara.	Numri i NJVV që miratojnë lehtësira fiskale; Numri i bizneseve përfituese nga reduktimi i taksave dhe tarifave vendore.	≥30 NJVV ≥200 subjekte	NJVV, MEI/MF	Buxheti i shtetit dhe donatorë
Objektivi specifik 2.3: Përmirësimi i aksesit të barabartë në punësim dhe reduktimi i diskriminimit në tregun e punës.							
Masa 2.3.1: Forcimi i mekanizmave institucionalë dhe masave për parandalimin e diskriminimit në tregun e punës.	a. Hartimi dhe miratimi i kuadrit rregullator për krijimin dhe funksionalizimin e mediatorëve të punësimit për romët dhe egjiptianët.	2026-2030	Mungon aktualisht.	Hartimi dhe miratimi i instrumenti ligjor.	Instrument ligjor i miraturar mbi krijimin dhe funksionalizimin e mediatorëve të punësimit (instrument horizontal përfshirë specifikimet për fushat e tjera si arsimi e shëndetësia)	MEI/AKPA, NJVV, MSHMS	Buxheti i shtetit
	b. Punësimi i mediatorëve në zyrat e punës në bashkitë me përqendrim të lartë të popullsisë romë dhe egjiptiane.	2026-2030	0	Numri i mediatorëve romë dhe egjiptianë të punësuar	≥12	AKPA, NJVV	Buxheti i shtetit
	c. Organizimi i trajnimeve të detyrueshme për stafin e shërbimeve të punësimit dhe AFP-së mbi diversitetin, mosdiskriminimin,	2026-2030	360 pjesëmarrës (AKPA, 2024).	Numri i stafit të punësimit të certifikuar.	≥410 deri në 2030	AKPA, NJVV, KMD	Buxheti i shtetit

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar (2030)	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 2: Punësimi dhe Formimi Profesional							
Qëllimi i Politikës 2: Rritja e përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve në tregun formal të punës dhe fuqizimi ekonomik i tyre.							
	trajtimin e barabartë dhe qasjen gjithëpërfshirëse.						
	ç. Zhvillimi i materialeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuesë për parandalimin e diskriminimit në tregun e punës, drejtuar punëkërkuësve, punëdhënësve dhe ofruesve të shërbimeve të punësimit.	2026-2030	0	Numri i materialeve dhe aktiviteteve informuese.	≥20	AKPA/ MEI, ISHPSHSH, KMD, OJF Organizatat e punëdhënësve	Buxheti i shtetit

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 3: Strehimi							
Qëllimi i Politikës 3: Përmirësimi i sigurisë së strehimit dhe aksesit në zgjidhje të qëndrueshme, të përballueshme dhe të desegreguara për romët dhe egjiptianët.							
Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i sigurisë së strehimit përmes legalizimit, formalizimit të vendbanimit dhe zgjidhjeve alternative të qëndrueshme.							
Masa 3.1.1: Forcimi i planifikimit vendor të strehimit social dhe përmirësimi i kapaciteteve.	a. Asistence teknike për bashkitë në hartimin/përditësimin e planeve 5-vjeçare të strehimit, lidhjen e tyre me PBA-në vendore.	2026-2030	30 NJVV me plane të miratuara (EKB, 2025); 30 aplikime të dorëzuara (EKB, 2024).	Numri i NJVV me plane strehimi të lidhura me PBA-në vendore; Numri i aplikimeve për financim.	≥ 45 NJVV me plane të hartuara/përditësuara e të lidhura me PBA-në (2028); ≥ 35 aplikime të dorëzuara;	MEI/EKB, NJVV, MF (lidhja me PBA)	Buxheti i shtetit, donatorë
Masa 3.1.2: Forcimi i proceseve të legalizimit dhe formalizimit të vendbanimit.	a. Mbështetje e identifikimit, përgatitjes së dosjeve dhe ndjekjes administrative të rasteve të legalizimit dhe formalizimit të vendbanimit për familjet R/E.	2026-2030	65 familje të asistuar në procedurë aplikimi (2025, pilot në Fier dhe Vorë).	Numri i rasteve të identifikuar dhe të trajtuara për legalizim.	≥500 raste të trajtuara dhe të mbyllura administrativisht (nga të cilat ≥50% mbyllen përmes formalizimit dhe/ose ≥20% përmes zgjidhjeve alternative, ≥30% riorientohen në programe sociale).	ASHK, NJVV, MEI	Buxheti i shtetit, donatorë
Objektivi specifik 3.2: Rritja e aksesit në programet e strehimit social dhe përmirësimi i kushteve të banimit për familjet më të cenueshme.							
Masa 3.2.1: Përmirësimi i aksesit dhe përfshirjes së familjeve R/E në programet e strehimit social.	a. Lehtësimi i aksesit të familjeve R/E në programet e subvencionimit të qerasë instrumenteve financiare të strehimit (kredi të buta), përmes informimit, mbështetjes dhe asistencës direkte në aplikim.	2026–2030	400 familje (EKB, 2024); 214 familje të asistuar (EKB, 2021-24).	Numri i familjeve përfituese sipas programit; % familje që vazhdojnë programin pas vitit të parë;	≥1500 familje përfituese deri në 2030; vijimësi ≥ 70%;	MEI/EKB, NJVV, MSHMS	Buxheti i shtetit
	b. Monitorim dhe llogaridhënie e zbatimit të kuotës ligjore ≥5% R/E në programet e strehimit social.	2026–2030	20.5% R/E përfitues në programin e subvencionimit të qerasë (MEI, 2025); 10.1% R/E përfitues në programin e përmirësimit	% e NJVV me raportim vjetor të zbatimit të kuotës; % familjesh R/E ndaj totalit të përfituesve të programeve	≥80% NJVV raportojnë zbatim të kuotës çdo vit; ≥5% e dokumentuar në ≥45 NJVV deri 2030.	MEI/EKB (monitorim), NJVV (zbatim raportim), MSHMS	Buxheti i shtetit

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 3: Strehimi							
Qëllimi i Politikës 3: Përmirësimi i sigurisë së strehimit dhe aksesit në zgjidhje të qëndrueshme, të përballueshme dhe të desegreguara për romët dhe egjiptianët.							
			të kushteve të banimit (MEI, 2025); 17.6% R/E përfitues (MEI, 2025).				
Masa 3.2.2: Përmirësimi i kushteve të banimit përmes ndërhyrjeve fizike.	a. Grante dhe ndërhyrje fizike për rehabilitimin e njësive individuale të banimit përmirësimin e kushteve të banimit përfamiljet R/E (çati, dyer, kushte sanitare brendshme, akses energji).	2026–2030	125 ose 10.1% e përfituesve të programit të përmirësimit të kushteve të banimit janë R/E (MEI, 2025).	Nr. njësish banimi me ndërhyrje individuale të dokumentuar	≥400 njësi banimi deri në 2030; ≥80% me standard të përshtatshëm banimi të verifikuar pas ndërhyrjes.	NJVV, MEI/EKB, MSHMS	Buxheti i shtetit
Objektivi specifik 3.3: Parandalimi i segregimit rezidencial dhe përmirësimi i aksesit në infrastrukturë dhe shërbime bazë.							
Masa 3.3.1: Parandalimi i segregimit rezidencial dhe përmirësimi i kushteve të jetesës.	a. Hartëzimi gjeografik i zonave me përqendrim R/E dhe rrezik segregimi (Procesi i Berlinit).	2027	0 NJVV me hartëzim sistematik (MEI, 2025)	Numri i bashkive me hartëzim të kompletuar; databaza gjeografike e publikuar;	≥100% e NJVV me përqendrim të R/E të dokumentuar (hartëzim i përfunduar deri në Q4 2027)	MEI, NJVV, MSHMS	Buxheti i shtetit, donatorë
	b. Hartimi dhe miratimi i plane vendore të ndërhyrjes për zonat e klasifikuara "rrezik i lartë segregimi" nga hartëzimi (a) me fokus integrimin e tyre në planet urbanistike vendore (Ligji 107/2014) dhe në konsultim me komunitetin R/E.	2028–2030	Mungojnë planet e dedikuara	Numri i planeve të miratuara; % propozimesh të komunitetit R/E të reflektuara në planet finale.	≥1 plan për çdo zonë të klasifikuar "rrezik i lartë" nga hartëzimi; ≥60% e propozimeve të komunitetit të reflektuar	NJVV MEI, MIE, OJF	Buxheti i shtetit, donatorë
	c. Zbatimi i projekteve infrastrukturore për përmirësimin e aksesit në ujë, kanalizime, energji dhe rrugë në zonat më	2026–2030	Mungojnë të dhënat e disagreguara për R/E	Numri i projekteve të zbatuara; Numri i familjeve me akses të përmirësuar në ujë,	≥20 projekte ≥1,000 numri i familjeve që përfitojnë akses të përmirësuar	NJVV, MIE, MEI, FSHZH	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 3: Strehimi							
Qëllimi i Politikës 3: Përmirësimi i sigurisë së strehimit dhe aksesit në zgjidhje të qëndrueshme, të përballueshme dhe të desegreguara për romët dhe egjiptianët.							
	përqendrim të komuniteteve R/E.			kanalizime, energji ose rruge.	në ujë, kanalizimi, energji ose ujë.		
	ç. Organizimi i konsultimeve të strukturuar me komunitetet R/E për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e ndërhyrjeve në strehim dhe infrastrukturë.	2025-2030	Mungojnë të dhëna të konsoliduara	Konsultime të realizuara	≥40 konsultime	NJVV; MEI, OJF, MSHMS	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 4: Kujdesi Shëndetësor							
Qëllimi i Politikës 4: Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet shëndetësore dhe reduktimi i pabarazive në rezultatet shëndetësore.							
Objektivi specifik 4.1: Rritja e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve shëndetësore parësore dhe parandaluese.							
Masa 4.1.1: Zgjerimi i aksesit në shërbimet shëndetësore parësore e parandaluese përmes ndërhyrjeve në terren dhe identifikimit aktiv të përfituesve.	a. Zbatimi dhe zgjerimi i ekipeve lëvizëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore parësore dhe parandaluese në komunitetet R/E (vizita, vaksinim, kontroll bazë dhe referim).	2026-2030	52,429 individë R/E të arritur përmes ekipeve lëvizëse (MSHMS, 2024).	% e popullsisë R/E me të paktën 1 vizitë/vit; Numri i vizitave nga ekipet lëvizëse për 1,000 banorë (R/E); % e referimeve të ndjekura.	≥70% mbulim; Rritje progresive vjetore e përdorimit të shërbimeve.	MSHMS, OSHKSH, ISHP, NJVV, mediatorë	Buxheti i shtetit, donatorë
	b. Rritja e mbulimit të kontrollit bazë shëndetësor (check-up) për grupmoshën 35-70 vjeç, përmes identifikimit aktiv dhe referimit	2026-2030	Nuk disponohen të dhënat e disagreguara (të shtohen në 2026)	% e popullsisë R/E (35-70 vjeç) që kryen check-up (sipas grupmoshave dhe gjinisë).	≥15% rritje	MSHMS, OSHKSH/QSH ISHP KMD	Buxheti i shtetit, donatorë
Masa 4.1.2: Përmirësimi i cilësisë, barazisë dhe përdorimit të shërbimeve shëndetësore.	a. Zbatimi i programeve të detyrueshme të trajnimit për stafin mjekësor dhe administrativ të QSH-ve mbi mosdiskriminimin, barazinë gjinorë dhe komunikimin ndërkulturor.	2026-2030	494 punonjës mjekësor dhe administrativ të trajnuar (MSHMS, 2024).	% e stafit të trajnuar në zonat prioritare; % e QSH-ve që zbatojnë protokolle anti-diskriminim.	100% QSH në zonat prioritare të trajnuar	MSHMS, ISHP, OSHKSH/QSH, KMD	Buxheti i shtetit, donatorë
	b. Zhvillimi dhe zbatimi i një mekanizmi të strukturuar për raportimin dhe monitorimin e rasteve të diskriminimit në shërbimet parësore shëndetësore.	2026-2030	Mungon një mekanizëm funksional	Numri i rasteve të raportuara të diskriminimit për 1,000 vizita.	Mekanizëm i miratuar deri në 2027; raportim vjetor nga të gjitha QSH e zonave prioritare; publikim i të dhënave	MSHMS, ISHP, OSHKSH/QSH, KMD	Buxheti i shtetit, donatorë
Masa 4.1.3: Fuqizimi i shërbimeve për shëndetin e nënës	a. Identifikimi aktiv dhe ndjekje antenatale/postnatale e grave R/E përmes rrjetit	2026-2030	3,833 gra dhe vajza R/E që përfituese të shërbimeve gjatë shtatzënisë (MSHMS, 2024)	% e nënave më të paktën 4 vizita antenatale;	95% e nënave më të paktën 4 vizita antenatale;	MSHMS, OSHKSH, ISHP, NJVV,	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 4: Kujdesi Shëndetësor							
Qëllimi i Politikës 4: Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet shëndetësore dhe reduktimi i pabarazive në rezultatet shëndetësore.							
dhe fëmijës dhe rrija e aksesit në përfitimet shëndetësore dhe sociale.	të infermierëve dhe mediatorëve.			% vizitave postnatale (brenda 7 ditëve pas lindje).	95% e foshnjave të vizituara	Mediatorët	
	b. Rritje e aksesit në përfitimet financiare (bonusi i bebes) dhe shërbimet shëndetësore (barna falas) përmes bashkëpunimit të strukturave sociale, shëndetësore dhe mediatorëve.	2026-2030	1,010 familje	Numri i përfituesve	≥30% rritje (1,300 familje)	MSHMS, SHSSH, OSHKSH, NJVV. Mediatorët	Buxheti i shtetit, donatorë
Objektivi specifik 4.2: Forcimi dhe institucionalizimi i sistemit të mediatorëve shëndetësorë dhe rritja e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në sektorin shëndetësor.							
Masa 4.2.1: Konsolidimi dhe zgjerimi i sistemit të mediatorëve shëndetësor.	a. Miratimi i kuadrit ligjor dhe buxhetor për institucionalizimin e mediatorëve shëndetësorë.	2026-2028	VKM e pamiratur	VKM e miratuar dhe mediatorët të përfshirë në strukturat organike të MSHM; Numri i pozicioneve të miratuara në strukturën organike; Numri i mediatorëve të rekrutuar dhe aktivë; Buxheti vjetor i dedikuar; numri i komuniteteve të mbuluara.	VKM e miratuar (Q2 2027) me mediatorët shëndetësorë të përfshirë në strukturën organike dhe buxhet të dedikuar (PBA 2027–2029); ≥50% e pozicioneve të miratuara të plotësuara me personel të rekrutuar dhe të trajnuar (Q4 2027).	MSHMS, MF, OSHKSH, NJVV	Buxheti i shtetit, donatorë
	b. Zgjerimi i rrjetit të mediatorëve shëndetësorë.	2026-2030	37 mediatorë (MSHMS, 2025)	Numër mediatorësh/10.000 banorë;	≥56 mediatorë (50% rritje).	MSHMS, OSHKSH, NJVV	Buxheti i shtetit, donatorë
Masa 4.2.2: Rritja e përfaqësimit të romëve dhe	a. Zbatimi i programeve të bursave dhe kuotave për studentët romë dhe	2026-2030	0	Numri i studentëve përfitues (bursa &	≥50 studentë romë dhe egjiptianë.	MSHMS, MA,	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 4: Kujdesi Shëndetësor							
Qëllimi i Politikës 4: Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet shëndetësore dhe reduktimi i pabarazive në rezultatet shëndetësore.							
egjiptianëve në sektorin shëndetësor përmes arsimit dhe punësimit.	egjiptianë në studimet mjekësore dhe teknike shëndetësore.			kuota) në Fakultetin e Mjekësisë.		Fakulteti i Mjekësisë/IAL	
	b. Zbatimi i politikave për rritjen e përfaqësimit të R/E në institucionet e shëndetit publik.	2026-2030	0	Rritje e numrit mjekëve/infermierëve të punësuar nga komunitetet.	50 profesionistë R/E të punësuar /rritje progresive.	MSHMS OSHKSH,	Buxheti i shtetit, donatorë
Objektivi specifik 4.3: Rritja e edukimit shëndetësor dhe përdorimit të shërbimeve parandaluese në komunitetet rome dhe egjiptiane.							
Masa 4.3.1: Përmirësimi i edukimit shëndetësor dhe promovimi i sjelljeve të shëndetshme përmes angazhimit komunitar.	a. Zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit për përdorimin e shërbimeve shëndetësore dhe navigim në sistem (e-Albania, referim) .	2026-2030	0	Numri i fushatave ndërgjegjësuese të realizuara në terren (në lagjet e banimit); nr. i familjeve/individëve të informuara.	≥30 fushata ndërgjegjësuese; ≥10,000 përfitues	MSHMS , ISHP, OSHKSH/NJVKS H, NJVV, OJF	Buxheti i shtetit, donatorë
	b. Zbatimi i fushatave aktive të vaksinimit “derë më derë” dhe sistemit të gjurmimit për fëmijët me vaksina të vonuara.	2026-2030	Nën mesataren e përgjithshme të popullsisë (MSHMS, 2024).	% e fëmijëve R/E dhe egjiptianë të vaksinuar sipas kalendarit kombëtar (DTP3, Polio, MMR); % e fëmijëve R/E që rikuperojnë brenda vitit vaksinat e vonuara.	95% mbulim me vaksinat bazë sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit.	MSHMS , ISHP, OSHKSH/NJVKS H, NJVV Mediatorët	Buxheti i shtetit, donatorë
	c. Zbatimi i programeve dhe fushatave për promovimin e stileve të shëndetshme të jetesës në komunitetet rome dhe egjiptiane.	2026-2030	Nuk disponohen të dhëna të strukturuar (baseline do të vendoset në 2026).	Numri i programeve dhe fushatave; Numri i pjesëmarrësve në aktivitete.	≥25 programe dhe fushata të realizuara ≥5,000 individë të përfshirë.	MSHMS , ISHP, OSHKSH/NJVKS H, NJVV Mediatorët, OJF	Buxheti i shtetit, donatorë
	ç. Organizimi i sesioneve edukative të strukturuar me vlerësim para dhe pas ndërhyrjes për vaksinimin dhe kujdesin ndaj foshnjave.	2026-2030	0	% e pjesëmarrësve që raportojnë rritje të njohurive mbi rëndësinë e vaksinimit dhe kujdesit ndaj foshnjave.	2000 gra pjesëmarrëse; ≥70% e rritje të njohurive	MSHMS , OSHKSH, ISHP, maternitetet, NJVV, OJF	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 4: Kujdesi Shëndetësor							
Qëllimi i Politikës 4: Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet shëndetësore dhe reduktimi i pabarazive në rezultatet shëndetësore.							
	d. Zbatimi i fushatave komunitare ndërgjegjësuese mbi Semundjet Seksualisht të Transmetueshme (SST) dhe shëndetin riprodhues.	2026-2030	5 fushata	Numri i aktiviteteve e të realizuara.	≥20 fushata	MSHMS, ISHP, OSHKSH, OJF, mediatorë	Buxheti i shtetit, donatorë
	dh. Prodhimi dhe shpërndarja e materialeve informuese të përshtatura kulturalisht dhe në gjuhë rome.	2026-2030	4 materiale të prodhuara	Numri i materialeve të prodhuara dhe të shpërndara; % e familjeve që kanë parë materialet	≥10 materiale të prodhuara; ≥60% e familjeve	MSHMS, ISHP, OSHKSH, NJVV, OJF, Media	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 5: Varfëria dhe përjashtimi social							
Qëllimi i Politikës 5: Reduktimi i varfërisë dhe përjashtimit social të komuniteteve rome dhe egjiptiane përmes rritjes së aksesit në mbrojtjen sociale, shërbimet e integruara dhe aktivizimit ekonomik.							
Objektivi specifik 5.1: Rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në shërbimet e integruara dhe forcimi i mekanizmave të identifikimit dhe menaxhimit të rasteve.							
Masa 5.1.1: Forcimi i aksesit në mbrojtjen sociale dhe shërbime të integruara.	a. Zbatim i sistemit proaktiv të identifikimit dhe ndjekjes përmes ekipeve lëvizëse dhe koordinimit ndërsektorial për adresimin e nevojave të familjeve R/E (Koordinim me 4.1.1.a).	2026-2030	25 bashki me ekipe lëvizëse (MSHMS, 2025)	Numri i bashkive me ekipe funksionale; Numri/ i familjeve të identifikuar; Numri i rasteve të regjistruara dhe ndjekura.	≥80% e bashkive deri në 2030; Rritje vjetore e rasteve të identifikuar dhe ndjekura.	MSHMS, AKPA NJVV, SHSSH, AKSHI Ofruesit e AFP Punëdhënësit	Buxheti i shtetit, donatorë
	b. Rritje e aksesit për familjet R/E në shërbime të integruara sociale (cash+).	2026-2030	Mungojnë të dhënat e agreguara për R/E (baseline do të vendoset në 2026)	% e familjeve R/E përfituese nga skemat cash+	≥ 80% e familjeve të regjistruara përfitojnë shërbime të integruara		Buxheti i shtetit, donatorë
	c. Zbatimi i një sistemi të integruar për menaxhimin e rasteve (MIS i integruar).	2026-2030	Nuk ka sistem të integruar. Aktualisht (lidhur me MSHMS) ekzistojnë 3 sisteme për shërbimet e përkujdesit (SHKSH, ROMALB dhe REVALB) dhe 2 përfitimet në para (NE&PAK).	Vlerësim i sistemeve ekzistuese; Sistem i integruar i zhvilluar dhe funksional; % e bashkive që përdorin sistemin.	≥ 100% menaxhim i rasteve përmes (SHKSH) deri në 2030.		Buxheti i shtetit, donatorë
Masa 5.1.2: Ativizimi ekonomik dhe përfshirja në tregun e punës për përfituesit e mbrojtjes sociale, me fokus gratë rome dhe egjiptiane.	a. Referimi i strukturuar i përfituesve të NE drejt programit të riintegrimin social (VKM 401, zbatuar nga AKPA, me ndjekje të rezultateve sipas 2.1.1b).	2026-2030	2,342 familje përfituese të NE, prej të cilëve 887 të punësuar përmes AKPA (AKPA, 2025)	% e përfituesve NE të referuar drejt programeve të nxitjes së punësimit.	≥25% e përfituesve të NE të përfshirë çdo vit në tregun e punës	MSHMS, SHSSH, AKPA, NJVV Ofrues AFP, Punëdhënësit	Buxheti i shtetit, donatorë
	b. Ofrimi i programeve të formimit profesional në sektorët social dhe shëndetësor për gratë R/E (përfshirë ato në NE) me certifikim dhe ndërmjetësim në punë.	2026-2030	mungojnë të dhëna të konsoliduara	% pjesëmarrëse që përfundojnë; % që punësohen	≥ 70% përfundim; ≥ 60% punësim.		Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 5: Varfëria dhe përjashtimi social							
Qëllimi i Politikës 5: Reduktimi i varfërisë dhe përjashtimit social të komuniteteve rome dhe egjiptiane përmes rritjes së aksesit në mbrojtjen sociale, shërbimet e integruara dhe aktivizimit ekonomik.							
	c. Ofrimi i shërbimeve të integruara për identifikimin, referimin dhe mbështetjen e fëmijëve dhe të rinjve R/E, dhe familjeve të tyre, për të garantuar vijimësinë në arsim dhe lidhjen me shërbimet sociale, dhe orientimin drejt aftësisimit/punësimit për të rinjtë (Koordinim me 1.1.2.d dhe 2.1.3).	2026–2030	103 raste të referuara (MSHMS, 2025); Zbatim i pabarabartë i modelit të menaxhimit të integruar të rastit.	Numri i bashkive që zbatojnë modelin e menaxhimit të rastit; Numri i rasteve identifikuar dhe të referuara; numri i planeve individuale të mbështetjes; % e rasteve që ruajnë vijimësi.	100% bashki që zbatojnë modelin e menaxhimit të rastit për fëmijë dhe të rinj R/E deri në vitin 2030; ≥500 ⁵³ familje të përfshira në menaxhim aktiv ; ≥ 200 raste të reja të identifikuar dhe të referuara në shërbime; ≥70% e rasteve aktive marrin të paktën 2 shërbime të integruara ≥80% ruajnë vijimësi mbajnë vijimësinë 6 muaj+ ose deri në përfundimin e planit individual.		Buxheti i shtetit, donatorë
Masa 5.1.3: Forcimi dhe standardizimi i mekanizmave vendorë të identifikimit , referimit dhe menaxhimit të rasteve për fëmijët dhe familjet në rrezik.	a. Forcimi/standardizimi i mekanizmit të referimit për fëmijët dhe familjet në nevojë për mbrojtje.	2026-2030	61 bashki me sistemi referimi funksional (2025); 94 raste të fëmijëve në situatë rrugë ose rrezik trafikimi (MSHMS, 2024).	Numri i bashkive të kapacituara; Numri i fëmijëve/familjeve të trajtuara përmes planeve individuale të ndërhyrjes, të ndara sipas etnisë, gjinisë etj.	61 bashki të kapacituara dhe zbatojnë procedura të standardizuara të menaxhimit të rasteve; Të paktën 220 raste të identifikuar, trajtuara dhe të ndjekura përmes planeve	MSHMS , SHSSH, NJVV, ASHDMF, MPB, Policia e Shtetit, OJF	Buxheti i shtetit, donatorë

⁵³ Të reja dhe ekzistuese

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 5: Varfëria dhe përjashtimi social							
Qëllimi i Politikës 5: Reduktimi i varfërisë dhe përjashtimit social të komuniteteve rome dhe egjiptiane përmes rritjes së aksesit në mbrojtjen sociale, shërbimet e integruara dhe aktivizimit ekonomik.							
					individuale/familiar e të ndërhyrjes deri në 2030.		
	b. Zgjerimi i shërbimeve komunitare multifunkionale për mbështetjen e familjeve rome dhe egjiptiane.	2026-2030	22 shërbime/qendra multifunkionale (2025); Mungojnë të dhëna të konsoliduara në lidhje të mbulimit të familjeve me shërbimeve komunitare të integruara.	Numri i qendrave funksionale në bashkitë prioritare; % e familjeve R/E në zonat prioritare që përfitojnë të paktën një shërbim komunitar të integruar.	≥30 shërbime/multifunkionale; ≥70% mbulim i familjeve në zona prioritare.	NJVV, MSHMS, SHSSH, Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës, OJF/ofrues shërbimesh	Buxheti i shtetit, donatorë
Objektivi specifik 5.2: Forcimi i mekanizmave vendorë për përgatitjen dhe reagimin ndaj krizave dhe emergjencave.							
Masa 5.2.1: Forcimi i përgatitjes dhe reagimit social në situata emergjence dhe krize.	a. Zbatimi i fushatave ndërgjegjësuese në gjuhën rome për rreziqet nga pandemitë dhe emergjencat civile (përmbytje, zjarre, erozion).	2026-2030	0	Hartimi Protokollit Emergjencës për pakicat; numri i fushatave të realizuara.	1 protokoll.	MSHMS, AKMC, NJVV SHSSH, Strukturat vendore të mbrojtjes civile	Buxheti i shtetit, donatorë
	b. Krijimi i databazave vendore për identifikimin e familjeve në rrezik dhe reagimin e shpejtë në emergjencë.	2026-2030	Mungojnë të dhëna të konsoliduara në nivel bashkish.	Krijimi i databazave vendore, duke nisur nga bashkitë prioritare; % e familjeve të identifikuar.	≥20 bashki prioritare me databaza funksionale; ≥80% e familjeve të identifikuar të referuara.		Buxheti i shtetit, donatorë
	c. Identifikimi i vendbanimeve në rrezik dhe planifikimi i masave mbrojtëse ose zhvendosjes emergjente.	2026-2030	Nuk ka të dhëna të strukturuar	Përqindja e familjeve rome dhe egjiptiane që marrin mbështetje të menjëhershme (ushqimore/ mjekësore) gjatë krizave.	≥80% e familjeve të identifikuar.		Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 6: Antigjipsizmi							
Qëllimi i Politikës 6: Reduktimi i antigjipsizmit dhe forcimi i mekanizmave institucionalë për parandalimin dhe adresimin e diskriminimit.							
Objektivi specifik 6.1: Integrimi i konceptit të antigjipsizmit në kuadrin ligjor, strategjik dhe institucional të politikave publike.							
Masa 6.1.1: Integrim i antigjipsizmit në legjislacion dhe politika sektoriale.	a. Standardizimi dhe integrimi i konceptit të antigjipsizmit në legjislacion, dokumente politike dhe strategjitë sektoriale.	2026-2030	0 dokumente që referojnë antigjipsizmin (MSHMS, 2025).	Numri i dokumenteve ligjore dhe strategjike që përfshijnë antigjipsizmit.	≥7 dokumente sektoriale (arsim, shëndetësi, punësim, mbrojtje sociale dhe planet përkatëse)	Kuvendi, MSHMS, MD, Ministritë e linjës, ASPA, KMD	Buxheti i shtetit, donatorë
Objektivi specifik 6.2: Forcimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin dhe adresimin e diskriminimit dhe antigjipsizmit.							
Masa 6.2.1: Forcimi i kapaciteteve profesionale për parandalimin dhe adresimin e antigjipsizmit.	a. Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të detyrueshme të trajnimit mbi antigjipsizmit, diskriminimin dhe krimet e urrejtjes për administratën publike, sistemin e drejtësisë, policinë dhe aktorët politikë/vendorë.	2026-2030	0 programe të standardizuara trajnimi; Kurrikula për antigjipsizmin e miratuar dhe zbatuar në Shkollën e Administratës Publike (ASPA, 2025)	% e punonjësve të administratës publike të trajnuar; % e punonjësve të policisë, prokurorisë dhe gjyqtarëve të trajnuar/certifikuar; % e antarëve të Kuvendit dhe Këshillave bashkiakë që marrin pjesë në seanca ndërgjegjësuere.	≥ 70% e stafit relevant në administratë të trajnuar; ≥50% rritje e profesionistëve të drejtësisë të certifikuar; ≥80% e antarëve të Kuvendit dhe KB të ndërgjegjësuar (me rifreskim për çdo legjislaturë).	ASPA, Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, MSHMS, MD, DAP, Ministritë e linjës, KMD, NJVV	Buxheti i shtetit, donatorë
Masa 6.2.2: Forcimi i sistemeve për monitorimin, raportimin dhe adresimin e diskriminimit dhe antigjipsizmit.	a. Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi të integruar për monitorimin, raportimin dhe analizën e diskriminimit dhe antigjipsizmit, përfshirë mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e gjuhës së urrejtjes.	2026-2030	Mungon një sistem i integruar dhe raportimi është i fragmentuar (MSHMS, 2025).	Sistem i integruar i zhvilluar dhe funksional; Numri i institucioneve që raportojnë në sistem.	1 sistem funksional; ≥80% e institucioneve përkatëse raportojnë.	MSHMS, AKSHI, KMD, MD, NJVV	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 6: Antigjipsizmi							
Qëllimi i Politikës 6: Reduktimi i antigjipsizmit dhe forcimi i mekanizmave institucionalë për parandalimin dhe adresimin e diskriminimit.							
	b. Identifikimi dhe trajtimi i rasteve të diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes.	2026-2030	Raportimi nuk është sistematik.	Numri i rasteve të identifikuar dhe trajtuara.	≥50% rritje e rasteve	Prokuroria, e Përgjithshme, Policia e Shtetit, KMD, Gjykatat, MD, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Urdhri i Psikologut, Urdhri i Punonjësit Social.	Buxheti i shtetit, donatorë
	c. Zbatimi i mekanizmave të bashkë-monitorimit dhe raportimit periodik mbi antigjipsizmin në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.	2026-2030	0 mekanizma formalë bashkë-monitorimi.	% e fondeve publike të dedikuara për OSHC; Numri i raporteve të pavarura periodike të publikuara; % rasteve të identifikuar nga raportet që marrin trajtim institucional.	Mekanizëm formal i bashkë-monitorimi funksional; ≥3 raporte periodike ≥5% fonde të dedikuara OSHC R/E; ≥50% rasteve të identifikuar me trajtim.	MSHMS, KMD. Avokati i Popullit, OSHC	Buxheti i shtetit, donatorë
Objektivi specifik 6.3: Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe promovimi i narrativave pozitive për romët dhe egjiptianët.							
Masa 6.3.1: Promovimi i diversitetit dhe reduktimi i stereotipeve përmes fushatave ndërgjegjëse dhe aktiviteteve publike.	a. Zbatimi i fushatave të integruara ndërgjegjëse dhe aktivitete publike për promovimin e diversitetit, reduktimin e stereotipeve dhe ndryshimin e narrativës mbi romët dhe egjiptianët.	2026-2030	0 fushata të strukturuar dhe koordinuara.	Numri i fushatave kombëtare të realizuara; Numri i aktiviteteve publike (kombëtar & vendor); Numri i personave të arritur/informuar.	≥4 fushata kombëtare; ≥20 aktivitete publike; ≥5,000 persona të arritur.	KPK, MTKS, MSHMS, NJVV, Media, OJF. KMD	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 6: Antigjipsizmi							
Qëllimi i Politikës 6: Reduktimi i antigjipsizmit dhe forcimi i mekanizmave institucionalë për parandalimin dhe adresimin e diskriminimit.							
Masa 6.3.2: Rritja e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në jetën publike dhe vendimmarrje.	a. Nxitja e pjesëmarrjes së R/E në proceset zgjedhore dhe strukturat vendimmarrëse vendore dhe kombëtare.	2026-2030	5 bashki kanë përfaqësues nga komunitetet R/E në KB (2024); Mungojnë të dhënat për pjesëmarrjen zgjedhore.	Numri i përfaqësuesve R/E në listat e kandidatëve për Këshillat Bashkiakë.	≥20 bashki me përfaqësues R/E në Këshillat Bashkiakë dhe strukturat vendimmarrëse.	KQZ, NJVV, KMD, OSHC	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 7: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil							
Qëllimi i Politikës 7: Garantimi i aksesit efektiv dhe të barabartë të romëve dhe egjiptianëve në regjistrimin civil, dokumentimin personal dhe ndihmën juridike falas.							
Objektivi specifik 7.1: Përmirësimi i regjistrimit civil dhe dokumentimit të romëve dhe egjiptianëve përmes eliminimit të barrierave administrative dhe financiare.							
Masa 7.1.1: Identifikimi proaktiv dhe regjistrimi civil i personave të paregjistruar	a. Identifikimi në terren i personave të paregjistruar dhe mbështetja e tyre për regjistrim civil dhe dokumentim, përfshirë brenda dhe jashtë vendit.	2026-2030	402 persona R/E të paregjistruar total (MPB/DPGjC, 2023); prej të cilëve 250 fëmijë të identifikuar si të paregjistruar.	Numri i personave të identifikuar si të paregjistruar; % e rasteve të identifikuar që përfundojnë regjistrimin civil.	≥600 persona të identifikuar deri në 2030; ≥90% e rasteve të identifikuar të zgjidhura me regjistrim civil.	MPB/ DPGjC, NJVV, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, OJF rome/egjiptiane	Buxheti i shtetit, donatorë
Masa 7.1.2: Eliminimi i barrierave administrative dhe financiare për regjistrimin civil përmes shërbimeve mbështetëse, thjeshtimit të procedurave dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.	a. Ofrimi i shërbimeve mbështetëse për regjistrimin civil, përfshirë përkthimin, legalizimin e dokumenteve dhe procedurat konsullore.	2026-2030	0 shërbime të strukturuar si paketë e integruar mbështetëse (2025).	Numri i personave/familjeve që përfitojnë shërbime mbështetëse për regjistrimin civil; % e rasteve të mbështetura që përfundojnë procesin me dokumentacion të rregulluar.	≥1,500 persona të mbështetur; ≥80% e rasteve.	MPB / DPGjC, MPJ, Institucionet arsimore, NJVV/SHSSH	Buxheti i shtetit, donatorë
	b. Mbështetja financiare për testet e ADN dhe procedurat e verifikimit të identitetit për rastet pa dokumentacion.	2026-2030	50 ADN (MPB, 2025); 270 legalizime falas nga konsullatat (MPB, 2025).	Numri i testeve të ADN të rimbursuara; Numri i rasteve të verifikimit të identitetit të përfunduara.	≥100 teste ADN në vit; ≥400 raste verifikimi identiteti në vit	MPB / DPGjC (ADN koordinim) dhe MPJ	Buxheti i shtetit, donatorë
	c. Thjeshtimi dhe standardizimi i procedurave administrative për regjistrim civil dhe transferimin e dosjeve (ku familja jeton aktualisht).	2026-2027	Nuk ka procedura të standardizuara (MPB, 2025).	Procedurë e standardizuar e miratuar; % e bashkive/zyrave të gjendjes civile që zbatojnë procedurën e standardizuar.	Procedurë e standardizuar e miratuar deri në 2027; ≥85% e zyrave të gjendjes civile e zbatojnë;	MPB / DPGjC NJVV, MSHMS/SHSSH	Buxheti i shtetit, donatorë
	ç. Trajnimi i nëpunësve të gjendjes civile për trajtimin pa diskriminim dhe menaxhimin e	2026-2030	525 nëpunës të trajnuar (MPB, 2025).	Numri i nëpunësve të trajnuar; % e zyrave të gjendjes civile me staf të trajnuar.	≥800 nëpunës të trajnuar; ≥90% e zyrave të gjendjes civile me	MPB/ DPGjC ASPA, MSHMS/SHSSH, NJVV	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 7: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil							
Qëllimi i Politikës 7: <i>Garantimi i aksesit efektiv dhe të barabartë të romëve dhe egjiptianëve në regjistrimin civil, dokumentimin personal dhe ndihmën juridike falas.</i>							
	rasteve komplekse të regjistrimit civil				të paktën 1 punonjës të trajnuar.		
	d. Zbatimi i procedurave alternative për regjistrimin civil përmes vërtetimit faktit të vendbanimit për familjet në zona informale. <i>(Koordinim me 3.1.2.a)</i>	2026-2030	Mungojnë të dhënat e konsoliduara (do të vendoset në fund të 2026).	Numri i rasteve të regjistruara përmes vërtetimit faktit të vendbanimit; % e këtyre rasteve të trajtuara që përfundojnë regjistrimin civil.	≥500 raste të regjistruara deri në 2030; ≥80% e rasteve të trajtuara përfundojnë me regjistrimin civil.	MPB / DPGJC NJVV, MSHMS/SHSSH, OJF, e-Albania AKSHI	Buxheti i shtetit, donatorë
Objektivi specifik 7.2: <i>Rritja e aksesit në ndihmën juridike falas dhe shërbimet elektronike publike.</i>							
Masa 7.2.1: Përmirësim i aksesit në ndihmës juridike falas për romët dhe egjiptianët	a. Ofrimi i ndihmës juridike parësore dhe dytësore për romët dhe egjiptianët	2026-2030	1,500 përfitues R/E (MD, 2025)	Numri i përfituesve romë dhe egjiptianë që përfitojnë ndihmë juridike falas; % e rasteve të mbyllura më zgjidhje ose referim të plotë Numri i avokatëve të gatshëm për përfaqësim gjyqësor.	≥3,000 përfitues; ≥70% e rasteve të trajtuara mbyllen me zgjidhje të plotë; Mbi 50 avokatë pjesë e rrjetit	MD/ Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Dhoma e Avokatisë Shqiptare, MSHMS, KMD, OJF	Buxheti i shtetit, donatorë
	b. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndihmën juridike për të lehtësuar aksesin e romëve dhe egjiptianëve.	2026-2027	0	Kuadri ligjor i rishikuar dhe miratuar/romët dhe egjiptianët si kategori përfituese automatike (ex-lege); numri i dispozitave që lehtësojnë aksesin;	1 paketë ligjore e miratuar, deri Q4 2027; ≥2 dispozita konkrete me efekt të drejtpërdrejtë	MD. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	Buxheti i shtetit, donatorë
	c. Zgjerimi i rrjetit të shërbimeve të ndihmës juridike falas dhe bashkëpunimit me klinikat	2026-2030	20 qendra/zyra funksionale të ndihmës juridike parësore ⁵⁴	Numri i qendrave/zyrave funksionale të ndihmës juridike të hapura në bashkitë me përqendrim	≥25 qendra/zyra funksionale; ≥20 marrëveshje funksionale.	MD/ Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, IAL, OJF	Buxheti i shtetit, donatorë

⁵⁴ Në Tiranë, Lushnjë, Durrës, Shkodër, Fier, Gjirokastrë, Tropojë, Përmet, Puka, Mati, Kavajë, Kurbin, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Dibër, Kukës, Korçë, Berat, Elbasan;

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 7: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil							
Qëllimi i Politikës 7: Garantimi i aksesit efektiv dhe të barabartë të romëve dhe egjiptianëve në regjistrimin civil, dokumentimin personal dhe ndihmën juridike falas.							
	ligjore dhe organizatat përkatëse.		14 organizata jofitimprurëse të cilat operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Berat; Shkodër dhe Vlorë të autorizuara nga MD; 13 marrëveshje bashkëpunimi me klinikat ligjore pranë IAL-ve që operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë dhe Shkodër (MD, 2025).	të lartë të komuniteteve; Numri i marrëveshjeve funksionale me klinikat ligjore dhe organizatat përkatëse.			
Masa 7.2.2: Rritja e ndërgjegjësimit dhe fuqizimit ligjor të romëve dhe egjiptianëve.	a. Zbatimi i fushatave informuese dhe aktiviteteve të edukimit ligjor për rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat mbi të drejtat dhe procedurat për ndihmën juridike falas.	2026-2030	1,000 gra dhe vajza rome dhe egjiptiane të informuara/mbështetura (MD, 2025)	Numri i personave të informuar mbi të drejtat dhe procedura e ndihmës juridike; Numri i grave dhe vajzave të mbështetura në çështje të pronësisë dhe familjes; Numri i fushatave/aktiviteteve të realizuara.	≥2,000 gra dhe vajza rome dhe egjiptiane të informuara/mbështetura; ≥10 fushata/aktiviteteve të edukimit ligjor të realizuara.	MD , Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, NJVV, MSHMS, KMD OJF	Buxheti i shtetit, donatorë
Masa 7.2.3: Rritja e përfshirjes dixhitale dhe e aksesit në shërbimet elektronike për romët dhe egjiptianët.	a. Zbatimi i programeve të trajnimit për shkrim-lexim dixhital dhe navigim në shërbimet e e-Albania, të synuara për familjet rome dhe egjiptiane, në bashkëpunim me bashkitë dhe AKSHI	2026–2030	0 programe trajnimi të strukturuar të dedikuara për R/E (2025); Ankesat ndaj e-Albania për pengesa aksesit të dokumentuara nga KMD (2024).	Numri i trajnimeve të realizuara; numri i familjeve/individëve të trajnuar; % e familjeve R/E me akses aktiv në shërbimet e e-Albania.	≥30 programe trajnimi; ≥3,000 individë të trajnuar; ≥50% e familjeve R/E në bashkitë prioritare me akses aktiv në e-Albania deri në 2030.	MSHMS , AKSHI, MA, NJVV, OJF	Buxheti i shtetit, donatorë

Masa	Aktiviteti	Afati Kohor	Vlera bazë	Treguesit e performancës	Objektivat dhe vlera e synuar	Institucionet përgjegjëse	Burimet e Financimit
Fusha Prioritare 7: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil							
Qëllimi i Politikës 7: <i>Garantimi i aksesit efektiv dhe të barabartë të romëve dhe egjiptianëve në regjistrimin civil, dokumentimin personal dhe ndihmën juridike falas.</i>							
	b. Integrimi i moduleve të shkrim-leximit dixhital në programet e aktivizimit ekonomik dhe formimit profesional për romët dhe egjiptianët (koordinim me Masën 2.1.1).	2026–2030	0 module të integruara (2025).	Numri i programeve të punësimit dhe AFP-së që integrojnë module dixhitale; numri i pjesëmarrësve R/E.	≥10 programe me modul dixhital të integruar; ≥500 pjesëmarrës R/E.	AKPA, MSHMS, MEI, Ofrues AFP, NJVV	Buxheti i shtetit, donatorë

ANEKSI 2. Korniza e indikatorëve strategjik të monitorimit

Shënime metodologjike:

Më poshtë prezantohet korniza strategjike e cila përfshin treguesit bazë të performancës bazuar në tre shtylla metodologjike: (i) rekomandimin e KE-së⁵⁵, (ii) treguesit bazë sipas Deklaratës së Poznan; dhe (iii) tregues kombëtarë administrativë sipas sektorëve.

Burimi kryesor për vlerat bazë është Anketa e Romëve 2024 e kryer nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (European Union Agency for Fundamental Rights e referuar me shkurtesën FRA), e publikuar në tetor 2025 dhe përfshin 13 vende, nga të cilët 10 janë vende anëtarë dhe 3 kandidatë (Shqipëria për herë të parë, Maqedonia e Veriut dhe Serbia)⁵⁶. Anketa përfshin të gjithë 16 treguesit kryesorë të Aneksit II të BE-së me të dhëna për vendin tonë, të disagreguara sipas etnisë (por vetëm për romët) dhe është metodologjikisht të krahasueshme me shtetet anëtare pjesëmarrëse. Përdorimi i anketës mundëson plotësimin e vlerave bazë për PKVBPPRE 2030. Po ashtu, Anketa e Romëve ka cikël 4 vjeçar e do të shërbejë për vlerësimin afatmesëm (2028) dhe pas përfundimit të planit. Ndërkohë që të dhënat e Censit, duke qenë se janë dhjetëvjeçare shërbejnë si bazë për të dhënat demografike dhe infrastrukturore (banesa dhe akesi në shërbime bazë).

Grupi i parë i treguesve, të prezantuar në këtë seksion, përfshin treguesit të cilët masin progresin ndaj tre objektivave horizontalë të kornizës së BE-së, konkretisht: (1) lufta kundër antigjipsizmit dhe diskriminimit; (2) ulja e varfërisë; (3) promovimi i pjesëmarrjes. Në vijim të treguesve horizontalë paraqiten treguesit strategjik sektorialë lidhur me objektivat në fushën e arsimit, punësisimit, shëndetësisë dhe strehimit.

Tregues strategjikë, do të vlerësohen fillimisht gjatë gjashtëmujorit të parë, pas miratimit të planit, si dhe në vijim të zbatimit të tij, duke e pasuruar kuadrin e monitorimit si dhe për të reflektuar ndryshimet që mund të ndodhin në prioritizimin dhe mbledhjen e treguesve sektorialë. Gjithashtu, sikurse cilësohet dhe në seksionin mbi monitorimin (2.5.2 dhe 2.5.3.) kuadri i monitorimi do të plotësohet nga kontributet e shoqërisë civile dhe Platforma Kombëtare e Pjesëmarrjes, të cilat do të pasurojnë vlerësimin cilësor vjetor të integruar dhe në raportet vjetore të progresit të PKVBPPRE 2030.

⁵⁵ Komisioni Evropian, 2020, Annex II to COM(2020) 620 final.

⁵⁶ FRA (2025). "Roma Survey 2024". Anketë e FRA-së e vitit 2024 mbi romët dhe udhëtarët në Shqipëri, Bullgari, Çeki, Francë, Greqi, Hungari, Irlandë, Itali, Maqedoninë e Veriut, Portugali, Rumani, Serbi dhe Spanjë mblodhi informacion nga 10,126 të anketuar që jetojnë në familje, të cilët vetëidentifikohen si romë ose udhëtarë, janë 16 vjeç ose më të shumë dhe kanë jetuar në vendet ku është zhvilluar anketa për të paktën 12 muajt para anketës. Përveç kësaj, është mbledhur informacion për mbi 22,484 persona që jetojnë në familjet e të anketuarve dhe mbi infrastrukturën e njësive administrative/lagjeve ku banojnë. Puna në terren është zhvilluar nga qershori deri në dhjetor 2024 përmes intervistave ballë për ballë, me intervistues të trajnuar që përdornin pyetësin e kompjuterizuar. Aksesuar në: <https://fra.europa.eu/en/publications-and-resources/data-and-maps/2025/roma-survey-2024>

1. Treguesit horizontal

Kodi	Treguesi strategjik	Burimi	Vlera bazë	Synimi 2030	Institucioni përgjegjës	Komente
H-01	Numri / % e individëve (16+) që raportojnë diskriminim në 12 muajt e fundit për shkak të përkatësisë etnike (romë/egjiptianë).	Anketa e Romëve 2024 (FRA, 2024); KMD	37% (FRA, 2024); 24 (KMD, 2024)	Në ulje, ≥7 pp	MSHMS, KMD	Tregues bazë i rekomanduar nga BE për matjen e diskriminimit (OZHQ 10.3.1 dhe 16.b.1).
H-02	% e romëve dhe egjiptianëve që kanë përjetuar diskriminim dhe e kanë raportuar (norma e raportimit).	Anketa e Romëve 2024 (FRA, 2024)	8% (FRA, 2024)	Në rritje, ≥3 pp	MSHMS, KMD	Tregues bazë rezultati, i rekomanduar nga BE për matjen e diskriminimit, që reflekton cilësinë e trajtimit institucional (OZHQ 10.3.1 dhe 16.b.1).
H-03	% e romëve dhe egjiptianëve në rrezik varfërie (AROP) (nën 60% të medianes kombëtare pas transfertave sociale).	Anketa e Romëve 2024 (FRA, 2024)	67% (FRA, 2024)	Në ulje, ≥3 pp	MSHMS	Rekomandim I BE. Relevant për OZHQ 1.2.1.
H-04	% e fëmijëve (nën 18 vjeç) në rrezik varfërie (AROP).	Anketa e Romëve 2024 (FRA, 2024)	69% (FRA, 2024)	Në ulje, ≥5 pp	MSHMS	Rekomandim I BE. Relevant për OZHQ 1.2.2.
H-05	% e romëve dhe egjiptianëve në deprivim të rëndë material (nuk mund të përballojnë 4 nga 9 artikujt bazë).	Anketa e Romëve 2024 (FRA, 2024)	70% (FRA, 2024)	Në ulje, ≥5 pp	MSHMS	Rekomandim I BE. Relevant për OZHQ 1. Frekuenca vjetore, mund të konsiderohen tregues proxy
H-06	% e fëmijëve (nën 18 vjeç) R/E në deprivim të rëndë material.	Anketa e Romëve 2024 (FRA, 2024)	75% (FRA, 2024)	Në ulje, ≥10 pp	MSHMS	Rekomandim I BE. Relevant për OZHQ 2.
H-07	Numri i personave R/E të peregjistruar në regjistrat civilë.	MPB/DPGJC	402 (2023) (Burimi: MSHMS 2026, rënie nga 650, 2021)	0	MPB, DPGJC	Tregues kombëtar (Poznan) OZHQ 16.
H-08	Numri i qytetarëve R/E që kanë përfituar ndihmë juridike parësore ose dytësore.	MD/DNJF	547 (kumulative për 2021-2024, burimi: MSHMS, 2026)	+30%	MD, DNJF	Tregues kombëtar (Poznan) OZHQ 16.

2. Treguesit sektoriale

2.1. Arsimi

Kodi	Treguesi strategjik	Burimi	Vlera bazë	Synimi 2030	Institucioni përgjegjës	Komente
A-01	% e fëmijëve R/E (3-6 vjeç) në institucionet e arsimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme (EKFH).	NJVV, MA,	38.3% për fëmijët egjiptianë dhe në 26.5% për fëmijët romë (Censi 2023 ⁵⁷ , në nivel kombëtar vlera është 51.2%).	≥50%	MA,NJVV,	Tregues bazë i rekomanduar nga BE. Relevant për OZHQ 4.2.2. Mungojnë të dhënat e strukturuar për grupmoshën dhe të disagreguara sipas etnisë.
A-02	Numri/% e fëmijëve R/E të regjistruar në arsimin bazë (klasat 1-9)	SMIP/MA	9,503 (2023-2024, Vjetari Statistikor 2024)	≥95%	MA	Tregues bazë i rekomanduar nga BE dhe pjesë e Deklaratës së Poznan. Relevant për OZHQ 4.2.2.
A-03	% e fëmijëve R/E që përfundojnë arsimin bazë (norma e përfundimit të arsimit 9-vjeçar).	SMIP/MA	Vlera bazë e normës së përfundimit: të përcaktohet deri në Q2 2026 (rreth 80–85%, bazuar në raportin numër regjistrimesh/numër braktisjesh, MA 2024); 591 raste braktisjeje (2024)	≥90%; ulje e rasteve të braktisjes nën 300 deri në 2030	MA	Tregues bazë i rekomanduar nga BE dhe pjesë e Deklaratës së Poznan. Relevant për OZHQ 4.2.2. Shënim metodologjik: vlera bazë shprehet si normë përqindjeje e kohortës, e cila mundëson krahasim me vendet anëtare të BE-së dhe me treguesit e Aneksit II të Kornizës Strategjike. Numri i rasteve të braktisjes mbahet si tregues dytësor operacional.
A-04	Numri/% e fëmijëve R/E të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë.	SMIP/MA	858 (2023-2024, Vjetari Statistikor 2024).	≥70%	MA	Tregues bazë i rekomanduar nga BE dhe pjesë e Deklaratës së Poznan. Relevant për OZHQ 4.
